

STEFAN MARTIKO

KULTI I POEZISË
... DHE PËRSIATJE TË TJERA
RRETH ARTIT E LETËRSISË

Autori: Stefan Martiko
Redaktor: Josif Papagjoni
Copiright: Stefan Martiko

ISBN
Design: Mimoza Vasku



Rruca "Him Kolli". Pallati nr.41. Kati Nëntokë. Tiranë. Albania
E-mail: shtyp.emal@yahoo.com
Tel: 00355.682.036.631

LEXIMI SI HYRJE NË LETËRSI

A je ti më parë i përgatitur për leximin apo ndjehesh Ai tillë përgjatë leximit? Ndoshta kjo fazë na ka munduar më herët që në përzgjedhjen ndoshta ose edhe më herët të kanë orientuar drejt këtij libri vet dijet e tua si shije tashmë të formuara. Por ç'ndodh në të vërtetë gjatë leximit? A nuk është e pranishme në çdo çast dëshira jote që duke lexuar nis ta rishkruash po atë libër por sipas mënyrës tënde. Kemi në këtë rast një ndërkalje të një libri te një libër tjetër dhe këtë unë do ta quaja një lexim të begatë. Një lexim që pasuron letërsinë që hedh, shumë ura afrimi, aq sa një shoqëri nuk mund të kuptohet pa letërsinë e saj. Në krye të herës kisha dëshirën të shprehja ndjesitë e njëçasti të papërsëritshëm. Ofrimi i një miqësie dhe pranimi pa kushte i saj. Vetëm se një letërsi e mëparshme dhe një kulturë po e tillë e kanë përgatitur lexuesin- në çdo hap të kësaj largësie për të mos iu ndarë letërsisë. Kjo nuk duhet parë thjesht si një ornament zbukurimi i një shoqërie, por vet shëndeti i saj. Po të vesh re largësinë e një letërsie prej lexuesit mund të zbulosh të metat e një shoqërie dhe vet papjekurinë e saj. Unë do ta quaja këtë një nga ato të paktat dhunti që e bëjnë një komb apo një shoqëri vullnet të vetpastrimit të saj, përparim me vështrimin pas ndërsa vet tradita duket se gjendet përherë në timon, për të drejtuar anijen në një lundrim të mbarë. Rsti ideal i një lexuesi është Borgesi i cili me shumë modesti ka pranuar se para se të ndjehet shkrimtar

ai është ndierë një lexues i mirë. Prej këtij vullneti plus talentin e madh lindi një prej shkrimtarëve më të mëdhenj të kohës sonë. Shembulli se si Borgesi u afrua me letërsinë nuk na le shteg për ta veçuar atë si rast, por kthehet në një mësim të madh. Këto marrin vlerën e shpikjeve njerëzore sepse sjellin një proces shndërrimi të një qenieje që është duke e zotëruar më thellë e më larg botën rrethuese të saj. Ndoshta gjithçka nis me çastin se si ne i afrohemi një libri pasi kemi hapur kapakun e lexojmë rreshtin e parë të tij. Sa më tepër njerëz të hyjnë brenda kësaj kështjelle diturie, aq më e vogël bëhet frika ndaj së ardhmes. Njeriu brenda në libër del prej këtij labirinti tashmë falë mençurisë së përfutur gjatë leximit të tij. Falë asaj shkrimtarët ekzistojnë dhe vihen në kërkim të një letërsie më të mirë. Poezia moderne ose moderniteti vet në përgjithësi duket sikur përcjellin të njëjtat regjetime të një vuajtjeje të përbashkët. Përndryshe asgjë tjetër nuk mund të justifikojë nevojën e tij për të rilindur. Po ta shpërbëjmë ai do na jap po të njëjtin produkt: dhimbjen tonë prej ikjes për në muze të parmendës dhe shuarja e atij intimiteti, si të një tufe qirinjsh mbi varrin e së shkuarës. Nevoja jo për ta dëbuar por për ta përthyer nëpër vegimet e saj të shkuarën, është një lloj domosdoshmëri që ajo të bashkëjetojë me të tëra kohët. Kjo mizori ku ndoshta tmerrin më i madh vjen prej së ardhmes, e cila vetëm mund të përfytyrohet duke qënë krejtësisht e panjohur. Pra çfarë është moderne prej bashkëkohësisë duket sikur është tepër e huaj dhe e paftuar, ndërsa duhmba e saj i ka hapur dritaret nëpër ëndrrat tona. Jemi të dënuar për tu përqaftuar me të ndoshta edhe në vigjilje të një çasti sublim, kur ne sakrifkohemi për të ardhmen për të mbetur tek ajo një e shkuar sa më e afërme.

7.7.11-31.3.16

MËNGJESI I SË DIELËS

Analiza që Harold Blum i bënë poezisë Mëngjesi ai së Dieles të Stevensit shndërrohet në një merkato të ideve si vet poezia e poetit të shquar amerikan, një ngulmuese e palodhshme e asaj që thuhet në çast për tu bërë shprehje e një të ardhmeje tjetër të pritshme. Pra kemi dy synime që i afrohen po aq sa i largohen njëri-tjetrit. Ajo ndjellësja – poezia e Stevensit- dhe ai që i afrohet asaj- vet Blumi që guxon të matet me të si përjetësi që një çast i bëhet e afërt dhe pasi frymëzohet prej poemës , e tejkalon atë duke mos i dhënë dekoratën merituese për sakrificën sublime, të një mendjeje që po buronte nga vet gjeniu i saj, një Stevensi gati të papërsëritshëm. Në këtë betejë të mendjes ku aq shumë shpata janë thyer, mbetet për të gjykuar veç mendjen njerëzore si fillesën e vetme të asaj që iu paraprin luftrave të veta krejt asgjësuese. Jo më një trill por një domosdoshmëri për të kuptuar pse thellësitë tona bëhen sfida më e egër që na zhvendos prej përditshmërive, në kërkime që sjellin më tepër të mbytur se të shpëtuar.

6.4.10

PËRBALLË BORGESIT

Jam përballur përherë me inteligjencën katastrofale të Borgesit, i gjendur në një kufij të rrezikshëm për të përjetuar më te tmerrin e një vetëasgjësimi, si dhe frikën që e shoqëron atë si mister i së pamundurës. Ky lloj gjykimi ka kaluar përmes testeve të vazhdueshëm gjersa do të gjej tek unë prehje kur atë vendosa ta shkruaj. Jo më dogmë por si fundi i gjithçkaje dhe pse jo edhe i çdo lloj përfytyrimi. Borgesit duket sikur konsumon gjithçka me shpejtësi para se ne tek ai plotësisht të kemi mbërritur. Prej urisë së vet të përbindshme i zbrazi krejt bibliotekat dhe ne për t'i studiuar ato duhet të hyjmë brenda kujtesës së tij. Ose s'do të kemi asnjë mundësi tjetër. Ky përbindësh që e tejkalon edhe lirinë e përrallës për të mbajtur përgjegjësi para publikut e ligjit, duket se do të ketë më tepër punë me kohët që po vijnë se me bashkëkohësit që u mësuan me zakonet e mësuesit, të këtij manjaku të mistershëm-bibliotekë e gjallë e të gjitha kohërave. As një milion Borges të vegjël nuk e përballin dot atë, sepse ai u shndërrua në kujtesë të të gjithëve. Aq sa na lejon kufiri që na ndan prej pamundësisë ne mund të gjuajmë se dhe sa më e rëndë do kish qënë ajo që mund të kish shkruar. Ndoshta – mendoj – ai nuk u shua si qiriri në flakë por flakët në vdekje të tij ishin duke vetëtitur përbrenda. Sikur s'kemi më edhe ç'të themi veç ato duke i përsëritur me frikën se po kapim këtë kufi të rrezikshëm, ku ndodhet fundi i gjërave dhe i vet botës.

Borgesi është natyra siç e ka krijuar Zoti. Me po ato hire dhe elegancë si lumenjtë që e përshkojnë atë për të zgjuar elegjitet dhe baladat e moçme të njerëzimit. Borgesi bëhet kështu vet Ne por ne kuptojmë se ai na ka zbuloi la dhe kotësinë e përpjekjeve tona. Ai kish rendur për gjer këtu përmes shumë shekujve gjersa drita e syve të tij nuk mjaftoi dhe ai nisi të shihte botën me verbërinë e tij, ku ndoshta vezullon një energji tjetër emrin e së cilës ne ende dot nuk e kemi shpikur.

12.6.11

POEZIA SI MISION I PAPËRFUNDUAR

Poezia duhet të jetë e hapur për shumë kuptime njëherësh. Një mbyllje drejt një interpretimi të vetëm do të sillte dhe vdekjen e saj. Por mendoj se po aq e papranueshme është edhe një kritikë që e torturon atë duke e zbërthyer anatomikisht, sepse çdo lloj peshe na përcillet te një tjetër dhe ajo mund të shqyrtohet e tëra si një organizëm i vetëm dhe, mund të shpërbëhet njëherësh si trupi i një mumjeje, që bie në kontakt me ajrin. Herë-herë duket sikur kemi thënë gjithçka për poezinë, por mirë është ta shohim atë edhe si një mision të papërfunduar për të zbuluar njeriun e kohëve që vijnë, ku moderniteti duhet parë si një atavizëm i arkaizmit, atje ku mbruhet së pari vet poezia si ndjenjë. Tek ndjesi të tilla të thella si dhimbja dhe hareja, çmenduria dhe urtësia dhe gjithçka tjetër që është vetëm virtyti i lindjes si çdo lloj ilaçi që lind prej një bime të egër. Nëse jemi larguar pak si tepër prej idesë fillestare, po rikthehemi te natyra komplekse dhe njëherësh e brishtë e saj. Ajo që dhe kur lind prej vdekjes mëton të mbetet përherë e gjallë. Por a do të mundet vallë një poezi të jetë e hapur ose pasqyrë për të reflektuar çdo lloj ndryshimi?

25.12.18

ATJE KU SHUAJNË ETJEN DRERËT DHE SORKADHET

Unë u përpoqa t'i jepja poezisë një status tjetër. Ta shndërroja atë në një epiqendër ku përplasen tërë zërat, që nga ngashërimet e lindjes e gjer te klithmat e njeriut që përshkojnë përherë një zonë të rrezikshme. Një lloj ndjesie ku janë shkriret të gjitha në një çast që bëhet universal, për ta shpjeguar ekzistencën si një të tërë dhe të pandashme. Kur e vendosa njeriun përballë universit synoja që ai të bëhej vet universi për shkak të lidhjeve të panumërta me natyrën dhe kohën si ekzistencë e vet qënies. Kjo ishte një përpjekje krejt individuale përdërisa unë e pash veten përballë një pashpjegueshmërie dhe kisha zgjedhur pikërisht këtë kënd, prej ku po shikoja si në një pasqyrë të universit veten. Poezia mu shndërrua kështu në një lloj mjeti,/klauzole/ diçka jo fort e shpjegueshme por askush nuk i imponohet dot tjetrit me ligjin e forcës. Poezia kishte ardhur tek unë me një mision dhe unë u vura në shërbim të saj duke bërë një pakt me traditën, për të hyrë më vonë në lidhje të tjera me të letrare ose jashtëletrare. Sepse dhe unë s'kam tjetër përgjigje për gjithë atë që ka ndodhur ndërsa i bëja jehonë çdo zëri që vinte prej thellësive të mia. Pra arsyeja më çoi gjer tek universi i gjerë dhe i pafundmë, ndoshta dhe për shkak të fajeve të panumërt që mua me të më mbanin lidhur. Vetëm e vetëm sepse unë ekzistoj dhe

kërkova zanafillën time gjer në terrin e kohës, për të më sjellë gjer te drita e kësaj zanafille përbrenda njeriut. Poezia duhet të shkojë te burimi, atje ku shuajnë etjen drerët dhe sorkadhet, ose çdikush tjetër që ka ndalur vrapin këtu për tu shëruar me ujin e burimit plagët e veta. Duke u larë me ujë të bekuar, fjalët vetshenjtërohen dhe hapet një faqe e re e marrëdhënieve me botën. Pra vet gjuha supozohet që është nisur drejt vendeve të shenjta. Si nevojë për ta çliruar njeriun nga brenda. Energji të fjetura që nuk do të humbasin më kurrë luftën me realitetin. Jam i prirur t'i besoj këtij misioni që e zbulon njeriun aty ku ai është, duke pritur një përgjigje prej asaj që ai është duke zbuluar te vetja. Te burimi mund të ndodhin vetëm gjëra të mrekullueshme, sepse atje vijnë vetëm të eturit prej shkretëtirave. Dhe nëse ky blerim rritet, shkretëtira mund të kthehet në një oaz duke mundur të keqen. Kemi shumë pak mjete në dorë për të fituar luftën e madhe nëse nuk do t'iu drejtohem burimeve të ujit. Një magji që shpërthen prej errësirës dhe ndriçon këndet e fshehtë si pllaka të lashta tektonike. Ne të përditshmet tona jemi duke i shkelur me këmbë, këto gjëra të vyera dhe nuk marrim as mundimin për të trokitur në portat e këtij misteri. Atje janë përgjigjet e mëdha për ta shndërruar çdo çast të ekzistencës një hap për më tej, për të eksploruar se prej nga na vijnë fatkeqësitë dhe dhimbjet. Burimi edhe pse i fshehur na tregon udhën përmes dritës së ujit. Të fëshfërimave të largëta e pëshpëritjeve të thella për humbjet e dikurshme. Atje do të takoni dhe zanat dhe sirenat që dikur i patët humbur. Kam nevojë të hap përherë një libër për të zbuluar se gjer në ç'thellësi njeriu dikur e kishte zbuluar të fshehtën dhe, pse ajo mbetej përherë e tillë ndërsa fëshfërijnë në natë burimet e ujit. Te natyra që na ushqen shpresën se vetëm përmes gjelbërimit të

përhershëm të saj, me një lloj vademekumi në dorë ti po
flijon edhe trupin tënd, një parajsë e cila është ajo natyrë që
nuk pranon kurrë të bëhet varri një të shkuare.

4.4.18-16.2.18

UDHËTIM ME HOLUBIN

Në këtë udhëtim të gjatë kisha marrë me vete poetin Ne shquar çek të shekullit XX Miroslav Holub. Sidoqoftë një poet mjaft interesant, si një lloj laboratorit që lëviz ku vëren dukuritë e shpejtësive të vdekura. Ai ishte kriminolog i shquar i kohës së vet. Ja pse udhëtimi me Holubin po më çonte për herë të parë drejt një vendi të panjohur. Më shoqëroi mua Patrici si skllavin e tij. Jemi shumë të errët Holub për tu kuptuar plotësisht, prandaj kemi nevojë për këshilla dhe për ditë duhet t'i ndriçojmë rrugën njëri-tjetrit. Ti një çast aty afër Rios mërzhitesh në dorën time dhe tërhiqesh në botën tënde. As unë nuk të dua tani kaq afër dhe ndoshta kjo ka qënë dëshira e të dyve për tu ndarë e bashkuar sërish tutje Agrinjos. Është mërzi vërtet kjo natë i dashur mik nëpër këtë udhëtim kaq të largët. Nuk bëhet ndryshe përveçse duke u dashur e urryer. Nuk kemi shumë lexues por atyre që u kanë plasur sytë le të mos shohin. Ne po flasim për një lloj perspektive që përgatitet. Por dhe të tregojmë sa ajo është e kërcënuar. Në çast të rinisjes së miqësisë siç thashë pak më sipër përtej Agrinjos, unë vura re se ti mund të më shpjegoheshe më mirë përmes vetmisë sime të thellë. Ulërima janë ato miza që tani po fluturojnë mbi kufomën e gjeneralit pas një beteje të humbur. Fati i zi i dashur Holub me të cilin ti në laboratorin tënd duhet të merresh. Atje kulmoi poezia jote që do të bashkudhëtojë me njeriun që nata ia bënë edhe më të vështira përgjigjen e

pyetjeve të tua. Por vetëm më lutesh: sikur tani të ndalemi. Unë po fle se do të zgjoj topçiu dhe kambanarja e qytetit fiks në ora 6 të mëngjesit. Poezia jote Holub ndoshta jo dhe aq shenjë e vënë re, ka rënë si mortajë pas çdo mbarim lufte. Tepër fine për të rënë në grackën e retorikës, ajo vazhdon në një farë mënyre denjesisht atë që la pa thënë sa nuk mundi dot Kafka. Tani koha po mbaron Holub dhe unë duhet të shtrihem për të fjetur. Ti e kupton ç’dua të them por unë pikërisht tani nuk dua të dal prej librit. Ndërsa ti ose bota nuk ka ndryshuar aq sa të zvogëlohen në këtë farë feje poetët. Tani që ti je shndërruar në statujë ,si terrakotë e saj unë e kam më të lehtë nën krahë për të të mbajtur. Ti nuk do më qahesh më për përditshmëritë dhe për të shpëtuar duhet të hysh sa më shpejt në histori.

27.7.09

SHENJTËRIA E NJË ÇASTI

Jetën ma mbush me kuptim vetëm letërsia. Më duket se të njëjtën gjë pohonte dhe Brodskij. Është një tundim i jashtëzakonshëm që të ngre lart dhe shpëtimin ua beson vetëm këtyre çasteve të shenjta. Është ndoshta magjia e një iluzioni se po ia mbërrin çastit prej të cilit të tërë me përçmim janë duke iu larguar. Shkëlqimi verbues i përjetësisë, i një drite që shkrep befas në natën e errët. Ashtu siç të është shfaqur duke të kapur në një kurth marramendës s'e kupton dot që prej kësaj flake ti je duke u djegur. Ç'lloj energjie është kjo, burimi i së cilës këtë çast është vetëm ajo që ti je duke e ëndërruar më tepër se sa duke e jetuar. Po ç'dritë vallë e ndriçonte verbërinë e Borgesit, ç'injeksion i mrekullueshëm ishte ai që do t'ia mpinte krejt trupin Çehovit për t'i çliruar mendjen. Po Majakovski ekzekutor i vetvetes, njëlloj si Esenin, ndërsa Mendelshtami nuk u vetvra por e vrau mizorisht pushteti. Drita nuk mjaftoka njësoj për të gjithë dhe do na duhet shumë kohë për të zbuluar atë në errësirën e thellë ku drita rri fshehur. Duket sikur errësira e projekton vet dritën dhe jo e kundërta. Dhe çfarë rezultate të habitshëm që kemi prej këtij shkakut të thellë që kurrë s'kemi për ta shpjeguar. Si shumë mistere të tjerë të botës sonë, por ky bëhet edhe më i pashpjegueshmi, sepse duke mos patur asnjë lloj vegle në duar, i ve para njeriut pasqyrën për të parë thellësitë e veta.

4.8.09

PREJ NGA VIJMË, PËR KU SHKOJMË...

Ithash mikut tim, një shkrimtar jo fort i ri por në një moshë ku shkrimtarët e vërtetë piqen- të vazhdojmë diskutimin e nisur me përgjegjësinë më të madhe të mundshme. Po flisnim për atë që është duke u bërë traditë edhe pse janë duke e shoqëruar ende dilemat dhe hamendjet, sepse një gjë që është duke u krijuar mund të mos ketë ende një emër. Por sidoqoftë ne po flasim për diçka që është duke ndodhur edhe këtë çast që ne jemi duke folur. Kjo është një përparësi e madhe sepse jemi duke thithur të njëjtin ajër dhe ndoshta jemi duke u parë në të njëjtën pasqyrë. Po flasim për bashkëkohësinë e cila është ajo gjëja e vështirë për tu klasifikuar, sepse vera e saponxjerrë prej rrushit nuk është ende plotësisht vera që kërkon kohën e stazhonimit të saj. Errësirë dhe vetëm pakëz dritë para se aroma e saj të ketë shpërthyer prej shishes. Pak më vonë ajo do të bëhet shije, shije e kënaqësive tona. Një letërsi kthehet në traditë prej leximeve të shumtë si një lloj kudhë ku rrihet ky hekur i nxehtë për tu bërë diçka tjetër. Por ç’është kjo gjë tjetër përveçse kujtesë, përveçse shtim i dijeve dhe plotësim i mungesave, zbulim i nevojave, vënia e gishtit mbi plagë, dalja në dritë e një errësire të thellë. Nëqoftëse këtë traditë ne as që e konstatojmë dot sepse ajë ndërkohë është duke u shndërruar si e tillë, sepse ajo përshkon një rrugë të gjatë e të vështirë dhe herë-herë të kontestuar. Traditë, dmth shtim i diçkaje ose bashkëngjitje, ose ngjitje në njëlartësi tjetër si

fakt që ndihmon edhe vet traditën e mëparshme. Miku im këmbëngul se Poradeci është nyje e letërsisë shqipe prej së cilës mund të shihet më qart e djeshmja dhe e sotmja. Por unë i gjykoj gjërat pak më ndryshe. Pa e mohuar Poradecin unë dua të le hapur rrugën për të mirëseardhur pak më shpejt të rinjtë dhe letërsinë e re, e cila i kap më shpejt kuotat e larta. Por problemi është se si në tërë këtë traditë këto vlera mund të qëndrojnë së bashku dhe duke qënë letërsi e një gjuhe të vetme, të jetë edhe e krahasueshme mes vetes. Prurjet e reja zakonisht janë dhe të ndrojtura por janë dhe përvoja kulturash e absorbimesh të thella, ngjizje me traditën e të folurit, me gjurmët më të hershme të shkrimit, kapërcim më i shpejtë i kufijve që mund të kanë ngurtësuar letërsinë në një lloj rrethimi, prej ku është e ndaluar hyrja e të tjerëve. Unë jam i hapur duke propozuar shpërthimin e rrethit, ku vlerat e reja nuk janë më të kushtëzuara vetëm e vetëm prej traditës.

6.8.09

NJË LIBËR SI PESHË NË DORËN TËNDE

Pas leximit të parë rrethohesh prej një flake që duhet shuar me afshin e parë ose ta dërgosh atë që ke lexuar për udhëtim të largët si hakmarrje që ajo nuk arriti dot të të merrte me vete. Kjo ndoshta nuk ka qënë detyra jote si lexues. Sapo je ndarë prej një dikushi që më parë nuk e kishe njohur prej një lloj trajte të paformuar ende ndaj së cilës ti të jepet detyra për të krijuar diçka tjetër. Si të thuash ti po lexon një libër për të vendosur fatin e tij me një udhëtar më shumë ose me një që s'është më asgjë, as bashkudhëtar dhe as i regjistruar gjëkund. Libri më kishte pritur për t'i treguar munxët. Kur e çova aty ku e kisha gjetur, nën atë hije bliri tek po më priste në heshtje. Po pse vallë nën një hije bliri? Siç do ta gjykoja unë më vonë ai po performohej prej aromave të luleve të kësaj peme të bekuar. Kjo ma shtoi kuriozitetin për të vëzhguar shkallën asociative të mendimit tim, i cili po e krahason librin me një prostitutë. Sidoqoftë unë e lexova atë dhe ndoshta isha lexuesi i tij i parë dhe i fundit. Tani kam dal me të në dorë për t'ia dorëzuar atij që ia mora, ose për t'ia çuar atje ku ai do të kishte bashkë çerdhen dhe varrin. Kjo po më dyzon ndërkohë që këtë rrugë po e bëja shpesh kohët e fundit. Unë po sillem padrejtësisht me të sepse mund t'ia çoja dhuruesit me mirësjellje dhe një varg këshillash të miat. Por isha trembur për vdekje prej rrezikut të një epidemie që po bëhej gati të hynte brenda meje. ose unë në qënien e saj të hyja

përmes portës që ajo e kish harruar hapur. Kohët e fundit thashë - dhe mu drodh tërë trupi sepse prej një inondate unë i tëri isha shpërthyer, ose thjesht kisha mbetur pa mbrojtje. Po ti që tani atë e shkruan? -pyeta veten - a je i sigurt se ke përgatitur një lloj lexuesi? Dhe mu rrëqeth pena në dorë prej një gërvishje të saj mbi lëkurën time. Një pikë gjaku kish shpërthyer prej fjalëve që me zor brenda shprehjes i kisha futur. A e zotëron ti vallë masën e cila e lejon penën për t'iu ngjitur nga posht sipër në majë fijos së letrës? Pak më parë kisha lexuar ca shënime të një kritiku të madh, të cilat më kishin lëkundur shumë nga bindjet e mia estetike. Po ta pranoje atë shkrim në letër do zbrisja posht e më posht dhe s'do kish më gjasa fjalët e mia më lart për tu ngjitur.

12.8.09

RRJEDHA ËSHTË VET KËNGA E UJIT

Mënyra e të shkruarit është vet thelbi i artit. Mos u përsillni nëpër shpjegime të tjera që mund të mos u çojnë asgjëkundi. Vetëm atje kërkoni dhe me siguri që gjatë kërkimit ka për të buruar uji. – Ujë-thash- sikur kisha thënë jetë për ta shuar etjen e vet udhës. Nëse kemi vërtet ide ato duhet të vijnë njëherësh me forcën e tyre shpërthyesë. Jo thjesht si dije e mendjes për të kapërcyer mërzinë. Rjedha e lumit është vet kënga e ujit. Ne e ndiejmë se si po fryhet nga të katër anët lumi. Te rrjedha dhe shtrati dhe te dëshira e ujërave për tu kthyer, për të mbetur te kjo kënetë që do ta kish zhveshur lumin prej perspektivës. Atë që e tha i pari Herakliti ne e përsërisim pa u turpëruar para Mësuesit, edhe pse e artikulojmë atë me një mijë e një gabime. Por ne guxojmë ta themi si Pjer Menari që e shkroi nga e para Don Kishotin pa i hequr asnjë presje. Por në mes ishte koha që tani s' ishte me Kishotin e Servantesit, sepse janë 500 vjet dhe nëpër to përsëri lumi i Herakliti ka rrjedhur. Vetëm ky paska që në çelësi që misioni i artit të mbretet përherë i papërfunduar, sepse Herakliti e tha që çdo masë uji që rrjedhëne të e bënë çdo lumë të papërsëritshëm.

31.12.16

LIBRIN E SHFLETON ERA

Ti erë që hap librin e mosdijeve tona. Dhe sikur të mos vinte kjo diçka nga brenda, kurrë s'do të kishim patur një libër të hapur. Dhe kurrë s'do të kish patur eksploratorë dhe vetvete të dala prej vetes. Krejt errësirë nga jasht dhe brenda. Lëkurë në mish e ngjitur dhe ky libër i tharë që vazhdimisht do shkërmoqej. Po fryn zonja erë dhe librin e hapi së pari nga brenda. Të gjallët ngjallën të vdekurit e tyre sepse dalëngadalë gjuha po bëhej kujtesë dhe fara e njerëzore mbillej e korrej në një cikël që rrezikonte të ishte i përjetshëm. Dhe atëherë u pa se përjetësia nuk mund të ishte ndërgjegje dhe era hapi fletën e parë të librit, ku së pari dolën ca gërma si eshtra të bardha të shumë e shumë të vdekurve. Liria pa cak qe bërë pengesa kryesore për tu kufizuar te konkretësia e gjërave dhe e vet ekzistencës. Prej librit -lëkurë njerëzore po shqiteshin një nga një fletët dhe u pa se vdekja ishte shenjë jete por nevoja për ta shfletuar edhe më tej librin u bë e papërballueshme. Tani syri më parë se thika vrasëse, lotët njëherësh e mbushën lumin para se të nisnin shirat e vjeshtës. Rruga qe hapur për të mos u mbyllur më kurrë dhe përjetësia prej përkohshmërisë vdekatore qe mundur. Por njerëzit ua kishin falur pushtetin mbretërve që nuk do t'i lejonte më ata të hynin nëpër shpella. Qe mbyllur kështu një nga epokat më të gjata të njeriut së cilës akoma nuk ia kemi në dorë fillin. Prej mijëra e mijëra vjetësh dhe vetëm prej atëherë filloi numërimi i ditëve përmes hapjes së faqeve të këtij libri që kurrë më s'ka për tu mbyllur.

3.3.06

ROBËRI E NEVOJSHME

Nis ai tension i zakonshëm i shkrimit. Më ngatërrohen duart nëpër letra. Le një bllok për të marrë tjetrin. Një lloj prangosje e ëmbël e cila është duke të kumtuar se ka edhe robëri të nevojshme nëse harron vërtet se ti je vetprangosur. Por mund ta quash edhe festë ose dhe diçka tjetër. Sidoqoftë përjetimi është krejt i veçantë dhe pothuaj i papërsëritshëm. Někëto çaste unë u kam besuar zotave që largojnë urdinë dhe më hapin rrugën. Mba në dorë një timon që më dridhet prej ngërçit por për atë që shkruaj vetëgjykimin e ruaj për më vonë për të mos u prishur magjia e shkrimit. Mos ka qënë vallë kjo një lloj lumturie që unë e kam refuzuar duke pranuar më mirë këtë dënim se sa të humbisja në orgjitë e saj? Për çfarë po dëshmoj nuk ka për qëllim të mbrojë atë që kam shkruar. Ajo është krejt tjetër dhe këtë çast larg objektit tim. Deri më tani nuk kam zënë në gojë se cili është gardiani që duart m'i ka lidhur. Jo, unë jam duke folur për diçka krejt tjetër, për çastin kur ti te krijimi je zhytur. Pjesa tjetër që të tërën në vetvete e përfshin këtë çast këtu nuk është e pranishme. Çasti i të lindurit, i flakëve që ngrihen mbi zjarret, por edhe i diçkaje tjetër më të thellë që gjer më sot ka mbetur pa emër. Ajo që vet i trembet vetemërtimit të saj prej frikës së zhbërjes. Ajo që është këtu për të tjerët por që nuk mundet dot ta shpjegojë veten.

7.2.08

RRETH LASGUSHIT DHE TRADITËS

Dëgjoj shumë mbrojtës të poezisë së Lasgush Poradecit, entuziaztë e fare të pakëshillueshëm me faktet. Më tepër i kam gjykuar ata si mbrojtës të vetes dhe i kam falur. Pa patur për qëllim të denigroja aspak poetin tonë të madh, atë që gjithësesi nuk do ta le jashtë përsiatjeve të mia. Po e them hapur qysh në fillim, njësoj si të tjerët me zemër e me arsyen e shëndoshë që s'më le të bëjë gabim tjetër. Lasgushi është pema që mbiu në atë kopsht dhe e bëri poezinë shqipe fatlume. Por më duket se gjer këtu mbarojnë referencat e mia dhe më duhet të shqyrtojë me kujdes faktet, për të shprehur atë që unë mendoj se është e vërteta. Duke pohuar njëkohësisht se kjo përbën një çështje prej ku varen shumë e shumë gjykime të cilat në mjaft raste i kalojnë edhe kufijtë e një ekzaltimi fëmijëror. Unë sapo e kam hapur Kutinë e Pandorës dhe personalisht guxoj të shoh vetëm të vërtetën. Por gjykimi im nuk është agresiv veçse një përpjekje për t'i vendosur në kohë vlerat dhe për të shkarkuar gjykimin prej emocioneve. Detyrë shumë e vështirë aq sa dyshoj te vetja në do të kem aq fuqi atë për ta mbrojtur. Por po eci ngadalë përpara dhe poeti më shfaqet brenda kohës së vet, të një kulture që kish mundur të mbijetonte për atë që dha për ta ruajtur identitetin e kombit të vet. Më duhet të shënoj gjërat me kujdes sepse e di që po shkel në një terren të minuar, ose mbi një tabu që edhe mund ta kthejë të tërën në një bumerang. Por këtë

po e bëj brenda fuqive të mia dhe ndërgjegjes sime duke respektuar dhe të tjerët për atë që synojnë forcën e logjikës dhe argumentit. Duke qënë hera e parë që marr pjesë në një debat të cilin do ta dëshiroja të hapur dhe përgjithësisht letrar dhe estetik, e ndiej se jam duke bërë një sakrilegj dhe mund të anatemohem si shkatërrues i simboleve. Por unë thjesht dua që simbolet të jenë në vendin ku duhet me peshën dhe autoritetin që i lejojnë të tjerët të afrohen për t'i gjykuar. Lasgush Poradeci shkroi poezi përgjithësisht rreth viteve '30-40 të shekullit të kaluar, në një kohë kur letërsia por sidomos poezia shqipe sapo ishin ngritur në këmbë prej një tradite jo dhe atë për tu vetekzaltuar. Nëse veçojmë De Radën të tjerët në kontekstin evropian ishin ende larg . Sepse një vlerë konsiderohet e tillë kur bëhet e krahasueshme, e matshme me atë botërore evropiane e, pse jo mjaft do të kish qënë edhe ballkanike. Lasgushi ndoshta e nxorri letërsinë shqipe prej këtij ngërçi por thjesht nuk arriti dot ta bënte atë të krahasueshme. Ai është i pafajshëm sepse bëri atë që mundi por ndërgjegjen ma rëndon fakti që supelativizohen vlerat e poezisë së tij duke e bërë atë ballkanike, evropiane e pse jo edhe botërore. Kjo është si ta lëndosh ndërgjegjen artistike duke përkëdhelur atë kombëtare. Por gjithësesi asgjë nuk fitoj edhe prej kësaj . Ndoshta hapja e kësaj çështjeje synon për më larg në vlerësimin objektiv që na duhet t'i bëjmë së shkuarës sonë, e cila duhet gjykuar në kompleksitetin e saj. Po ashtu edhe kultura e letërsia e saj. E kjo e fundit edhe atë më tepër. Glorifikimi e himnizimi i saj shndërrohet në një pengesë, me një të ardhme edhe më të paqartë për të zbuluar pikën se nga duhet të nisemi për t'i vënë tërë vlerat në balancë. Kur këndonte Lasgushi, Evropa/jam duke folur konkretisht për poezinë/ kishte hapur katërkanatësh portat e Njeriut.

Të Njeriut flas të fillimshekullit dhe shqiptare të atij që s' ishte akoma evropiane. Këtu sprapsen argumentet e mi dhe kundërshtuesit mund të nxjerrin në çast 'shpatën' për tu hakmarrë. Dhe prapë them se Lasgushi s'ka faj. Ai bëri më të mirën e mundshme për letërsinë shqipe falë talentit të tij të madh. Po në Evropë në atë kohë dëgjoheshin të tjera kambana. Poezia tanimë Atdheun e vet e kërkonte te njeriu, te një lloj ekzistence që kushtëzon vet rrjedhat e kohës. Zbehja e frymës romantike për të dhënë sinjale se poezia mjaft ishte vonuar duke u zvarritur pas kohës, pas ndodhive të cilat të cilat duke i bërë objekt të saj, gati ishte duke i dhënë atyre karakter historik. Poezia e fillimshekullit XX e çliroi prej kësaj barre atë dhe e shndërroi veten për vete në një klithmë njerëzore përpara rrezikut të tmerrshëm të mbylljes së perspektivave. Nuk jam ndonjë apolinist i thekur por po e ilustruj argumentin tim me poezinë e Apolinerit. Ai shkroi herët për të vdekur fizikisht herët por për të jetuar më gjatë, për atë që sot konsiderohet si shenjë se poezia braktiste diçka për tu hedhur në strofkën e luanit, për tu ndeshur me atë për jetë a vdekje. Koha e jetës, e poezisë dhe vdekjes së tij sillen rrotull Luftë I Botërore. Por Apolineri që e zbriti poezinë tek transhetë e luftës për më tepër se kaq kish rinovuar krejt konceptin e poezisë përmes detajit, e fshiu pothuaj krejt të shkuarën dhe përmes një ligjërimi sa mendimtar po aq edhe filozofik por mbi të gjitha me diçka të padëgjuar më parë-ekselencën poetike, tregoi se si në të vërtetë po ndodhnin gjërat, ai realitet që tani e tutje do të reflektonte ndryshe në të ardhmen. Është pikërisht koha kur fillonte ligjërimin e tij Lasgushi ynë, kur ende Shqipëria s' ishte bërë dhe kjo vonesë historike e dëmtoi rëndë talentin e tij të fuqishëm, si të thuash e kushtëzoi atë, por kjo i solli një dëm të madh edhe poezisë dhe kulturës, e cila sidoqoftë

edhe me shembullin e Poradecit nuk i paparapriu dot zhvillimeve të ardhme. Ku pohojmë këtë kemi parasysh problemin në thelbin e tij që e përjashton çdo rrethanë, e cila më vonë do të shpallej fajtores për atëqë s'mundën ta sillnin atëhere, ku të tëra nevojat ishin urgjente. Poezia nuk besoj se është ajo Zhan D' Ark që do ta ngrinte në supe Atdheun, por do ta ndihmonte atë sadopak për ta nxjerrë përtej greminës. Aty ku ka qënë devijimi prej misionit të saj e cila i zhbëri tragjikisht vlerat duke e bërë përfaqësuese të një kulture - mision që poezia besoj se kurrë nuk e ka patur. Diskutimi i për t'iu shmangur këtij kurth, prandaj synon që të mbetet përherë brenda poezisë, sepse jo përherë statusi politik i një vendi përkon me nivelin e poezisë apo dhe të kulturës në përgjithësi. Irlanda është një shembull i tillë ku edhe pse me status politik ende të pazgjydhur është vendi i gjenive. Tek shembulli i Irlandës, këtij vendi e populli të vogël ne po heqim një paralele historike ndoshte edhe të panevojshme, por unë që këtë çast duke lënë pas të shkuarën, ia mora dritën asaj për të ndriçuar të ardhmen. Pika e nisjes së saj ndoshta do të ishte një lloj reflektimi ndaj vet së shkuarës, zgjimit të energjive të fjetura për të fituar kohën e humbur. Poradeci dhe në përgjithësi poezia shqipe si traditë ne nuk na turpëron, por duke këmbëngulur tek ajo si pikë referimi e vlerave të larta artistike, ne i sjellim një dëm vet zhvillimit të lirë, me një Vete të mbyllur brenda kornizës kombëtare, ku shfaqet natyra por jo njeriu. Ja pse poezia edhe sot në shkallët më të ulëta të saj, ushqehet me romantikën e dikurshme si ngushëllim i asaj që s'jemi dhe kur duhej të ishim ndryshe. Por kënga vazhdon të këndohet në po ato brigje, me cula e dajre, ndërsa kulti i poezisë sa vjen e po zbehet e përmytur prej euforisë së dixhitalizimit.

25.1.06

MË SHUMË I PUSHTUAR SE PUSHTUES

Ka ca poetë të cilët i mendoj si fundin e poezisë, sepse nuk e di se më pas gjë tjetër më e bukur mund të shkruhej. Kufirin e ëndërruar ti e kishe mbërritur papritur. Sepse më parë të gjithë atë e kishin sulmuar. Tani u bë e qartë se sulmi nga kjo anë u kish dhënë një farë zgjidhjeje tërë përpjekjeve tona. Mos vallë tani duhet të bëjmë aktin mizor dhe tërë ç’kemi shkruar duhet ta grisim? Më jep fjalën se ti as në mendje nuk do ta shkoje një diçka të tillë. Dhe më parë le të shqyrtojmë gjendjet tona. Por sikur për një çast ta mendosh atë që është arritur si diçka tënden? A s’ke qënë edhe ti aty kur ajo ishte shkruar. A nuk i shfaqeshin edhe atij në pasqyrë këta imazhe dhe të gjithë së bashku kishim bërë atë që do t’i bënte pjesëmarrëse në histori edhe masat? Dhe mendo si tani bota që pushtuar vetëm nga njëra anë e saj, prej ku këtë çast duken edhe më mirë anët e tjera të pambërritshme. Atëherë sulmoni të tërë së bashku edhe pse vetëm njëri do ta mbërrijë atë majën tjetër. Por edhe ai nuk ka qënë kurrë i vetëm. Ai na e pohoi vet këtë duke deklaruar se për më tepër në këtë majë ndiehej i pushtuar më shumë se pushtues.

21.1.08

KUSHTI I NJË POEZIE

Poezia në vetvete është simfoni e shumë zërave, ku çdo zë domosdoshmërisht duhet të jetë i përveçëm. Flas për poezinë në përgjithësi por në veçanti edhe për poezinë e një poeti. Por si mundet vallë që dhe ajo që s'na pëlqen në këtë shumësi zërash pa u grindur me të tjerët, të krijojnë këtë harmoni tingujsh? Ky vështrim që shkon përtej poezisë nuk na pengon për të parë se ç'ndodh në këtë përzierje tingujsh e që vijnë prej sintonive të ndryshme e të pidentifikueshme, të ngatërruara kaq keqas me njëra-tjetrën, tragë e humbur e çdonjërit në trupin e një tjetri, që si detyrin ka për ta çuar atë më tej duke e mbartur me vete. Dhe jo vetëm poezia, por tërë ky shpëstjellim njerëzor që sakrifikohet për tu dhënë emër epokave dhe, befas në horizont mund të identifikohet si një yll me një ndriçim fare të dobët. Kthimi sërish të poezia nuk është se i shton diçka tjetër të veçantë problemit, por në zërat e saj janë edhe ata që kurrë s'kanë mundur të flasin. Për shkak të rrethanave të pafundme ata kanë hyrë nëpër rrjedha të tjera, ndonëse si bisht i kësaj komete fluturuese atë janë duke e tërhequr pas vetes.

Ajo që po shkruaj nëse është gjë krejt e veçantë do më lodh dorën për të nxjerrë mikrobet e lëndës nga brenda. Ajo do të shtypej e shpërfillur nëse do të ishte diçka e zakonshme prej këmbëve të turmës në rrugë. Duhet të kisha ndalur frymën më parë për të provuar asfiksionin dhe pastaj

ta kisha hapur rubinetin e oksigjenit, që mushkритë e mia ta thithnin të etura ajrin e pastër të mbushur me aroma lulesh. Jo, mos e shkruaj atë- më kishin folur zërat që nuk ishin të së sotmes por ata që më prisnin në të ardhmen time. Pa timbrin e saj fjala bie te vendi i saj e pafuqishme, ku pluskon si kënetë një gjuhë e vdekur. Dhe mos e lësho dorën prej harkut që tani plotësisht është nderur. Ky tension duhet përcjellur për të mbërritur te pika ku ti ke shënuar. Shpejtësi sa një shkulumë fryme dhe kohë që nën ritmin e hapit tënd ti atë të tërën e ke zotëruar. Një pamundësi e ke mundur, ke mbërritur diçka dhe përtej kohës. Ti nuk e di ende çfarë ajo saktësisht është, por dëshmia që vjen pak më vonë ndoshta vetëm pas 100 vjetësh mund të verifikohet. Por ti e ke bërë detyrën. Ti zgjodhe penën që majën e saj e kish ngjyer te gjaku yt. Ti ke triumfuar por këtë s'ke për ta provuar kurrë ndonëse prej një ndjenje të tillë si fëmijë ndjehesh i përkëdhelur.

30.3.08 - 24.3.08

DËSHIMI SI MËSIM I HIDHUR

Dua t'i largohem sa më shumë përshkrimit të ngjarjes. Trembem se duke hyrë në të frymëzimi ka për të më braktisur. Dhe si mundet vallë ta shkruaj këtë tregim pa e treguar vet ngjarjen? Apo mos vallë ndoshta më lejohet ta kapërcej atë duke u marrë me përjetimet e mia si dëshmitar okular i saj? Atëherë po e nis nga kjo pistë; si mund të shkruash përshembull një tregim që fillon me ...'Kur mua nisën të më hanin ujqërit...'A s'është i tmerrshëm dhe pothuaj e pamundur. Qoftë edhe sikur të isha duke folur për një ëndërr. Ja pse nguroj ende ta nis tregimin ku e para frazë mund të qe kjo : '... Ai goditi fort me grushta e shqelma, ndaloi makinën në anë të rrugës dhe pasi hapi derën e flaku atë në rrugë dhe, duke qeshur e ngau makinën me një shpejtësi ulëritëse në autostradën e madhe jashtë qytetit. ...' Por mos vallë nuk kishte ndodhur vërtet kështu? Nëse realiteti artistik s'e pranonte, të paktën estetikisht duhet të ishte i justifikuar. Por fraza e dytë mund të dëshmohej edhe më e vështirë se e para por njësoj edhe e pamundur ,se pas këtij tmerrri që ti kishe përjetuar,me një lëvizje të dorës i ke dhënë fund gjithçkaje. Po sikur të vazhdoje kështu: '...Kur ujqërit më kishin ngrënë të tërin...' . Por një krijues i ndërgjegjshëm edhe këtë shans do ta kishte humbur fare lehtë. Po t'i kthehesh versionit fillestar, atij që qe dhe vet shtysa e këtij tregimi, fraza e dytë nuk do të vazhdonte më me ngjarjen, por vet ai shok që një

shkrimtar përjeton si dëshmitar i një ngjarjeje, të cilën e ka për detyrë morale dhe çështje nderi ta shkruaj. ‘ Ajo e vetme në autostradën e madhe në periferi të qytetit qante duke ecur. Po binte mbrëmja dhe figura e saj e ndriçuar nga dritat e shumta të makinave i ngjante një perëndeshe, që po kthehej prej lashtësisë së saj në kohën e një çmendurie...’ Por lapsi më qe rrëzuar përsëri mbi letër dhe e kuptove se në vend të asaj po shkruaja dramën time, domethënë unë duke vrapuar nëpër autostradë për t’i shpëtuar ndjekjes së një tufe ujqërish të çmendur. Tregimi as kështu s’mund të shkruhej sepse një autor-viktimë e ka në dorë të drejtojë rrjedhën e tragjedisë diku tjetër. Një tregim i tillë-vendosamë nuk mund të shkruhej.

24.3.08

SHKRIMTARI

Një shkrimtar i mirë është edhe një mendimtar i mirë. Ai nuk hynë në debat si mendimtar profesionist por thjesht për tu bërë një zëdhënës dhe injekton te fjala përplasjen, për ta çliruar mendimin prej rutinës së përditshme. Duket sikur shkrimtari hynë në betejë duke kërkuar falje se këtu ai ndodhet pa dashur. Një shkrimtar i mirë është zot i dyshimit dhe si i tillë ai pa u deklaruar ka hyrë në parcelën e atyre që e përdorin fjalën sipas dëshirës së shkrimtarit, më së shpeshti kur marrin fjalën nuk ta japin dëgjimin në sallë të gatshme. Duke e mbajtur më gjatë te gjuha e kërkojnë atë kur ndiejnë tu kërcasin dhëmbët dhe sa e lëshojnë në ajër ata nuk i panë njerëzit në sallë që zgjatnin krahët për t'i kapur. Shkrimtari u bë kështu një nevojë dhe hyri në betejë për të ruajtur nderin e fjalës. Në çdo pedestal të ngritur në qytet do gjejmë një shkrimtar të tillë, i cili më tepër se i përdorshëm si nevojë bëhet një lloj perëndie që ata kurrë s'kanë për ta njohur. Duke u rifutur në këtë betejë ata përdorin tërë arsenalin e fjalëve dhe të kësaj shprehjeje të urtë që doli përmes shpërthimit të mburojës së dhëmbëve, që e kafshonin egërsisht për të mos e lejuar të delte jasht qytetërimi i ri i cili më parë duhej shpallur. Dhe që prej asaj kohe unë jam ndier pak Gilgamesh dhe Homer më shumë dhe në parkun e madh të qytetit kam takuar tërë bardët. Dhe ç'pash ishte një figurë e mrekullueshme kjo prej së cilës pushtohesh prej diçkaje që ende s'është brenda

teje dhe të bënë ty njeri krejt të lumtur. Ndoshta ky është shkaku pse u lind njeriu për t'i bërë dhe sendet të flasin në gjuhën e tyre dhe si dëshmi të fundit se, dikur nëpër këtë pafundësi njohjesh njerëzit kishin nisur të këmbenin një mall të padukshëm, atë që ua kish shkurtuar shpesh rrugët e gjata dhe e panë veten të verbuar prej një drite, që u kishte shkrepur në mendje. Dukuri të tilla zbulon shkrimtari. Duke ndjekur hap pas hapi njeriun ai zbulon dhe atë që ai nuk e ka shprehur akoma. Sepse tani për të udha është e hapur. Ai nuk përqafton më duke kafshuar por janë vet jalët që i çojnë këto mesazhe të mrekullueshëm, ku nisin të bashkëjetojnë kaq shumë e shumë njerëz që takohen nëpër faqet e një libri, pa e njohur kurrë më parë njëri-tjetrin. Shkrimtari bëhet kështu mendimtar duke endur kuptimin e fjalëve.

23.5.19

BASHKËBISEDIM NË HESHTJE

Një mënyrë shprehjeje e cila ka në bazë veprimin jo fjalët. Fjalët në të mungojnë krejt dhe ti vetëm sa i përkthen veprimet në fjalë. Nis me të një bashkëbisedim në heshtje. Njeriu përballë nuk të flet por vetëm përmes asaj që ai është duke fshehur përpiket të tregojë në një mënyrë tjetër zemërimin apo mërzitjen, ose ndërprerjen këtej e tutje të një marrëveshjeje që mund të kishte mbërritur në një pikë të rrezikshme. Por siç thotë një fjalë veprat flasin më shumë se fjalët. Dhe ti nis leximin e heshtur të tyre në një rend pak a shumë të njohur-një kthim shpine, zhvendosje e vështrimit në një objekt dhe në fund një braktisje si për të na kumtuar se ti nuk je më ti. Ndoshta atje ku përgjohet hiçi, asgjëja. Por ai që tani shkruan dhe ti që lexon jini të përfshirë në ndjesi të thella. Çdo veprim tani thotë mijëra fjalë me një xhirim tepër të ngadalshëm. Botët tona shpalosen duke mbyllur atë që pak më parë ishte hapur. Zona e keqkuptimit tani është zgjeruar mjaft dhe ti me dyshim të duhet të dalësh prej këtij libri. Dora që e shfleton atë në të kundërt tani ka një ritëm tjetër nga ai në hapje. Dhe jemi duke dëgjuar një muzikë tjetër të veprimeve të shkarkuar prej fjalëve, një lloj funebriteti shoqëron shkëputjen dhe vdekjen e fjalëve brenda veprimit. Dhe ndërsa prej veprimit tani çlirohet vet energjia e fjalës ajo që merr një ndriçim tjetër, sepse fjala në të tani është duke u djegur, pra u shpreh dhe vetëm si energji i jepet një diçkaje tjetër, duke i shtuar kuptime të tjera vetë udhës.

19.5.08

PËR ALLEN GINSBERGUN DHE NËNËN E TIJ

Për ta shkruar këtë duhet një përqëndrim shumë i madh. Përndryshe nuk mund ta mbash nën kontroll të rreptë agresivitetin, përmes së cilës ana njerëzore jo rrallë herë mund të shfaqet. Të çmendurit nuk janë aq të rrallë sa të mos vrojtohen si një dukuri haraçin e së cilës shoqëria është e detyruar ta paguaj. Kujto këtu spitalet psiqiatrikë pa numër, qendra të rehabilitimit të tyre dhe mbi të gjitha si plagë, korja e së cilës kurrë s'ka për tu tharë. Gati si një temë tabu që edhe letërsia nuk guxon t'i qaset. Jam i prirur ta shikoj atë si një dhimbje njerëzore dhe të qa njëlloj si Allen Ginsbergu që është duke shkruar poemën Kaddish, kushtuar nënës së tij të çmendur. Te ky guxim i tejskajshëm është një shembull i rrallë se si mund të operohet shumë thellë në problemet e shoqërisë, për të parandaluar përkeqësimin e moralit të saj. Ose siç e prek këtë temë Kafka te Metamorfoza. Po ç'janë në të vërtet këta njerëz të flakur në margjinë të shoqërisë? Mos janë vallë ata më afër kafshës me tendencë për t'iu larguar përherë e më tepër vet natyrës njerëzore? Sa herë i afrohemi kësaj flake njëherësh dhe i largojmë duart prej saj. Asnjë njeri nuk mund të ketë lindur i çmendur por shumë prej tyre janë në pritje në paradhomën e një çmendine. Ata që kanë qënë midis nesh dhe na luten për të mos i braktisur. Ata kanë plot parandjenja të këqija dhe u tremben atyre për vdekje. Ja pse ulërijnë përballë murit të heshtjes sonë e indifernetizmit.

Një spital në periferi ku ata burgosen e vdesin së gjalli. Por Ata sa janë ende gjallë janë, edhe njerëz. Ata i sëmuri shoqëria e cila përmes tyre shpreh vet sëmundjen e saj. Ata u marginalizuan që ne të hapim themele duke vendosur në to eshtrat por më parë vet shpirtin e tyre. Ata ishin dikur njerëz, një dhimbje e skajshme ulëritëse si plaga më e majisur e vuajtjes sonë të përbashkët. Si mund të shpëtohen ata vallë nëse ne më parë veveten nuk e kemi shëruar edhe pse nëpër kavjet e çmendinës, shoqëria është duke eksperimentuar për të zbuluar kurën morale të saj.

29.8.07

INGEBORG BACHMAN

”Një dorë ujë hodha mbi këto vende, që ato të bleronin si varre...”- Ingeborg Becham. Më tej unë duhet të shndërrohesha në shërbëtor, sepse fjala e kish mbërritur majën prej ku fëshfërinte si diçka e përbindshme. Unë më pas veç kam heshtur klithmën time që të mos e dëgjonin të tjerët. Unë e di çfarë Beckham ka patur në mendje kur këto fjalë i kish shkruar dhe po i kërkoj falje sikur unë të isha i pari që atë e kisha përdhunuar. Kohët e foljeve prishen nga pamundësia e fjalës për të mos u shprehur. Ingeborg e mrekulluar para zbulimit i spërkat me ujë ato vende që gjithësesi dihet se do të bleronin si varre, ku tani është duke vdekur dhe lumturia më e madhe. Ingeborgu pohoi një të vërtetë ndaj së cilës unë për fat të keq duhet të bëhem gjykatës i saj, që tashmë ka bleruar mbi shumë varre. Si një gjë të pashmangshme të krimit që është pjesa më e tmerrshme e vetes sonë, të cilën për ironi të saj e kemi mbuluar me trëndafila. Ç’po bëja unë më 26 shtator të vitit 1973 kur në shtëpinë e Ingeborg Bachman ra papritur zjarr dhe poetja e madhe e gjuhës gjermane në flakët e këtij zjarri kishte vdekur? Mos vallë vuaj prej kësaj sindrome që të fiksoj vetëm kohët e të vdekurve? Më 26 shtator 1973 bota tek unë qe vënë në akull, pas asaj ëndrre që e pamë me tmerr dhe si përherë para kohe. Për 47 ditë unë do të mbushja 25 vjeç. Mba mend që kisha veshur një këmishë nailoni të bardhë dhe që nuk më kish dashur askush prej

atyre që unë kisha dashur. Jeta ime intime papritur qe përzier në mënyrë të pandashme me kohën. Në botë kishte njerëz që bënë revolucione duke djegur vetveten si Jan Zhishka përshembull në mes të Pragës, në kohën e pushtimit sovjetik të Çekosllavakisë. Atëherë kur tanket rusë përshkonin si fitimtarë rrugëve të Pragës. Por edhe pse po e ushqej kujtesën dhe krejt integritetin e lutjes sime, dita e 26 shtatorit të viti 1973 prapë do të mbetet e errët. Shtypi botëror kishte kapur në flagrancë krimin në shtëpinë e Ingeborg Bachmanit, që duke u pjekur brenda në prushin e zjarrit e tëra njëherësh po digjej. Mund të qe ajo krejt ëndrra ime pas asaj që kishim ëndërruar dhe muret e ëndrrës po çaheshin. Në vendin tim vetëm Skënderbeu ishte ende mbi kalë si një hero i pavdekshëm dhe koha përgjithësisht nuk kishte ndonjë kalendar, që të mund të parashikonte nëse Ingeborgu brenda në shtëpinë e saj e gjallë kishte vdekur.

25.4.08

KUPTIMI EMOCIONAL

Kuptimi i varur prej emocionit është një gjendje e kcila më tepër ndiehet se duket. Prej një emocionit negativ kuptimi vjen në kahje të kundërt me atë çka mund të kishte qënë prej fillimit. Gjoksi i hapur i një femre shihet me simpati prej një katoliku evropian ose amerikano-latin. Ata e lenë dritaren hapur, e kapin rënien e traditës por ia lenë të lira degët, aq sa herë ikijnë tepër larg duke venë në dyshim vet ekzistencën. Por kthehen të penduar dhe peshojnë vlerat duke kuptuar se aventurat nuk janë zgjidhja më e përshtatshme, ndonëse përmes saj si përmes një eksperimenti ,u provua që bota sidoqoftë ka bërë hapa të mëdhenj përpara. Por një myslyman nuk do ta toleronte këtë shfaqje dhe do pranonte më mirë ferexhenë se pjesët lakuriqe të zbuluar dy qytetërimeve. Njëri i hapur e liberal mbi bazën e të cilit janë liritë individuale që bëhen edhe promtor i lëvizjes. I dyti, i mbyllur me kujdesin për ta dministruar lirinë individuale deri në kuifjtë më të skajshëm. Por edhe një traditë e vjetër e cila e ka përshkuar kohën jo përmes bjerrjes por ekstremizimit të saj. Forcat e kësaj tradite i shtyjnë emocionet gjer në ekzaltim të së shkuarës dhe çdo ndërrim i saj shoqërohet me çlirimin prej dogmës, duke i rishikuar ato aq sa të mos u cënohet thelbi. Kjo mund të arrihet përmes rivlerësimit të shoqërisë islame. Dogma këtu triumfon mbi dëshirat, të cilat në të shumtën e rasteve ndiehen të shtypura prej forcave të jashtme që ndërhyjnë

arbitrarisht në vet jetën e individit. Por në rastin e idesë që jemi duke shtjelluar do të na interesonte më tepër fakti se si letërsia e thith prej realitetit këtë gjendje të dyfishtë të një shumëse emocionale në përcjelljen e mesazheve të veta. Ndoshta këtu gjendet një nga burimet e pashterur të saj. Përjetimi i ndryshëm i njerëzve të ndryshëm i gjendjes së një objekti ,ndoshta është vet arsyeja e ekzistencës së letërsisë, sepse përmes saj njeriu/në këtë rast lexuesi/ që pranon vetëm njërën anë të shpjegimit i duhet të lozë në të njëjtën fushë me të tjerë e që me të njëjtin top e humbasin ose e fitojnë lojën. Por me kusht që kjo jetë dhe një shkak jo aq i rëndësishëm për llojin e kësaj apo asaj ekzistence. Sidoqoftë ana emocionale i jep një fuqi shtesë kuptimit, ose dhe duke e devijuar atë krejt dhe në vend të grurit kemi korrur hashahsin, që na vjedh bashkë me shuarjen e urisë dhe gjykimin e arsyes.

14.9.07

NË BOTËN FANTAZISTE TË LETËRSISË

Një letërsi e vërtetë nuk mund t'i qëndrojë dot besnike asaj që ka ndodhur, sepse letërsia shkruhet për atë që në të vërtetë nuk ka ndodhur. Kështu nis Bibla dhe Iliada, pastaj Ferri i Dantes dhe Uliksi i Xhojsit deri dhe Alefi i Borgesit. Por poezia është tmerrri i vërtetë i asaj që pritet të ndodhi, por pa asnjë kohë, dikur, kush e di kur dhe ndoshta kurrë. Letërsia është e përfshitë në këtë lojë sa reale aq edhe surreale por megjithatë letërsia nuk është dokument. Ajo e takon njeriun përherë në zgripet e veta, në dyshimet e mëdha dhe në vigjilje të asaj që pritet të ndodhi. Pa qënë e tillë ajo as që do ta vazhdonte bashkëbisedimin e saj me njeriun dhe kohën. Guximi i saj nuk njeh kufi dhe është çarku i mendjes sonë që në pritje të saj përherë rri i ngritur. Prej e për ku kalojnë vallë retë? Furrë që ndez përfytyrimet tona, digju ti skëterrë që nxjerrë me zor shpirtrat e njeriut në dritë. Zemërohu e gulço prej pafuqisë së hapit për të kapur përfytyrimet tona. Ti që tani e kupton se prej meje ke humbur vet botën, e cila nuk do të jetë më pjesë e vetes tënde të braktisur.

17.9.07

KOHA REALE E KADARESË TE “DARKA E GABUAR”

Ngulumimi për ta krijuar atë ndoshta përcakton fizionominë letrare të Kadaresë. Me data dhe vende pa kohë dhe hapësirë që bëhen të pashmangshme ndryshe e tërë vepra mund të shkërmoqet. Aty janë vjegot ku korpusi letrar i shkrimtarit gjendet i përcaktuar. Koha reale është në fakt një rimarrje prej historisë e diçkaje që duhet kaluar nëpër filtrin e së sotmes për të shumëfishuar kumtet. Sepse vet shkrimtari është personazhi i botëkuptimit të sotëm që udhëton me reminishencat e historisë. Kjo është një nga pikat e takimit me historinë, jo në mënyrë virtuale por të drejtpërdrejtë. Brenda këtij kuadri shkrimtari e vendos veten në rreth duke zvogëluar mundësitë e shpikjes së historisë por duke zgjeruar mundësitë e interpretimit të saj. Dalja prej rrethit është një detyrë shumë e vështirë por shkrimtari ia delë mbanë si një strateg tashmë i sprovuar. Që kur ka nisur betejat e para me letërsinë Kadareja ka njohur forcat e mundësitë e tij. Të kolauduara përmes një sërë sprovash të tjera të mëparshme ai gjendet tani në këtë zgrip ta takimit të tij me historinë.

A do të kishim një roman si “Darka e Gabuar” pa atë faktin real i cili si histori prej kohësh edhe mund të kish vdekur? Prej skeletit të tij Kadareja po mbush haspësirën me kohë antropologjike, me mishin e së sotmes të njeriut i cili duhet domosdoshmërisht të ndiehet brenda saj. Dy doktorëve vetëm sa u janë ndërruar emrat nga Vasil në

Babbameto por që këtej ai kap fillin për ridimensionimin e historisë. Historia në vetvete mund të jetë shndërruar prej kohësh në një zgavër të një lisi dikur të lavdishëm. Por risjellja bëhet produktive për shkak të karakterit ciklik të zhvillimit. Kadareja rri shumë afër historisë për të mos u shkëputur prej saj sepse humbja e këtij filli mund të rrezikonte pastaj krejt veprën. Flas për veprën e Kadaresë e lidhur kaq shumë me historinë si rrallë ndonjë shkrimtar tjetër. Prej një largimi të përkohshëm duket se marrëdhënia e tij me të bëhet edhe më e ngjeshur. Por a janë historike fjalët e personazheve të Kadaresë? Sado të veshur me misterin e jetëve të veta ata në fund të fundit do të shfaqen si produkt i vet historisë. Ata janë të determinuar prej historisë qoftë edhe të vjelur nëpër periferitë e saj. Por ikja prej historisë mbetet përherë e kushtëzuar prej forcës tërheqëse të saj. Aq sa ajo të mos largohet prej fokusit të shkrimtarit për aq sa ai t'i mbledhë në kohë të larguarit prej saj. Këtu kam parasysh pothuaj krejt veprën e Kadaresë me përjashtime të rralla. Ky det i magjishëm i çon atje tërë udhëtarët e tij për t'i mbytur. Por lidhjet e Kadaresë me historinë mbeten përherë specifike. Ai ka ndërhyrë në një gjë pothuaj të vdekur për ta rilindur atë sipas nevojave të bashkëkohësisë. e cila ndien nevojën për tu ushqyer prej saj. Letrarizimi i historisë apo historizimi i letërsisë? Pothuaj as njëra as tjetra. Kurthi diku mund të jetë ngritur por shkrimtari e ka bërë të qartë që në nisje devizën e tij. Historinë ai e sheh posaçërisht si lëndë duke ua rrëmbyer atë kohëve të shkuara të cilat tani s'kanë më kujt t'i ankohen. Flirti me historinë është i pranishëm e i dëshirueshëm për të dyja palët. Te romani i fundit ka shumë histori reale, pika të shumta referimi, por Kadareja edhe në këtë rast ndodhet aty për ta marrë historinë me vete. Kjo ka qënë në fund të

fundit detyra e kujtesës njerëzore: Të mos harrojnë vetveten. Do na zenë dridhmat e mosekzistencës nëse historinë nuk do ta shndërronim në një tekst të shkruar e për më tepër, në një tekst të mirëfilli letrar të paasgjësueshëm, siç mëton të jetë teksti kadarejan. Duke mos u bërë shtojcë e historisë çdo libër i Kadaresë na sjellë një variant të moderuar të saj, një lloj përjetimi i supozuar por që gjendet i përcaktuar prej vet kuadrit historik. Dëshmitarët të gjithë kanë vdekur pas vetë protagonistëve. Kanë kaluar qindra dhe mijëra vjet e megjithatë prej atyre kohërave vijnë kumte njerëzore të përplasjeve të mëdha të cilat tashmë kanë fituar qytetarinë universale. E sotnja –kumton shkrimtari- nuk është pjekur ende, ajo nuk është bërë ende histori . Por Kadareja si një gjahtar me aftësi të një shënjimi të jashtë zakonshëm të historisë më parë i ka bërë asaj një pritje madhështore duke e futur në kurth dhe ajo më vonë atje është ndierë mirë, sepse është duke u kthyer me një madhësi tjetër: tek e shkuara e saj e lavdishme. Por as kjo nuk do të ishte letërsi nëse duke e ripërtërirë historinë duhet ta mendojmë prej asaj pike të vdekur, se si do të ishte ajo në këtë të ardhme kur po rimerret për tu shkruar. Në pikëtakimin e sotëm të historisë me të shkuarën e saj ndodhet i pranishëm vetëm shkrimtari. Dhe vetëm ai e di se ç’thuhet e flitet për këto kohë kaq të largëta në mungesë të informacionit për atë që mund të ketë ndodhur. Ja pse shfaqet shkrimtari të cilit jo vetëm i duhet të mbajë proces- verbalin apo të kryej modalitetet e këtij takimi me historinë, por që ajo të shkojë në rrjedhën që ai ia ka përcaktuar. Nuk besoj se në historinë e letërsisë botërore të ketë një shkrimtar të dytë që e rimerrë historinë me kaq skrupulozitet, duke na i paraqitur atë përherë me një lloj perspektive, ku ne mund të shohim fytyrën e së ardhmes në pasqyrën e së sotmes. Por ka histori të tjera pa fund që nuk

do të kenë kurrë fatin t'i presin përpara shkrimtarë dhe ato një ditë do të vdesin, nëpër ca data lindjeje dhe vdekjeje pa patur fatin që letërsia t'i operojë përbrenda. Në Shqipërinë e vogël ca historira aq të panjohura për botën përmes penës së Kadaresë u bënë të përbotshme. Ja pse ndërmendem tani përmes veprës së Kadaresë dhe historisë duke marrë shkas prej romanit "Darka e Gabuar". Mungesa e syrit të Kadaresë ndaj historisë të një copë vendi gati të panjohur, do të ishte si një nyje e këputur në zinxhirin e kujtesës. Unë po flas tani për ngjarje e ngjarje që kanë përmasa gati biblike për shndërrimin në hiç të shumë qytetërimeve. Ku janë maqedonasit dhe thrakët e lashtë? Zhdukja e një ppulli të tërë si tragjedi është e papërfytyrueshme. Por ja që dhe ajo ende nuk është shkruar. Duhet të vijë shkrimtari për të kryer këtë operacion të thellë për të nxjerrë prej andej të vërteta të mëdha që mund të jenë duke vdekur. Dhe ndoshta një ditë Hollivudi do të mbushej me histori të thrakasve e maqedonasve por gjasat për të zbuluar nën këto gërmadha qytetërimi të humbur, sa vjen e bëhen përherë e më të pakta. Gjirokastra e Kadaresë është vendi simbol i zbulimit të historisë . Përderisa interesi e intelekti i shkrimtarit të jetë gjallë ajo Gjirokastra do të gjenerojë përherë letërsi prej penës së tij. Një zhvendosje e tillë e historisë te letërsia nuk bëhet thjesht për t'i shtuar ornamentalizmin asaj. Këtë më mirë se kudo e vemë re te Kadareja i cili ndiehet në histori si brenda shtëpisë së vet dhe, fati i letërsisë që kemi këto zbulmime "arkeologjike" të historisë të pamenduara kurrë . Kur kemi thënë si në shtëpinë e vet në radhë të parë kemi parasysh sjelljen e cila është më se e natyrshme, së cilës i mungon poza dhe shtirja. Historisë në këtë rast i duhet vetëm të bindet sepse udhërrëfyesi i saj është i pagabueshëm. Edhe pse ngjarjet duken thjesht histori

shqiptare ato e shpërthejnë kornizën e tyre gjeografike e gjeopolitike. Kemi një zhvendosje të kohës estetike ku çdo histori është pasojë e një shkaku të mëparshëm. Ja pse letërsihistoria e Kadaresë mund të konsiderohet gjini e një lloji tjetër letërsie, e cila zhvillohet paralelisht me realizmin magjik të amerikanolatinasve të Markesit etj. Kemi dy kahje letrare që e shënojnë letërsinë e shek. XX të konturuar mjaft qart. Jo thjesht ose vetëm si çështje e përmbajtjes së saj por për më tepër zgjimi i letërsive të vogla për të mbërthyer vet horizontin e letërsisë . Miti edhe kur merret prej Kadaresë shndërrohet në histori . Le të kujtojmë këtu “Kush e solli Doruntinën” nëpunësat e shtetit mesjetar si dhe sfondi historik i kohës. Pra miti zhvishet përfundimisht për të vdekur në histori. Si të thuash në një rrjedhë tjetër duke i larguar përherë e më shumë anës funksionale të saj. Kadareja edhe në këtë rast gjendet i shënuar prej historisë e cila iu vu në besë shkrimtarit numër Një të saj.

Mars 2009

BURIMI KU PI UJË ETJA

Ç'më ndodhi me këngëtares K.B. krejt të panjohur për mua. Një fytyrë e ëmbël sikur vinte tek unë këtë çast prej një ëndrre. Ato pak minuta që e ndoqa në ekran mu krijua një ndjenjë kurrë e përjetuar më parë. Ëmbëlsia e një fytyrë që lodrohej prej zërit të saj ndoshta është ajo që këtë çast po shpikte njeriun, më tepër mungesë e një kohe të largët ,së cilës unë po i kushtohesha shpirtërisht, duke qënë krejt me veten e duke udhëtuar nëpër ftesën që po më bën një e panjohur. Unë nuk e di si po lindesha sepse po lindej një copëz jete tjetër prej meje. Si rrëzohet një sfinks nëpër flakë të mendimeve tona. Dua ta dua atë për jetë në mënyrë të pandalshme ,si një zbulim ku më në fund njeriu ka gjetur burimin e etjes së tij më të thellë.

6.12.07

LIRSHMËRI PA PENGESA E LIGJËRIMIT

Duke folur një gjuhë, njeriu krijon me të një lidhje shpirtërore, sepse vetëm përmes saj realizon vet ekzistencën. Kam parasysh edhe njerëz që për komunikim janë të detyruar të përdorin edhe gjuhë të tjera. Ato/ gjuhët/ shumë shpejt bëhen kujtesë dhe ti nuk jeton dot ndryshe veçse përmes ose i kushtëzuar prej tyre. Një nga marrëdhëniet njerëzore më të prekshme e cila shpesh nga shumë njerëz nuk vihet re, sepse njeriu në fakt ndiehet vet ajo. Kushti bazë që kjo marrëdhënie të mos priset është të folurit, apo qoftë edhe të menduarit përmes saj. Ky lloj intimiteti tret gjuhën në çdo qelizë dhe duke ecur ti në fakt je duke ushtruar vet gjuhën dhe, ajo çka të jep gjuha ti ia kthen asaj në mënyra të tjera, duke u bërë konsumator i saj dhe kjo e mirë e madhe duhet shpërblyer, me më pak sakrifica por me ndershmëri të madhe. Përveçse me shqipen unë kam pasur fare pak kontakte me gjuhë të tjera. Tani ushtroj greqishten. Marrëdhënia ime me të ka qënë mjaft e komplikuar për shkak të shumë rrethanave. Duke jetuar në Greqi për një kohe relativisht të gjatë, unë mora prej saj një bazë të mjaftueshme fjalësh e trajtash gramatikore e sintaksore. Por nëse flas për raportet që kam krijuar me të ato janë ende fluide, që po kalojnë përmes tërë vështirësive që i duhet një marrëdhënie për tu konsoliduar. Situatat e humorit të lindura për shkak të keqkuptimeve të vazhdueshme me të kanë qënë gjëja më e këndshme që i ka mbajtur këto

marrëdhënie në një gjendje miqësore. Gjuha të jep aq sa ti kërkon prej saj, por kurdoherë nevoja ka qënë ajo që na ka ndihmuar për të kaluar nga miqësia në dashuri. Ndërsa me rusishten kam pas një marrëdhënie e cila mbeti e ftohtë edhe pas 7 vitesh të mësuar atë në shkolla. Ajo erdhi duke u fikur vet përderisa ne/unë dhe gjuha/ nuk e ushqyem më njëri-tjetrin. E çara e madhe ndoshta kishte qënë vet fillimi i kësaj aventure që shpreh shkallën e imteresit pa baza të forta. Me italishte punët kishin qënë më ndryshe. Unë arrita deri tek ajo përmes një lodhjeje të madhe pa mësues. Falë sistemit gramatikor të saj të përafërt me shqipen, që përveç dashurisë, sfida më e madhe ishte që unë ta konservoja atë pa e folur dhe, përmes leximeve ne ndihmuam njëri-tjetrin që kjo marrëdhënie të mos zhbëhej. Sidoqoftë flas për përvoja që kanë qënë pak rezultative por mua më intereson thelbi i marrëdhënieve njerëzore me gjuhën, në pikëpamjen që njeriu e arrin përsosjen e vet vetëm përmes gjuhës. Neve na nevojitet një fjalor me një shumë të caktuar fjalësh, të cilat pasi janë përfutuar nga baza e vet gjuhës, ngjiten më lart duke tërhequr njëra-tjetrën drejt një lirshmërie pa pangesa të ligjërit.

1.12.07

ELIOT E TRANSTROMER

Imazhi konkret i poezisë dhe ligjërimi sa më afër gjuhës së folur me qëllimin e vetëm për ta shndërruar poezinë në një metaforë të vetme. Poetizimi nëqoftëse do ta përcaktojme si të tillë konceptin që e trajton poezinë thjesht si kënaqësi estetike, më duke se tashmë i ka lënë vendin rrokjes më konkrete të realitetit, të atyre raporteve që nuk mund t'i zhvlerësojë asnjë epokë dhe që përcaktojnë në fund të fundit vet natyrën njerëzore. Por një poezi e tillë ndodhet prapë e vendosur në kohë, sepse mjetet artistike të saj e zbulojnë poetin në kohë ku duket qart synimi i tij për t'i ikur kohës. Alfred Purforku i Eliotit si qenie që përmes poezisë ka fituar përjetësinë duket po aq konkret si njeri i fillimshekullit XX në mjediset e një Londre, e cila mund të zbulohet pa shumë vështirësi përmes detajeve që janë trupëzuar në poezi ,por që për nevoja studimi ne i veçojmë ato duke ia kthyer përsëri kënaqësisë së lexuesit. Por ndodh edhe e kundërta si në poezinë e Transtromerit tek Shubertiana ku poezia kryqëzon tek e sotnja të shkuarën dhe të ardhmen. Prej shekullit XIX kemi një lloj subjekti me dy kompozitorët e mëdhenj, një intimitet i tejskajshëm por Nju Jorku tashmë bëhet skena ku vepra e shquar muzikore do të luhet. Një mbrëmje e Nju Jorkut kthehet një një Shubertuianë moderne dhe poezia sjellë një emocion më të drejtëpërdrejtë për bashkëkohësin. Ndërsa gjykon se si do ta përcjellë Shubertiana të ardhmen njerëzore përmes

shkeljes së pedalit që të hyjë posht ndërgjegjeve tona deti. Ndërkohë që Transtromeri bëhet edhe më konkret se Elioti e ndërsa Elioti largohet paksa në horizont, poezia më e re ndienë nevojën për ta përshkuar bashkëkohësinë si një dritë që shkon drejt shuarjes. Ky shoqërim e ndihmon poezinë për të mos iu larguar edhe më shumë synimeve pa fre të saj. Por sidoqoftë ajo me atë pakëz histori prej së cilës është ngjizur do të mbetet e paprekur prej saj.

12.12.07

BIBLA KISH NISUR TË SHKRUHEJ

Një shkak që mund të duket krejt absurd por që tani është kthyer në një obsesion, ndoshta i duhet nënshtruar analizës. Si një copë gazete duhet prerë nga shtypi i kohës ku një ngjarje rri e kundron të tjerat në heshtje, por që nuk e verbojnë flamurët që atë ngrejnë për shkak se çdo lloj fitoreje mund të jetë edhe vet humbja, kanë nisur prej këtij çasti të shkurtër. Nuk e përballojmë më dot dhe vendosim ta hedhim në treg këtë antikuar me një dhimbje të madhe. Do të thoshja kohë krize, ku identiteti i papranuar nga koha kërkon të imponohet qoftë edhe përmes këtij delikti ndaj një karakteri që nuk ka nënvizuar kurrë asgjë prej vetes. Tani që letrat u hapën në çastin po e bëj bëj historik dhe e shpall atë para të gjithëve. Si njeri që në një moshë madhore është duke pritur kuptimin e vet botës. Një “grafomani” si unë kjo pyetje i duhej bërë prej kohësh, por unë me atë guximin çmendurak ndaj të cilit e ruaj përherë pushtetin, po ia bëj thjesht vetëvetes: Tregomë pra ç’është rrjedha ku një rrëke duke rënë, nuk po vendos ende ku të derdhet? Përrenjë dhe lumenjë dhe dete që janë fati i shiut që këtë natë po bie, për të vënë në gjumë botën. Ishte një vjershëruce e vogël e ndërtuar me një ide mbi të rënë e Luftës II Botërore me ca rima foljore, shkaravina e cila u bë vjersha e parë ajo që kish dhënë një shenjë se talenti, ndoshta nuk ka filluar përherë në mënyrën si u shpall prej tij Moxarti. Ky vargëzim tetë rreshtash mua sidoqoftë më

kish bërë mik me një botë tjetër të kësaj kambane, tingujt e së cilës vetëm sa ishin kapur si sinjale. Por ndoshta ky ka qënë përherë fati i një fare që në tokë do të mbillet. Me të bashkë suktesi dhe dështimi, fitorja dhe humbja. Por faqja e parë ishte hapur dhe Bibla kish nisur të shkruhej.

18.12.07

ÇAST

Më duhet të jem në një gjendje tensioni të vazhdueshëm. Si të thuash të mos guxoj ta lëshoj fillin nga dora sepse me ikjen e tij do të humbisja krejt botën. Kjo ka qënë vala që më ka përshkuar. Kjo ka qënë zemra të cilën kurrë s'do ta njihja. Unë gjer më tani s'kam folur kurrë për këtë gjendje që është vet shkak i krijimit. Ajo që më ka dhuruar vet jetën dhe damkosi me fjalë përfytyrimet e fantazitë e mia. Çaste të magjishëm ku një urdhër providencial e urdhëroi botën të heshëte për t'i hapur udhë një bote tjetë. Atëherë unë jam ndër i frikshëm sepse nuk i shihja më frerët që një nga një po këputeshin. As ky përbindësh- kjo monstër që kish gjetur këto mënyra mizore për të më shqyer. Makthi duhet shpërblyer me fjalë, me zëra që konvertohen njëherësh në gjuhë, ndryshe fantazia qiellore e hap varrin e saj në qiell. I prangosur në pritje prej çastit të lindjes, ti je bërë një kambanë që me gjëmimin e saj pasqyron verbërisht ankthin.

10.11.07

BLASFEMI

Poezia si përvojë tani nuk duhet të jetë më aq e butë, e përkulshme dhe e trembur mos thyen rimat e ritmin. Ajo ka një betejë të madhe përpara të cilën rrezikon për ta humbur. Por mentaliteti i vjetër që e trajton atë plot përkujdesje, duke e përgjuar natën në gjumë e qetësi hapat e njeriut, ajo do të zgjojë ndërgjegjen e saj për fuqitë që ka ende pa eksploruar. Për një nga dashuritë më të bukura të njeriut duhen bërë martirë të rinj. Depot janë mbushur me barut dhe me plehra. Baruti është atomik por për shpëtim poezia nuk mund t'i këndojë atij më ninullat e lashta, sepse djepet janë strehuar nëpër muzetë me shpresë se mite të rinj në ta do përkunden . Duhet modifikuar gjuha dhe të mos e lejojmë njeriun të kërkojë nëpër gërmadha predha të luftës së shkuar, që njëlloj rrëmbejnë jetë njerëzish. Poezia që përdoret për të prostituiuar ca mendje prej kohësh e ka humbur aftësinë shëruese të ndjenjave. Duhet goditur më thellë e më me forcë aty ku njeriui ruan të fshehtat për të mos u zbuluar lakuriq, para moralit të ri që na i ka hequr prej duarve këto lira, që telat e tyre thyhen si shkarpa. Poezia i ngjanë një lumi të nëndheshëm që mund të identifikohet përmes blerimit të natyrës, aty ku pelegrinët ende nuk janë shfaqur. Poezia e re është një blasfemi, por le ta durojmë dhe dhimbjen që vjen prej saj për tu shëruar gjer në rrënjë prej së keqes.

18.1.08

KAVAFI

Kavafi iu drejtua miteve dhe legjendave në kohën që ishte duke kërkuar një shpjegim rreth vetmisë. Për t'i shpëtuar kësaj vdekjeje të përhershme prej së cilës ai nuk po gjente dot mënyrë tjetër shpëtimi. Kavafi po lindej si poeti i mërzisë duke e përcaktuar veten në të njëjtën kohë edhe si poeti i fshehur te qytetërimet e lashtë, për tu bërë dhe shpëtimtari i tyre prej asgjësimit. Ai kërkonte një identitet që përditshmëria e Aleksandrisë po ia grryente nga brenda. Ai do të bëhej zëdhënës dhe ne s'e dimë ende si iu dha atij leja për të hyrë aty ku të gjithë kishin kaluar pa lënë asnjë gjurmë. Ai u takua me mitin dhe legjendën por edhe me historinë në kohën kur kërkonte një drejtpeshim te vetja ,për të na nxjerrë prej origjinës krejt lakuriq dhe për të na udhëzuar për të ardhmet tona të panjohura. Kavafi i siguroi vetmisë së vet një auidencë tek Perëndia. Ai bëri të pamundurën për të paraqitur prej kohës mbas vdekjes kredencialet e nevojshme, për tu pritur tek ajo në kohën kur çka shkroi i bëri një sfidë mënyrës tradcionale të të shkruarit.

16.11.16

NJË JETË QË ËSHTË DUKE ARDHUR

1.

Vijmë në jetë përmes një pasioni të egër. Më pas një klimë e butë dhe e ngrohtë gjersa të shpërthejmë prej një dhimbjeje të madhe në dritën që aq shumë na ka pritur. Ne që u lindëm duke u çliruar prej vargonjve të errësirës, tani do ta kemi të vështirë për tu orientuar me dritën. Prej andej nga na erdhi drita ne do të ndjekim udhën e saj. Një krijesë e pafajshme që iu dha në dorë thika për të vrarë dashurinë e për tu falur më vonë tek altari. Cikël i mbyllur prej kthimit në tokë prej qiellit. Kjo dashuri në urrejtje dhe kjo urrjetje në dashuri që kurrë më s'ka për ta dëgjuar ulërimën e atij fetusit të vogël që kërkonte errësirave të thella dritën. Dalja në dritë ishte e vetmja mundësi për ta shpëtuar krijesën nga vdekja që në lindje. Gjymtyrët tona të vogla që sulmonin në atë enklavë uji për të dalë gjallë prej mitrës. Ja ku jemi në dritën që në të vërtet na tregoi çfarë ishim. Një ambicje për pushtet e lindur mes putrave dhe kthetrave. Një armiqësi e shpallur ndaj pushtetit që te porta e mitrës ishte duke na pritur, si radhët e një ushtrie të bindur prej ku do të merrnim në dorë frenat e jetës. Mezi presim të bëhemi zot të veprimeve tona dhe me sa më pak varësi nga të tjerët. Thyerja e prangave krijon shpesh zhurma të panevojshme që mund t'i zbrapste vetëm një urdhër. Atëherë krijohet një përplasje mes individit dhe shoqërisë duke na nxjerrë në pah anën kriminale të tij. Tani armët kthehen

kundër vetes. Një kufi i paqartë mes pafajësisë dhe fajësisë. Gjyqe pa fund për të zbuluar shkaqe që vijnë prej shkaqeve të tjerë më pak të identifikueshëm. Burgje dhe çmendina më shumë ku përfundojnë në këtë mizerje shumë prej jetëve tona. Njeriu ve në shënjestër njeriun: me cmirë dhe urrëjtje, me pabesi dhe bomba. Pë të siguruar një fitore qoftë edhe të përkohshme.

2.

Për askund mos u nxito. Ato do të linden prej vetes. Secila lindet sipas kodit të saj duke e pasur folenë në mendjen time. Do të ketë prej tyre nga ato që ndoshta kurrë s'kanë për tu lindur dhe ti një jetë të tërë liturgjitë për shpirtrat e tyre ke për të kënduar. Rreth çerdhes u vërtitën erëra të furishme dhe ata u strukën edhe më thellë brenda vezëve. Sepse lindja është akt i madhërishtëm. Duhet të jetë gati tërë bota për ta pritur. Edhe kur u shpërthjenë brirët si sytha nuk do të thotë se ata po linden. Zgjatim putrat e vogla por nuk guxojnë dot të çukitin lëvozhgën dhe bien sërish në gjumin e shekujve. Nuk do të guxonin prej frikës për të mos u bërë thjesht ushqim i gjuhës. Kur të ndienin se ishin të pathëna do të lindeshin duke shënuar Ditën e Lindjes së një shenjtji. Por shenjtët kalojnë përmes provave torturuese para se ne tu japim leje të ngrihen në qiell. Në serrat e ngrohta duhet të bjerë aq sa diell edhe dritë hëne, aq sa kohë e shkuar edhe e ardhme. Krim është ta popullosh botën drejt një shpërthimi demografik të ardhshëm. Bibliotekat mbyllën portat në pritje të një Libri të Ri që ende nuk është shkruar. Prej andej u hedhim paprerë fjalë gojëve të uritura për të mjerruar edhe më shumë ekzistencën. Me mendjen se një libër i tillë ende nuk është shkruar le të ushqehen ekranet dhe skenat, bisedat tona të përditshme, parlamentet gjer sa të shteret krjet gjuha. Vetëm atëherë do shënohet çasti se

një shenjt është duke u lindur. Ai i ushqyer vetëm me majën e klorofilit dhe dritën e vesës së një mëngjesi për të dhënë lajmin se një shenjt i madh është duke u lindur. Nëpër furra të gjuhës digjen miliarda fjalë kur të qeshurat ndezin qirinjtë e pikëllimit. Kur s'bëhet dot ditë pa qënë më parë një natë e përjetshme. Në këto karnavaleska ne shenjtin tonë jemi duke e pritur gjersa të shuhen tërë ambicjet tona ne urtësinë që po vjen në gjunjë jemi duke e pritur. Të Pathënat përherë do t'i mbajë peng misteri dhe Absolutja.

14.7.19

LETËRSIA SI BUSULL NË DORË TË NJERIUT

1.

Atë çka arrij ta perceptoj përpiqem ta kthej në lëndë letrare. E derdhur në mitrën e subkoshiençës prej kësaj mbarsjeje mund të kemi një rezultat të mrekullueshëm. Përndryshe asgjë tjetër s'mund të jetë letërsia përveç këtij hibridizimi: materjale e shpirtëzuar që e zhvendos artin në të gjitha kohët. E ke zbuluar këtu dhe pikërisht këtë çast dhe e çonë atje tek e shkuara për të ndërtuar diçka tjetër. Çasttakimet me letërsinë vijnë prej këtyre kontakteve dhe një dëshire të epërme për të bërë një lojë të njohur me të panjohurën. I zhvendos gjërat atje ku më thotë mendja, njëlloj si të mbjellësh grurin në Hënë pa e ditur se kushtet për këtë ende nuk janë pjekur. Kjo aventurë e bukur por edhe e rrezikshme në shumë raste të ka dhënë rezultatin e dëshiruar. Jetës reale i vemë në dorë një busull për të treguar se dhe ajo vet ekziston brenda misterit. Por sado të përpiqemi ta shpjegojmë, ky proces nuk këmbëhet dot si përvojë me një mendje tjetër. Nëse dy njerëzve u shfaqet para syve e njëjta pamje, brenda saj ato kanë hyrë përmes portave të ndryshme. Kjo e bënë të pamundur ngjajshmërinë, përndryshe bibliotekat do të kishin qënë të panevojshme dhe do të ishin të përfaqësuara kështu prej një libri të vetëm. Këtë ide që e kish shfaqur i pari Malarmeja prej të cilit e mori më vonë Borges, ndërsa e përfytyronte krejt letërsinë si një lodërzë të bukur të mendjes së Njeriut. Ajo çka unë

perceptoj është një nga spektret e një ngjyre të vetme për tu bashkuar me të tjerat tek rezultati përfundimtar i saj. Ajo që unë perceptoj do të kalojë nëpër një kalvar të gjatë gjer sa me të diçka të jetë ngjizur.

2.

Unë dyshoj gjithmontë në një letërsi të organizuar apo thjesht si skicim të një ëndrre për ta parë të ngritur si ndërtesë, atë arkitekturë mahnitëse që mund ta shpërbëjë në çast edhe kritika më e përvuajtur. Ja pse me kohë e kam braktisur racionalitetin vetvrasës. Ajo peshë e rëndë e jetës që na rri përherë mbi kokë duke ngulmuar se na përket vetëm neve për tu vënë në shërbim të saj. Unë nuk i besoj as pritjes së muzës, hapjes së krahëve të fluturës te ky shteg ku rri në pritë, për të gjetur një ditë të mirë me tërë vektorët e saj, për t'i dhënë udhë diçkaje që unë nuk e kam akoma në mendje. Dhe po t'i besoja nuk do të vija më në dyshim asgjë prej asaj që është shkruar. Unë megjithatë nuk vendos për tu arratisur, por për një bashkëjetesë me gjithçka që është në përputhshmëri me mendjen, duke mos e provokuar kurrë atë për të çorientuar mendimin. Le ta marrë fjalën kur të dojë poezia nëse vërtet ajo ka vendosur të shprehet. Le të flasin zërat e me peshën e përgjegjësive historike të veprave të tjera të çdo lloji tjetër të letërsisë. Por unë nuk i besoj kur ato shpëputen papritur nga unë dhe rrëfejnë vetveten duke mos vrapuar. Ato mbërtheçka të vogla të çastit që tani para syve tanë janë duke fluturuar.

3.9.03

JETA NJË PËRRALLË

Unë jam rritur pa përralla sepse nuk njoha asnjë gjysh e gjyshe as nga nëna, as nga baba. Prindët nuk më tregonin kurrë përralla sepse për ta jeta ishte përralla më e panevojshme nëse më parë atë vetë nuk e nxirrje si përvojë nga jeta. Ky deformim i imi në edukim i përjetuar si një masakër e vërtet, u shërua shpejt e pa dhimbje me përrallën e parë mbarëbotërore “Tre kecat dhe Ujku”. Tani që jam rritur dhe nuk kam shkruar asnjë përrallë, të paktën për të mos i lënë bosh pyjet të prerë e të djegur, i mbush ata me kafshë imagjinare dhe përpiqem t’i i çoj për të kullotur me tërfilin që e mbjellin ato vetë në majën e malit, që më vonë do të mbulohej prej një pylli të madh e të dendur, e që më vonë akoma do të bëhej shtëpia e tyre e përjetshme.

27.9.06

ÇËSHITJE VETJAKE

Unë e krijova atë, nuk qe histori sepse nuk kish ekzistuar asgjëkundi. Jetova me të por nuk e preka dhe tani prej saj s'kam më asgjë në mendje. Të isha nxituar dhe pak do ta kisha kapur. Ç'është vallë flutura- bijë e kujt dëshire, zog i çfarë peme? Pse e vizitoi trurin tim si një kometë që nuk u pa nga vinte. Ku është ?– e pyes- Ku shkon dhe pse kaq e pafund është kujtesa ime ku ajo është duke shëtitur dhe unë kurrë s'do mundem për ta kapur. Ç'largësi të përbindshme vallë ka pushtuar? Para pak çastesh ajo si një vegim i mrekullueshëm kishte ndalur në dritaren e mendjes sime, krijesë prrallore krejtësisht e pavizatueshme, e përbërë vetëm prej bulëza vezullimesh drite apo shkarkesa planetesh të largët, ëndërr jo se jo por një shëtitje për qejf të mungesave të panumërta. Ajo kish krijuar veten me atë gjë të padukshme për tu hakmarrë ndaj meje, që papritur mbylla dritaret e ula grilat nga frika e verbimit prej dritës. Nuk do ta toleroj më kurrë të harbuarit. Jeta a zoti vallë na kish falur dhe këtë kënaqësi të fundit?

22.7.03

MAFHUZ I MALLKUAR

Rënia në dashuri në moshën 70-vjeçare rezultoi perfekte. Marrëzitë pleqërore më në fund u urtësuan dhe një i dytë kishte hyrë në jetën e njeriut për të vazduar një rrugëtim të panjohur për të eksploruar nga kjo lartësi jetën. Kishte qënë Nangip Mafhuzi, shkrimtari i madh egjiptian, fitues i Çmimit Nobel, që i thuri homazhe martesës së një çifti në zgrip të jetës. Kjo çmenduri erdhi dhe u zbukurua me përkorjen e saj, u spërkat me erëza e aroma orientalizmash gjithfarëllojsh. Doli kështu një njeri tjetër prej tyre dhe moçali u bë një liqen i kthjelltë, që po e kundronin me xhelozë tërë pasqyrat. Ja një mënyrë perfekte ribërjeje por edhe rilindjeje. Pragu i të 70-ave nuk qënka më vdekja por jeta. Së pari flaku shkopin dhe nisi të vraponte për t'iu ngjitur gërxeve e majave. Ishte një detyrë njerëzore e pakryer, amanet e gati qëllim të cilit gjithkujt duhet t'i shkojë gjer te fundi. Dhe pasqyrimet në liqen u zbukuruan me ato festa të vogla ku ai lozte duke parë atë njeriun tjetër të habitur. Në të vërtetë kish ndodhur mrekullia. Tani ai as që kishte më kohë të mendonte për vdekjen. Mafhuz i mallkuar- kishte bërë titull- prej ç'gjëje vallë më kishe shpikur, që unë si një gabim të vrapoja nga vdekja në jetë dhe jo nga jeta në vdekje, Ç'eliksir kisha pirë vallë ndërsa po vrisja dhe njeriun ballë meje. Kështu buçiste zëri i njeriut që ftonte në vallzim tërë botën. Dhe u bënë një i vetëm duke mbledhur të dy moshat për të dalë te

një moshë që në majë po piqte frytet e përvojës. U pjesëtuan vitet, u zhdukën moshat dhe mallkimi s'ka për t'i zënë edhe pse ky trëndafil u gënjye e u bë i mallkuar prej magjisë së vet të përbindshme. Atëherë- tha njeriu- ec përsëri me shkop por vrapo ne zemër, sepse syri i keq përgjon dhe e tërë kjo për fatkeqësinë tënde, mund të ketë qënë e gjitha veç një ëndërr.

5.5.05

TREMBE ME LULE E ZANA

Ipash dy pamje njëherësh; egërsinë dhe përulësinë
Indaj saj. Isha tkurrur për të krijuar peizazhin e
nevojshëm që do të më ndihmonte për të parë se si një
realitet i egër befas mund të të shfaqet. Nuk kishte më as
forcë shprehëse gjuha por mua më ndohmoi përvoja për të
nxjerrë lapsin si shpatën nga milli. Një pamje që për herë
të parë të shfaqet me tërë tmerrin e saj. Jo për të vdekur të
çastit por për të vdekurit e tjerë që i shihja mijëra, miliona,
klithma që përveç historisë kishte thirrur si nevojë romanin
e vet. Tu ikje ngjarjeve për t'i rrëmbyer ato në ajër. Prej
grumbullit kërcënues të reve të mblidhje qoftë edhe një pikë
të vetme shiu. Fatmirësisht një fajtor i madh ka durimin të
shoh ngadalësisht në një film ku mbarsen keq shumë ide,
por Oskar do të jetë vetëm njëra. Kur u ndeshën/nëse vërtet
ishin ndeshur/unë pashë vetëm gjakun që vrasësi viktimës
së vet ishte duke i thithur. Mëshira lëpihej në tokë por pikë
gjaku në të s'kishte mbetur. I mallkuar- i thashë vetes- që
do të sjellësh këtë dëshmi të përbindshme. Mere atëherë
dhe pastroje, dizinfektoje për të mos sëmurrur opinionin
publik, shkruaje krejt ndryshe, vizatoje me hile si Pikasoja,
trembe me lule e zana që krimi t'ia mbath nga sytë këmbët.
Por e vërteta si polic prej gënjeshtëris na ruan. Pastaj në
rrugë ka dhe plot kamera që ia çojnë filmin studiove për
diagnostikim moral. Ose ti beso se nuk kish qënë aty derisa
ngadalë në kujtesën tënde ky film po digjej. Mbi shkrrumb

e rrënoja prej Trojës së lashtë po vijnë dëshmitarë të tjerë.
Shtegu i hapur ishte ndoshta për ata të vdekur në mit që
nesët do të zgjohen.

3.4.06

LIBËRI QË VAZHDIMISHT DO TË SHKRUHET

Kjo do të ishte tema e kohës për ta bërë letërsinë të ndiehet mirë me bashkëkohësinë. Jo për ta mishëruar por për ta venë në provë rezistencën e saj. Shegu i hapur është ndoshta ikja i mërzitur prej saj por jo armiqësi që i ndan krejt ndryshe gjërat. Kjo të jep një mundësi kthimi nëpër këtë shteg që ajo ta ka lënë hapur për të verifikuar dyshimet e tua. Është një lloj bashkëjetese në largësi që e vuan më tepër mungesën e afërsisë. Ndoshta rruga në ikje ka qënë udhëtimi për të kërkuar atë që ajo e ka shprehur duke e lënë pezull. Dhe kjo është një shenjë force. Me këtë lloj ndjenje unë i jam afruar fëmijërisë, libër i shkruar kaq herë por asnjëherë i përfunduar. Sa herë kthehem tek ajo unë gjej një tjetër lloj strehëze. Asaj nuk i kanë mjaftuar as mijëra herë e s'do të mjaftojnë kurrë tërë kthimet, pra jemi të dënuar të kthehemi pambarimisht për të gjetur shkaqet, pse nuk mjafton asnjëherë e sotmja. Letërsia dhe fëmijëria bëhen kështu pika referimi shumë të afërta për njeriun të ikur prej tyre, por me detyrimin për tu kthyer aty aq herë sa e kupton, që ke ikur tepër larg me rrezikun e braktisjes së përhershme. Pleksen kaq shumë sa shpleksja e njëjës të le në dorë fillin e tjetrës për të mbajtur gjithnjë të paprerë lidhjet me jetën.

24.2.06

TALENTI I KUSHTËZUAR

Talenti si dhunti njerëzore e ka mbushur me kuptime botën. Në të gjitha format i shfaqur ai e ka shprehur në mënyrën më të përkryer natyrën tonë në përpjekje ta zbulojë atë në më të thellat e fshehtësisë së saj. Të shpreh forcën ndaj dobësisë, mençurinë ndaj budallallëkut. Nuk ka fushë ku ai të mos jetë prokursor dhe paraprirës i çdo zhvillimi. Si tharmi i gjithçkaje në të vërtet talenti e rrit rendimentin shoqëror të çdo fushe në progresion gjeometrik, sepse përmes tij njeriu më parë ka zbuluar potencialin e mundësive të veta, duke e bërë botën më refraktare ndaj synimeve e përpjekjeve tona. Por për t'iu shmangur grackës ku mund të biem lehtësisht, mua do më interesonte raporti i tij me krijimin artistik, ku rezultati bëhet edhe më i dukshëm. Përmes shqyrtimit të këtij produkti, në të gjitha kohët talentet e fuqishëm e kanë dominuar atë duke i përcaktuar në të njëjtën kohë edhe rrjedhat e tij të zhvillimit. Lehtësisht mund të dallosh prirje që duke qënë në çdo kohë rrjedhë, zbulojmë në të edhe kapërcimet e mëdha që kanë ndodhur. Talenti që është dukuri kaq personale e ka lulëzuar vet pemën me të cilën ka lindur. Përmes tij arti i shkoi më thellë duke e kthyer zanafillën e vet në një rrugë të gjerë, i cili ka rritur te njeriu shpresën dhe kurajon, besimin në mundësitë e veta. Vepra e një shkrimtari edhe në kulmin e krijimtarisë së tij përsëri do të jetë përcaktuar prej talentit, i cili si maja mbars çdo krijim për tu bërë shfaqja më e lartë e shprehisë njerëzore. Fundi i talentit shënon dhe fundin e një kariere në art dhe letërsi.

19.5.07

PREJ DHE NGA...

Nuk kamë bërë ndonjë studim të posaçëm gjuhësor por guxoj për të hyrë në një temë. Tema është kaq e gjerë sa me të mund të përfshihet e tërë gjuha. Prej përdorimit të dy lidhësave vendore të papërcaktuar, unë kuptoj se gjuha është duke na pritur ende për ta eksploruar. Edhe pse prej më duket disi më gegërishte dhe nga më tepër toskërishte, unë ndodhem njëlloj larg dhe afër tyre. Prej duket se vjen prej më larg ndërsa nga e ka më të përcaktuar ndodhjen . Por a mund të bashkëjetojnë të dyja dhe a mund të jetë ky një problem që nuk është vetëm gjuhësor ose vetëm i gjuhës shqipe? Këtë çast ndiej se gjuha është një kudhër që po rrihet dhe unë që tani jam duke bërë këtë punë të kahmotshme, i pranoj të dyja fjalët pa përjashtuar prej shqyrtimit tim asnjërën. Por shqetësimi im vete e sillet tek ajo se si t'ua përcaktoj më sakt vendin, në mënyrë që ato të jenë njëlloj të nevojshme dhe të pazëvendësueshme prej njëra-tjetrës. Unë që në shqyrtim të problemit/që nuk është fare shkencor/ e shoh gabimin prej ku jam nisur drejt një përfundimi të pasaktë e shumë të diskutueshëm. Por ja që kam një ngasje, ngaqë e kam lëvruar shumë gjuhën shqipe dhe shoh se krimin ndaj saj e kam më të madh e ndoshta si askush tjetër. Prej dhe nga unë i pashë si çelësin për të hyrë prej një porte tjetër te gjuha dhe, prej nga mund të filloj një diskutim tjetër më i gjerë për të pajtuar dy anët që e pranojmë se gjakun e marrin prej së njëjtës zemër. Si fillim

diskutimi ndoshta në vend që të verë në dukje çarjen, zbulon mundësinë për kalim tek ura dhe nga përandej bregut në pasqyrën e lumit shihen si dy njësi që i ngjajnë pak njëra-tjetrës, por të dyja te shtrati i një rrjedhe bashkohen.

Maj, 2007

ËNDRRA

Kur ajo mbeti një njollë e ndritshme mbi det dhe unë po e shihja prej një largësie që më tepër zmadhohej prej ikjes sime, e kisha pyetur atë: Pse nuk kthehesh? Sikur ta kisha fare pranë dhe njolla të që një njeri i vetëm jo një anije, e cila mu shfaq për herë të fundit në formën e një shigjete të ndritshme me drejtimin në ikje. Njeriu në anije më tha se atje s'ka më asgjë përveç shkretëtirës. Çfarë të bëj në një vend pa njerëz dhe në një vend pa kohë? Unë i thashë se do t'ia vlente të paktën të mblidhje çfarëdolloj suvenir, çfarëdo sendi që mund të ketë mbetur atje pas atij shkatërrimi të përgjithshëm. Sepse ikja jote – shtova – më duket se është pa kthim, pa shpresë. Por largësia shumë e madhe që na ndante prej malit të lartë ku unë po vazhdoja t'i ngjitesha-më kujtoi këtë çast Llogoranë. Por ishte edhe më e thellë dhe e largët, ku nuk bëhej më fjalë për mirëkuptim dhe arsye. Unë i mësuar me keqardhjen e mendova në çast tmerrin e një moskthimi dhe kjo ndjenjë, i dha atë formë duke e bërë edhe më të ndritshme njollën në një kaltërsi të pafund që gati po pëрпиhej prej një flake të ndritshme. Nuk po gjej dot mënyrë tjetër për ta përshkruar atë pamje që si e tillë vetëm një ëndrrë mund t'i shfaqej. Mendova në çast se e tërë kjo mund të kishte qënë një prej ekzistencave të mia që po shkëputej prej mosqënies, një liri që në fakt s'do të kishte qënë kurrë e tillë, e tërë jetën do t'i paguate haraç kësaj ikjeje spektakolare. Për fat të keq prej ëndrrës kujtesa

ime ruajtii vetëm këtë çast, duke u trembur se gjithçka para saj do të kish qënë një shungullimë gurësh e dheu, kërcitje eshtrash që thyheshin, lumenjë që po përmytnin tokën prej të katër anëve. Anija me një njeri të vetëm në detin e pamatë dhe unë, ndoshta ishim të mjaftueshëm për të krijuar simbolin.

22.5.07

OSKAR UAJLD

Çfarë nis e përfundon te Oskar Uajlldi ? Ndohta tërë kuptimet që prej elegancës magjike vijnë prej një rendi të natyrshëm të fjalëve ku gjithçka tingëllon si muzikë. Edhe ashpërsia e jetës e rreziqet rrjedhin përmes mendjes njerëzore me gurgullin e tyre të magjishëm. Ne nuk kemi përherë fuqinë në duar apo në krahë për ta bindur tjetrin, por Oskar Uajlldi si një Ezop modern përmes përrallave të tij na tregon udhën se si prej saj mund të lindet një mjeshtër. Ai nuk kujdeset për fjalën sepse asgjëkundi nuk duken të qepurat e saj. Rrjedha e një burimi është po ajo edhe kur kapërcen një pengesë për tu shndërruar në ujëvarë. Ai nuk e ka problem kuptimin me kohën sepse keqkuptimi me të ndoshta do të ishte edhe më i dobishëm se vetë kuptimi. Në përrallat e Uajlldit është jeta e ëndërruar por ti je duke ecur përherë brenda realitetit të një ëndrre. Ky sër i letërsisë botërore i ka bërë tërë blasfemitë e botës/ po t'i referohemi edhe titullit të një prej përrallave të veta/ është pikërisht Princi i Lumtur. Dhe prej çdo leximi në fund të fundit ajo sjellë në shijen tënde një aromë të panjohur më parë. As ti vet atë nuk di si ta shprehësh, sepse përjetimi i saj është kaq vetjak sa nxjerrja në treg e tij do të shkatërronte krejt embrionin e qelizat e vet burimit prej nga atë vinin. Prej një nga më fisnikët e letërsisë botërore përftojmë kënaqësinë e një leximi në mbrëmje para gjumit. për të parë një ëndërr edhe më të bukur. Oskar Uajlldin e

kam parë si një prej figurave më të ndritshme të letërsisë botërore. Dhe besoj se janë prej atyre yllësive që nuk do të shuhen kurrë. Sepse janë të brishta dhe nuk hyjnë kurrë me përdhunë nëpër ndjesitë tona. Përmes librave e sidomos përrallave të tij, Oskar Uajldi na u përfytyrua edhe vet si një përrallë e bukur. Edhe pse përkohësisht ajo na bënë të harrojmë dhimbjet dhe ikijmë të tërë për t'i dhënë dritë këtij ylli të largët. Uajldi është aty. Dhe pse të mos e besojmë që Princi i Lumtur i përrallës së tij një ditë në realitetin e jetës sonë ka për të zbritur. Sepse në çdo lexim që do t'i bëhet veprës së tij ne jemi pelegrinë që ecim për të marrë dritë për të ndriçuar errësitat tona. Ky shembull brilant tek unë për fat u zbulua prej pasqyrës së Borgesit ,prej ku është përcaktuar dhe fati i të pavdekshmëve.

8.5.07

SJELLJA DHE PRURJA

Sjellja dhe prurja e diçkaje më pranë vetes mund të sjenë dy nocione thellësisht të ndara edhe pse në fushën e gramatikës ato trajtohen si sinonime të njëra-tjetrës. Por letërsia i ndanë ato qartazi për t'i dhënë ndriçime të tjera shprehjes, duke e përkufizuar më qart anën semantike të tyre, më qëllim që të rritet intensiteti i kumunukimit. Këtu është thjesht çështja për të shpëtuar gjuhën prej përdorimit të saj të vazhdueshëm, prej së cilës shumë fjalë mund të dalin dhe jashtë përdorimit. Këto dy fjalë secila më vete na lejojnë tu afrohemi dhe largohemi kuptimeve të tyre fillestare. Sjellja/në kuptimin e mbartjes së diçkaje prej diku më afër nesh/për të veçuar këtë lëvizje të çdo lloj objekti në natyrë. Vetëm për lumin të sjellurit e ujërave të tij në gjuhë këto quhen prurje. Për artet dhe letërsinë cilësore kjo është bërë fjala më përcaktuese duke hequr natyrshëm paralele me rrjedhën e lumit në raste të ndryshimeve pozitive, rritjes së nivelit të ujërave duke i dhënë fund periudhës së tejzgjatur të thatësirave, për ta sjellë klimën në një erë të re ndryshimesh. Ndërsa sjellja (e diçkaje duke e lëvizur prej pozicionit të saj fillestar) si një nevojë e lëvizjes gati mekanike, ku përfshihen edhe instiktet, është në vetevete lëvizja e përditshme, lëvizje që i ka të përcaktuara që më parë rezultatet. Ajo e ka shumë të ngushtë perimetrin e saj të përdorimit sepse është e varur prej përditshmërisë, nevojës dhe riciklimit. Kjo është e

ngjajshme me frymëmarrjen duke dhënë e marrë masa të barabarta ajri që nuk gjenerojnë ndryshime. Në letërsi e arte sjellja në fund të fundit nuk është domosdoshmëri e risisë. Shkruhen shumë libra e ekzekutohen shumë pjesë muzikore e ekspozohen vepra pa mbarim në pikturë, por vetëm në raste të veçantë ne kemi të bëjmë me prurje dhe sasia nuk e sjellë në mënyrë mekanike cilësinë. Prurja është cilësi e tillë që ndryshon vet performancën e rrjedhës.

10.7.07

QYTETARE E BOTËS

Poezia shndërrohet në një unitet vetëm atëherë kur dëgjojmë prej saj një tingull. Dhe kjo ndodh kur brendësia jonë e ka dëgjuar më parë trokitjen ose thirrjen e rojeve që na ruajnë. Ne në çdo çast jemi të ngujuar te vetja prej rrethanave për tu mbrojtur. Por ky deri tani nuk është askurrëfarë rezultati. Ne ende nuk jemi hapur ndaj botës. Poezia mund të jetë një nga këto thirrje që po pati fat mund të kthehet edhe në një lloj lumturie, e ndodhur befas para një zbulimi. Por vet poezia është ajo që lind për të lëshuar këtë thirrje. Dhe nëse s'është e tillë përherë do t'i mungojnë një nga dy kushtet e domosdoshëm për të vendosur komunikimin. Që në hyrje fola për një lloj uniteti që do të thotë se ajo vet duhet të dijë çfarë është për tu bërë qytetare e botës. Por i duhet edhe një cilësi tjetër: të dijë të hedh ura, ura të përtejme njëherësh në të gjithë brigjet. Lëndë që e përmban të tërën e mundshme, udhëtim heroik i një blete që përfundon në vdekje. Ajo që ka mbetur është një pikëz mjalti në hoje aq sa ç'mund të sjellë kjo mesazhere e kohërave në thumbin e saj të vogël.

5.6.07

PUSHTETI I POEZISË MBI KOHËN

Referimi te zoti si një përpjekje për ta hapur poezinë drejt pafundësisë dhe pamundësisë së shpjegimit. Poezia e zbulon këtë burim në mënyrë të natyrshme pa lidhur asnjë kontratë për të qënë e detyruar t'i japë besimin e saj përfundimtar. Sa e sa herë gjatë rrjedhës së poezisë vijmë kumbime të tillë nën e jashtëtokësore për t'i dhënë asaj bekimin e shpirtit të injoruar kaq shumë prej shoqërisë së konsumit. Ajo e pakufishmja që siguron përmes saj aftësi për ta rrokur njëherësh krejt universin. Atë që në biseda të zakonshme do ta etiketojmë si çmenduri poezia e organizon në mënyrë gati perfekte. Për të zhbërë çdo lloj kufiri dhe për të qënë në çdo çast e gatshme për t'iu përgjigjur zërave të brendshëm, që përjashtojnë ulërimat dhe duartrokitjet e turmës. Është nevojë e shtysave të thella që kërkojnë një shtrat për tu shprehur. Lavdi poezisë që i bënë përgjumjet tona pasuri të ëndrrave, klithma dhe vegime që japin shenjë se zjarret brenda nesh rrinë përherë të nezur. Dhe çdo lloj mundësie tjetër qoftë ngado që të vijë në shërbim të saj çohet sipër në formën e avujve kaltëroshë, për ta bërë magjik çastin që një vend në përjetësi është duke e kërkuar. Drejtimi te zoti është lutja mbrëmësore e pafajshmërisë dhe gabimit tonë të përherëshëm, por edhe e fajit fatal të cilin tani e kemi mbyllur pas hekurave me dënim të përjetshëm. Atë që thotë poezia dhe s'mund ta thotë askush tjetër. Është njeriu që ia ka dorëzuar veten kësaj perëndie jo thjesht te

besimi por si pohim të pamundësisë, qoftë edhe si pakt për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Më larg se poezia besoj se s'mund të shkojë dot askush tjetër. Herë-herë përftyrimi i saj i ikur larg bëhet pa kthim. Si një mundësi e pashterur ajo e thërret kohën pas saj. Pushteti mbi kohën ndoshta është atributi më madhor i poezisë.

22.6.12

LIBËR QË KURRË S'DO TË MBYLLET

Përmes vrullesh të tillë dhe pas ndërprerjeve të herëpashershme ne më në fund kemi mbërritur te një realitet tjetër i cili tani është plus një libër. Kyçëm aty përvojën për të mos vdekur. Duke shpallur të kryer detyrën ne zumë prapë radhën në ecje pa vënë re se cili nga zakonet e ecjes sonë tani kishte hap tjetër. Ti më kot kërkon të vesh re diçka që s'ekziston ende. Prej asaj të kyçure njeriu do kërkoj ndihmë kur ta ketë thirrur nevoja. Ndoshta duhet edhe 100 jetë që Gobseku mes nesh të bëhet i dallueshëm pasi Balzaku të ketë vdekur. Një pjesëz të misterit tonë e kemi vënë në një shishe të hedhur në oqean si mesazh për të ardhmen. Kyçja e përvojës në një libër është shumëfishim i saj, shoshitja ose kullimi për t'ia bërë më të lehta barrët njeriut të së ardhmes. Të mendosh për miliona njerëz si po e vjelin këtë pemë në çdo stinë të urisë e etjes së tyre. Libër që nuk do të mbyllet kurrë dhe do të belbëzojë foshnjërinë e vet nëpër buzët me qumësht. Një proces shumë i gjatë dhe i ndërlikuar për tu vënë re përveçse i vështruar nga larg do të kuptojmë prej ç'thellësie në këtë realitet jemi bërë të pranishëm.

26.6.12

MOS IA PËRBALTË NDERIN UDHËS

Mos bëj përsëri krimin tjetër duke më lënë në mes të rrugës. Të harxhosh një fjalor të tërë dhe të harrosh pa shkruar në të fjalën e fundit. Kur t'i kthehesh rileximit gropat do të jenë thelluar edhe më tepër. Ti kurrë s'ke për tu shfajësuar dot para kohës që ia përbalte nderin kur të besoi kronikën e saj për ta shkruar. Këto gjëra gjysma që asnjëherë s'do munden të japin një numër të caktuar. Mbylle portën për të ardhur gjuha në mendje dhe të vijë kohë e ëndrrave. Mos lerë asgjë përgjysmë se do të ketë përherë të tilla në qiell që nuk na çojnë dot lajm për mesazhin që janë duke sjellur. Shkëndijat që u shuan nuk e ndezën zjarrin e madh që na kishin premtuar dhe s'mjaftojnë as lutjet për ta rikthyer vrasësin në vendin e krimit. Një vepër duhet kryer e plotë dhe kështjella të ketë hapur portat për të na pritur, ndërsa prej frëngjive të saj është duke ardhur ajo kohë që i nevojitet së tashmes. Për të ardhmen nuk ka dritare tjetër. Ajo më vonë si mungesë do shpërthejë krejt kështjellën për ta zhdukur jo si rrënojë, por si ide që nuk i mbijetoi dot kërkesave të së ardhmes. Por a është emundur që të shkruhet nga fillimi në fund e tëra? Nuk do ta besoja kurrë se kjo gërmë që u bë vet fjala të vibrojë një jehonë kaq të zgjatur. Mes këtyre dy mundësive mund të themi se ajo që na pengon për ta përfunduar është vet dëshira për vazhdimësi. Por vetëm jehonat e sjellin zërin në një epokë të re, prej nga do të kumbojë me një timbër të ri vet gjuha.

Si pavdekësi, si nevojë ajo te një pikë është ndalur, te një presje merrë frymën e çastit për të vazhduar më tej. Kurrë asgjë s'ka për tu shterur, sepse te fundi kush guxon për të shkuar më parë i është frikësuar tmerrit.

21.5.12

PREJ ÇASTIT NË AGONI QË ËSHTË DUKE ARDHUR

Çdo e shkruar është një lloj agonie për të dalë prej një gjendjeje pas së cilës do të vijojë zakonshmëria, por në një rrjedhë me të kthjellët. Ose kështu duhet të ishte sepse jo çdo lloj e shkruare mund të rezultojë si e tillë, përveç asaj që ka marrë bekimin e kohës. Pasi kemi njohur në një farë largësie shpirtin njerëzor priremi drejt thellësive të tjera që përvijojnë nevoja më të mprehta të shprehjes. Ato që s'mund të jenë tjetër përveçse përpjekje për heqjen e pengesave dhe kalimin në një tjetër lloj gjendjeje. Nëse do t'i referohemi lumit vërshimet e tij janë ajo përpjekje titanike për të nxjerrë nga fundi një luzmë gurësh e dherash prej një mbretërie gati të përjetshme. Le ta lemë shpirtin të flas në kohën kur thirrja e tij bëhet e papërballueshme. T'i japim shkëndijë kësaj energjie që ushqehet prej përditshmërisë së vet gjer te çasti i shpërthimit. Kemi për tu parë në më tepër dritë që na njeh me errësitat e thella prej nga ajo është duke ardhur. I jemi dorëzuar këtij vullneti hyjnor dhe mendja njerëzore kapërcen kufijtë për të nënshtruar të panjohurat. E panjohura e largët si kufi përherë i rrezikshëm. Duhet kryer si udhë takimi me të dërguarit e duhej shkruar pikërisht këtë çast ajo që u bë vet shpirti i saj. Është një udhëtim përherë në natë. Flas për të shkruarën si zanatin tonë më të vjetër. I goditur mijëra herë prej këtyre rrufeve ne mbajmë përherë në alarm pjesën më produktive të mendjes. Siç e kam ndierë unë veten në këtë përleshje, ku pothuaj në më

të shumtat e herëve kam dalur i humbur. Besoj se është një përvojë që tregon sa të pakta i kemi shanset për tu bërë të pavdekshëm. Prej çastit në agoni që nisët për tu lindur, por që edhe atë çast mund të jetë duke vdekur. Nëse është kalorëse do t'i ndiejmë vikamat e shpatave në ajër, ardhje të ushtrive të tjera që e çanë me shpatë horizontin. E kuptova se kjo pjesëzë eseje duhej shkruar pikërisht këtë çast, për të ndalur hemoragjinë e gjuhës/fjalëve/ kur unë po bëhesha gati për shpërthimin më të fundit të bërthamës energjitë e së cilës asnjëherë nuk do të reshtin.

24.3.13

BORGESI SI GJURMËLËNËS

Borgesi shndërrohet në çudi, shndërrohet përherë në problem të një letërsie tjetër duke e përkufizuar veten si një gjurmëlënës i famshëm. I gjendur aty pikërisht ku shënon Njeriun dhe Kohën dhe kurdoherë për të ngatërruar qëllimisht konceptet që u mungon siguria dhe guximi për tu artikulluar. Gjithçka që ai shpreh është dyshimi rreth asaj çka është thënë për ta lënë botën nën frikën e një pushteti të panjohur. Borgesi është inatçor i sertë ashtu siç është ëmbëlsi e vet gjuhës së cilës i vihet në shërbim me vullnet të pakufishëm. Borgesin ne kemi për ta ndeshur përherë përpara në formën e një miti modern, ku të ardhmet me të do vazhdojnë të argëtohen. Ai shpronësoi dijen duke i dhuruar inteligjencën e vet së ardhmes për të mos iu ndryshkur kurrë armët e luftëtarit. Është ai që pa thënë plotësisht dhe gjithçka e solli letërsinë në një zgrip të rrezikshëm, kur një dije mund të hedh në erë tërë konceptet e së shkuarës mbi Njeriun dhe Kohën. Ai guxoi duke u tërhequr me lavdi për ta lënë këtë rrugë të hapur. Ai ka mbërthyer tema të pafundme në një temë të vetme pa i përcaktuar asnjë fakti apo shtjelle ngjarjesh datën ose thjesht kohën e saj të lindjes. Meqënëse debati mbi Borgesin kurrë s'ka për tu shterur, neve s'na mbetet gjë tjetër veçse interpretimi i tij. Që thjesht mund të jetë edhe Sokrati i pastremijë vjetëve dhe Athina e atëhershme, thjesht bota e ardhme e njeriut. Borgesi është koncept, ai nuk është qenie i njëherë e një

kohe. Ka ekzistuar si bibliotekar i famshëm i lëkurëve dhe papiruseve, i gdhendjes nëpër shkëmbinj i asaj që më vonë me shkrimin kuinformë do të shkruhej. Është krejt qënia e një njeriu të vetëm i njohur prej së paku deri në 7 për qind të njerëzve, në një kohë kur 93 për qind e të tjerëve iu trembën duke u larguar këtij rrezatim ‘atomik’. që la pas një çpështjellim të pazakontë dhe, nevojën e vendosjes së një rendi të ri të koncepteve të mëparshëm, duke zbuluar pikën e artë të takimit të letërsisë me filozofinë.

9.1.2017

NJË VDEKJE E PANEVOJSHME

Ai u bë model i një vdekjeje fare të panevojshme. Askush s'e kujton jetën e tij përveçse vdekja që e gëlltiti njëherësh tërë jetën e tij për të mos lënë asnjë gjurmë. Sepse vdekja edhe mund të kishte pritur. Por armiqësia dhe arroganca e saj nxitoi të shprehej me gjasë për të mbetur vetëm ajo pikë referimi. Meqënëse jeta e tij kishte qënë tepër sedentare edhe vdekja e tij kishte qënë fare e panevojshme. Të dyja: jeta dhe vdekja thjesht ishin duke lozur me kohën. Duke qënë e panevojshme ajo s'kish si të ish edhe e parakohshme. Ajo vdekje kishte qënë e panevojshme sepse jeta e saj kishte qënë e paqëllimtë dhe rezultati i kësaj përplasjeje, do të kishte qënë një barazim i bardhë që nuk ngjallë asnjë lloj emocioni. Tani pa asnjë gjurmë po përpiqemi t'i sillemi objektit tonë sa më afër. Një njeri serioz që prej inteligjencës ngrihej pak mbi shtresën e të mesmëve. Por edhe te kjo shtresë ka shumë nënshtresa që mund të përfundosh te nënshtresa e fundit. Ndërkohë që vdekja na kanoset të gjithëve këtë herë ajo goditi në pikën më të dobët për të kaluar pa lënë asnjë gjurmë dhe vëmendje të tjerëve, përveçse do trondiste në këtë rast raportin e jetës me vdekjen. Duke qënë e panevojshme ai edhe mund t'i kish mbijetuar vdekjes. Edhe mund të jetonte njëlloj siç prej kohësh kish jetuar, por ja që koha s'na le mundësi më tepër për ta pritur. Rezultati është kjo viktimë e panevojshme po aq edhe e pafajshme. Veç rituali edhe

në këtë rast do na kujtojnë vdekjet e madhërishe prej një thike pas shpinës së Çezarit dhe, historia do të ndalej kaq e kaq herë për të regjistruar çdo detaj të kësaj vdekjeje, që e bëri vdekjen e Çezarit të nevojshme. Miku ynë tashmë sidoqoftë la gjurmë të një lloji tjetër, duke mos pritur dot kohën e një vdekjeje të madhërishe.

13.12.2018

NËPËR KTHINA KU MISTERI RRI FSHEHUR

Çelësin e kësaj të fshehte e mba përherë një murg. Ai që i vëzhgon jetët tona atje ku ne nuk guxojmë t'i shprehim. Poeti është i ftuar prej nevojës për të zbuluar misterin, të cilin përmes dordolecëve në një arë me grurë ne e kemi përqeshur. Poezia s'mund të jetë kurrë vetëm një çështje e jetës private, nëse nuk përcjellë një tingull shoqëror, aty ku njeriut prej opiumit të përditshmërisë i mungon një dritë që vetëm poezia është duke ia sjellur. Atë e kanë ftuar në ballo pasi është konsumuar pija dhe trupat e lodhur kërkojnë një kënd në dritëhije për tu prehur. Ajo që do na zbulojë mungesën që vjen pas dehjes. Ajo që ka parë nga dritarja si u errë papritur bota jashtë nesh dhe tani është koha për të ndezur një dritë tjetër, për ta parë veten nga brenda. Poezia pa qënë e tillë kurrë s'do të kishte qënë. Ajo harxhon energjitë më të pastra të ndjesive tona, që njeriu të realizojë në një mënyrë tjetër veten. Ajo pret kohë shumë të gjata për të folur kur ndien si majiset frika te njeriu përballë një realiteti të panjohur. Ajo që është aq ne sa ne s'mund të jemi tërësisht ajo. Dhe nëse përgjatë kërkimit s'ka takuar atë që kishte dashur, me suguri në kthim lind pendesa ku të tjera ndjesi njeriu është duke i provuar. Sepse udha nuk kish nevojë për të dhe ajo kërkonte një kënd tjetër për ta përgjuar jetën aty ku ajo qëllimisht i ishte fshehur. Njeriu që diku në pyll dhe në errësirë mund të ketë humbur busullën. Poezia nuk i imponohet askujt por i jep frymën e saj atyre që është duke u mbaruar oksigjeni.

3.1.2018

LUFTA DHE PAQJA

Etërë kjo pjesëz ka një frymë zemërimi por nuk arrin dot të na tregojë shkaqet. Ajo nuk na tregon dot edhe se prej kujt është e mërzitur. E përplasur me rrethanat ajo u gjend në këtë zgrip gati për tu shpërthyer. Dhe e veshi me bomba trupin e saj dhe shkoi të vetvritej duke vrarë më parë një numër sa më të madh njerëzish. Asgjë, megjithatë nuk zgjidhi , sepse të gjallët e mbetur do të kenë bërë një marrëveshje në prag të të asgjësimit. Te kjo copëz e vogël është Lufta dhe Paqja, një mijë herë më e vogël dhe rritet prej zemërimit të Akilit dhe profecitë e Kasandrës, për shurdhimin e përgjithshëm të botës. Do të ketë dhe më shumë shkaqe të tjerë që i sollën fjalët e mia në majë si gjuhë gjarpr, prej nga dëgjohet fërshëllima që i injekton pak helm shurdhërisë së botës për t'i kthyer asaj dëgjimin. Gjersa vendosi të shkruhej ajo i ka dalë zot vetes dhe e bëri ujem kodin e bashkëjetesës dhe e shpalli qoftë edhe vetëm prej njërës anë luftën. Njeriu iu dorëzua të papërballueshmes. Kur i kisha hedhur letrat me zemërim mbi tavolinë asi më kish rënë mua – një fytyrë murtaje njeriu që e mohoi miqësinë time. Zemërimi ecën me ty duke rjepur një nga një tërë lëkurët gjersa më thellë kockës të jetë ngulur thika. Nëpër këtë pjesëz letrare të vogël të trembur prej heronjve te lavdishëm, zemërimi paraqitet në formën e ca rrëkerave gurgulluese që vrapojnë për të mbytur veten te lumi. Edhe kur unë i ve përballë arsytën është gjaku që po kërkon shtrat të ri për trupin e vet dhe, arsytës iu këputën frenat dhe te lumi pas këtij çasti do të dalin në brigje tërë të mbyturit.

12.12.2017

PËR BETIM MUÇON

V diq miku im dhe prej një respekti të ndërsjelltë edhe dhimbja ime nuk do t'i ngjante të tjerave. Jo si ato që u panë në TV edhe pse unë e përcolla çdonjëren prej tyre me dhimbje të thellë dhe kujtesa më ndimoi të zbuloja dhe një herë, fillin e miqësisë që me poetin Betim Muçon më kish mbajtur lidhur. Unë për shkak të largësisë i mungova kësaj shprehjeje ceremoniale dhe, prita ca kohë gjersa tronditja të bëhej shkak për të zbuluar një ndjesi të tillë sa njerëzore po aq edhe personale e shoqërore. Unë kisha humbur një mik të shtrenjtë sipas mënyrës sime dhe asaj çka ai kishte përfaqësuar tek unë, duke e kujtuar në çaste që tani po mbusheshin prej atyre çfarë më parë u kishte munguar. Por edhe te çasti kur zbrazëtia jote bëhet e padurueshme. Dhe ja tani jam unë që e kam marrë fjalën pasi udhëtimi i poetit e mikut tim ka heshtur. Si të kisha një borxh të vjetër për ta kthyer tani në një mënyrë tjetër. Në vdekje ku borxhet paguhen pa interesa dhe unë nuk them asgjë që ka pendesën e një borxhi të pashlyer. Një mik sidoqoftë është një pjesë e rëndësishme e jetës sonë, i cili ndërhyne sa herë asaj i prishen ekuilibrat. Si e kam njohur unë Betim Muçon është ndoshta përpjekja që bënë njeriu për të njohur veten te një tjetër. Dhe njeriu që ta shpërblen gjithë këtë me një vdekje të pabesë e të hershme. Siç goditet realiteti papritur prej një rrufeje. Ndoshta ju prisni që unë tani të flas për personalitetin e shquar letrar e shkencor të

Betim Muços, ndërsa unë tani me këto fjalë dua thjesht të kuroj dhimbjen time. Unë i kryej falas tërë shërbimet për ta kujtuar sa më shpesh njeriun që e zbulon rrallë dhe i keqardhur se nuk do të gjej tokë tjetër për të mbirë në të kjo farë e çditshme. Ne që mbijmë nëpër kujtesa të njëri-tjetrit, për tu bërë kujtesë kolektive e ruajtjes së vlerave dhe e ndjesive më të thella, që e bëjnë pavdekësinë jo thjesht një slogan metafizik por diçka të qënësishme, pra edhe të pavdekshme.

2.11.2017

HEMINGUEJ

Ai që la shenjë përgjatë nxitimit me të cilën e përshekoi kohën. Ai që e vuri në pikëpyetje vet moralin e saj. Ai që ishte kudo pa qënë kurdoherë fizikisht i pranishëm. Ai që i përbuzi recetat dobiprurëse të moralit dhe nxitoi të bashkojë skajet me qendrën e saj. Çdo afrim tjetër rreth figurës së tij është diçka e munguar që kurrë s'ka për tu përmbushur. Sepse Heminguej ishte i papërkufizueshëm. Sepse çdo beteje ai i ndërronte armët e luftës për tu bërë edhe më i paligjshëm. Ai duke qënë revolucionar e shpalli revolucionin të padobishëm. Ai nxitonte për atje vetëm për të marrë dëshmi dhe ikte në një tjetër betejë për të luftuar me leopardët e Afrikës. Dhe sa e pamundshme për ta përkufizuar, ndërsa gjithçka e shkroi thjesht për ta bërë kujtesë të njeriut. Ne nuk dimë cila është studioja e tij dhe nëse ai e kishte një të tillë dhe ku e merrte lejen për të vizituar me magjinë e saj botën. Diçka që kurrë s'ka për tu shfaqur më me atë madhështi të thjeshtësisë së tij. Ai e zbuloi burgun për tu futur vet në të. Heminguej ëshhtë një figurë letrare që bishtoi botën kur në skenën letrare të saj loznin emra të mëdhenj të letërsisë botërore. Në një farë mënyre përmes veprës dhe sjelljes ai u bë përcaktues i vet epokës, gati duke e përjashtuar veten prej saj nëpër aventura që i sillnin dritës hijen dhe anasjelltas. Sepse filozofia po të ngarkohej me këto bëma antimorale dhe antikohë, do ta kishte strehuar shkrimtarin e madh duke e tretur brenda saj

për të mos mbetur asnjë gjurmë prej tij. Po për fat ai u shpëtoi këtyre kurtheve dhe vetëm përmes intesitetit të çdo veprimi, e zgjati lavdinë e tij pafundësisht.

11.11.2017

SHTRATI EUROPIAN I POEZISË SHQIPE

Dhe kush vallë trembet prej këtij ndryshimi? E vërteta sot është zonja /fryma/e ndryshimit. Një opinion pozitiv në rritje rreth saj është shenja më e mirë se poezia po e kap kohën e humbur. Prej guximit nuk duhet trembur. Nuk shtrohet problemi për tu kopjuar modele por të hyjmë në rrjedhat e zhvillimit bashkëkohor, i cili po tregon fuqinë vet për të thithur tërë kapacitetet intelektuale të bashkuar rreth poezisë. Por ka edhe mendje të trembura që po u ikën për dore filli i gjykimit njëherësh me shterjen e argumenteve. Rugën që poezisë ia hapën një grup të rinjsh por edhe poetë të tjerë të pakompromentuar aq tepër në ruajtjen e një statu-quo-je të dëmshme. Tani ka jo vetëm një shenjë por shumë të tilla që tregojnë se dhe kuri kemi hyrë Evropës në zemër, kjo qenie që e shëron plakjen e vet duke ndërruar vazhdimisht gjakun. Tërë zërat e poezisë së saj shkojnë drejt një prirjeje të vetme: çlirimi prej dogmës duke rritur forcën shprehëse të saj me teknikat që inkurajon vet zhvillimi. Jo lotë dhe psherëtima për humbjen e së shkuarës. E shkuara do të jetë përherë te ne në formën e rrënjëve. Shpirti i Homerit si shembull dhe koha e poezisë që vazhdimisht është duke ardhur. Asgjë nuk mund të gjykohet veç e veç dhe kur asaj litarin në fyt ia kemi hedhur. Por s'mund të guxojmë më tepër deri në blasfemi, për ta ndaluar me dhunë të ardhmen që meriton një pritje më miqësore. Ajo që çdo çast prej lëvozhgës është duke flakur fytyrën e vet, atë nuk ia fsheh më dot kohës. 28.3.2008

RRETH NJË SKICË- IDEJE

Ndoshta këto çapitjet e mia duhen lexuar në gjendje të dehur përndryshe ato do të mbeten të palexueshme. Kam bërë shumë prova lakuriq duke i veshur për të zbuluar kohën kur i kisha shkruar. Ato nuk mund të lexohen ndryshe edhe pse shkruesi i tyre është ende gjallë dhe nuk kujton dot pse e si i ka shkruar. Secili e kupton se koha e tij sapo ka vdekur dhe ti më kot pret të lexosh kur era është duke i mbuluar gjurmët e shkretëtirës. Një herë prej një të ardhmeje shumë të largët isha sulur drejt një të shkuare që nuk po më jepte asnjë sinjal . Ç’po lexoj tani të shkruar dikur vjen me peshën e një humbjeje. Atëherë atë ia kisha bërë dhuratë kohës por tani u bë tepër vonë për të mbajtur këtë medalje, që së fundi më dërgoi si dhuratë e shkuara.

Këtë realitet dua ta përfshij me gjithçka në kuptimin që t’ia kthej atë letërsisë. Kjo ka qënë përpjekja e vetme e njeriut që u vu në qendër të tij për t’i zbuluar papërsosmërinë morale e fizike. Shkrimtari e përjeton realitetin gati si somnambul. Është e nuk është në të dhe më shpesh ai del edhe vet prej tij pa u njehsuar me të tërësisht. Realiteti për krijuesin është një sfidë e përhershme por edhe një kërcënim për t’i mbyllur atij perspektivën. Dhe krijuesi/ demiurgu/ që nuk vllazërohet shpesh me të më tepër është surdisur në margjinë. Kjo e bënë edhe më të mprehtë majën e bisturisë së tij. Ai përherë zbulon në të nevojën

e shndërrimit duke identifikuar pengesat. Duke folur për krijuesin ne në fakt jemi duke folur për realitetin i cili nuk pranon të ulet në sallën e operacionit. Ai i trembet krijuesit që i zbulon shkakun e erës së keqe të Frymës. Duke qënë revolucionar prej natyre, krijuesi nuk e ka ende në dorë realitetin e ri, sepse atij përherë do t'i mungojë flamuri që udhëheq betejën.

3.7.18 - 19.6.18

DREJT NJË SHTEGU TË RI

Poezia e Ardita Jatrusë e botuar para pak kohësh te portali Fjala e Lirë me titullin Safo tregon se si mund të ndryshojë kursi i poezisë. Ishte befasi të shohësh poezinë e dikujt të eci në një rrjedhë tjetër. Përmes kërkimit e ushtrimit të përhershëm poezia lëviz dhe vjen një çast kur brenda saj gjendet vet çelësi i ndryshimit. Me përvojatje por më në fund poezia shtratin e saj e gjeti. Poezia është nisur për tjetër shtegtim ndoshta më të largët, jo thjesht si udhë por si kërkim për të qënë diçka tjetër, përtej përditshmërisë së saj e kapur peng prej rimave foljore e ritmeve strikt, që u japin komandën shprehive pa i lejuar të artikulohej siç vijnë prej burimeve. Se Feaone, i dashuri i Safos do të bëhet më në fund ylli i saj. Sepse poezia është përherë një njësi e vetme dhe e përhënur dhe vetëm si e tillë ajo ecën drejt përsosmërisë së vetes. Jatru me këtë poezi na detyron ta rishikojmë prej një këndi që kurrë më parë nuk e kishim parë. Sepse që prej këtij çasti poezia merrë prej bashkëkohësve të vet lejen/uratën/ për të udhëtuar e lirë drejt shumë zemrave të hapura në pritje. Duhet të ketë qënë një laborator i përvojatur eksperimentesh, ku janë djegur në flakë frymëzime për atë pak lëndë që mbyllet nëpër ato epruveta të vogla prej qelqi. Dhe që prej këtij çast poezia e Jatrusë bëhet më vete- poezia e saj e ngatërrueshme me shenjën dalluese të një premtimi të ri. Kjo poezi qoftë edhe e vetme/tani për tani/ na nxit kureshtjen për të eksploruar

në shkaqet që atë e kanë lindur. Më është dashur shumë kohë që pas poezisë së Armela Hysit të zbuloj diçka tjetër të qënësishme, por për çudi edhe kësaj here një femër. Një poezi e bukur është një akt i rrallë lindjeje. Ekziston një pikë kthese ku përvoja paskëtaj ka nisur një rrugëtim të ri. Ajo kthehet në një shfaqje ku fjala në skenë këtej e tutje do t'i lozë tërë rolet.

20.8.2018

SADIK BEJKO

Në atë çka mbetur dhe kujtesa ka vendosur ta ruaj ngjendet diçka ende e pakaluar në filtër. Sepse ne të gjallët jemi duke jetuar ende gjendjen e viktimës në pritje për tu bërë martirë të kohës. Në të shkruarit shqip si gjuhë e vogël e këtij rruzulli të madh, duhet të veçojmë me kujdes si duart që dridhen tek ndajnë grurin nga egjërat. Këtë punë dua të kryej unë tani me përgjegjësinë ‘profetike’ për ta veçuar prej kalimtarëve atë që doja t’i vendosja një shenjë, për ta bërë një grimcë të historisë që jo kurdoherë është e pagabueshme dhe kap në rrjetën e saj vetëm një Hamlet ,ndërsa miliona hamletër tashmë pa lënë asnjë gjurmë kanë vdekur. Dhe nëse tani po vendos t’i afrohem objektit tim, Sadik Bejko më vjen edhe më pranë. Duke e njohur në tërësi atë që ai ka shkruar unë po i bëj një nder vetes jo atij që zgjedh një kënd për ta vendosur. Poeti që nuk shkruan vetëm poezi por u ushtrua te eseja dhe dha leksione për qytetërimet, ai që u kujdes për botimin e poezisë së Kadaresë për t’i bërë asaj një paraqitje sa më mjeshtërore, tani ka punë me vëzhgimin tim që e kapi si flutur në ajër dhe e mbërtheu te krahët. Ai që hyri rastësisht në politikë por që nuk di ç’fitoi e ç’humbi prej saj. Njeriu që le një gjurmë për tu përballur më vonë me vëmendjen e shtuar ndaj tij. Bard që mbartet për në kohët moderne duke u ruajtur autostradave kujtimin e shtegut të dikurshëm. Një muzikë e ëmbël vjen

prej poezisë së tij, e shtruar e latuar prej një urtësie gati profetike. Të fjalëve të shqipes që ai i thuri me aq elokuencë dhe nëpër të nuk gjen kurrëfarë tingujsh parazitë që mund të prishin melodinë e tekstit. Për ç'kam lexuar prej Bejkos është ajo diçka e dëshirueshme që përherë na largohet dot pa e mbërritur. Sikur të kisha edhe më tepër kohë këto fjalë do të ishin përthyer nëpër nuanca të tjera të gjuhës. Pa patur për qëllim të ndalem gjatë duke lënë për një kohë tjetër për tu takuar me krijimtarinë e poetit, po nxitoj ta ve këtë shenjë te një ligjërimit tjetër më i thellë i të shkruarit shqip, ku besoj se përherë duke e artikuluar do të na detyrojë drejt tij të kthejmë vëmendjen.

23.9.18

NË STUDIO E SHKRIMTARIT

Është duke endur një mozaik të bukur por pa u kujdesur shumë për figurën që në të është duke u formësuar. Por cila është vlera në të vërtetë e saj? Pamja e një kopshti botanik të thurur aq mjeshtërisht por vizitorët nuk e zbulojnë dot dorën e endësit. Te një shkrimtar duhet të këndojë vet gjuha të cilën e përmban vet kultura. Do të isha tepër mizor të bëja shartimin e këtij kopshti të harlisur fjalësh sepse do më digjnin duart vetëtimat që në çdo prekje do shpërthenin njëherësh. Vetëm e vetëm pse doja të hapja një udhë përmes këtij kopshti ,mund të kisha prishur krejt magjinë e tij. Një zog që nuk mund të këndojë ndryshe, i harruar prej kaq kohësh në një pemë. Letërsia ka nevojë edhe për këtë zë që unë të ushqhem prej magjisë së tij. Kjo ndodh sidomos te eseja si prognozë letrare që mbruhet prej një pafundësi shprehjesh. Le të argëtohem me këtë fantazi të gjuhës dhe ta lemë shkrimtarin të vetmuar te pema duke fërshëllyer. Si një zë baritor që i ka munguar katedra. Nuk i shquaj dot në të idetë, por mrekullohem me begatinë e mjeshtërinë e thurjes së fjalëve. Duket sikur të tërën e përshkon një frymëmarrje e vetme. Dhe nuk më lind mua e drejta të rrëmbejë në duar gërshhërët për të krasitur pyllin. Krijuesi është në të drejtën e tij për aq kohë sa penën e tij e drejton pafajësia e fjalës. Unë do të kisha dashur shumë gjëra që në këtë rast më bëhen të pamundura. Zëri magjik i një Orfeu që është duke ndjellur Euridikën. Dhe çfarë do të

kisha dashur unë bëhet edhe më e parëndësishme, përballë një ëndrre që shndërrohet e tëra në fije, për të endur me të diçka që më në fund mund të shënojë edhe lindjen e një kryevepre.

15.10.18

LIRIKA E MBRËMJES

Edi se do përgojohem pse Universin po ua tregoj në një miniaturë kaq të vogël. Dhe me çfarë? Te një bimë speci e zbutur por që rritet plot madhështi mes tokës dhe qiellit. Mes dritës dhe errësirës, i larë me dritë hëne dhe i ushqyer me dritën e diellit, që u shfaqën e lanë gjurmë nëpër kërcëjtë e gjethet e kësaj bime shembullore. Është bima e një speci djegës që rritet në ballkonin e shtëpisë sime e shndërruar së fundi në një serrë ku unë kryej vazhdimisht eksperimente. Tani jam duke e kundruar si vet universin. Në të është gjithçka edhe vet shkretëtira, planete të rëna në tokë. Lidhje të pafundme që një mendje e mjerë është duke i kapur si vezullime yjesh që shfaqen e zhduken. Bima si rastësi këtë çast është kapur peng prej meje, ngaqë mua përherë më kishte munguar një shpjegim sa më shkencor për universin. Kur shoh kokrrat e vogla në ngjyrë të verdhë që po formohen, ndiej një frymëzim për ta shkruar sa më bukur këtë lirikë të mbrëmjes. Dhe nëse s'do ta ndieja të tillë-thashë- universi nuk ekziston asgjëkundi aq më pak në mendjen time. Është përkorja e asaj që është por që nuk mund të shpjegohet. Sepse nuk kemi shumë fije në duar dhe ndonjë gjeth që zgjatet drejt nesh mundet në çast të rrëzohet nga era si fill i këputur. Ato na këputen gjer në kufi të arsyes sonë të mjerë, që tani po e shpjegon universin në bimën e një speci djegës. Por sidoqoftë ky është uneversi ngaqë ai edhe s'mund të jetë diçka tjetër, pa këto imtësira

e pa këtë sy që përmes gjetheve i shfaqet horizonti i mbështetur në krahët e një pafundësie që nuk duket. Nisa t'i kërkoja shpjegimet te bima e vogël që po rritej në një vazo më të vogël se trupi i saj. Ngadalë po e kuptoja se ky shpjegim ishte duke më sjellur një risi tjetër. Sepse ajo që ndodh çdo çast me Universin e Pafundmë ndodhte edhe këtu në një mënyrë tjetër. Edhe pse i trembesha këtij vëzhgimi laboratorik të ekzistencës që ishte duke më joshur së tepërmi. Sepse nuk shoqërohej me të bërtitura por me një qetësi gati funebre. Lulet dhe gjethet ishin trupa dhe merrnin frymë. Me një përhapje/shtrirje/ solide të kurorës së tyre. Botë e ngrohtë frymësh dhe një dalli që më vjen prej saj duke mos guxuar për ta prekur. Çdo gjë që ndodh në botën e madhe me rrapullima, këtu ndodh qetësisht dhe ti si një zot po kundron tani veprën tënde. Dhe do të ishe përherë i vëmendshëm për të mos dalur prej temës, e cila dhe këtë çast të mbanë lidhur me botën dhe ti ndodhesh aty thjesht për të marrë prej saj sinjale.

21.10.18

PRANOJE SI DHURATË KËTË LIBËR

Të shkruarit është një mënyrë për të kaluar kohën, nëse asaj do t'i mungojë lexuesi. Besoj se as një për qind e asaj që shkruhet nuk do t'i përcillet kujtesës. Ky nuk është një problem që e rrezikon aq shumë të përditshmen se sa e varfëron atë. Moderniteti nuk i dha dot zgjidhje racionale asaj që të parët e shkrimit kishin ëndërruar. Mesjeta e errët që doli në dritë prej Rilindjes, shpërtheu dritën e mendjes por ajo u dogj shpejt dhe libri u bë sërish viktimë. Dhe o zot sa shumë pak lexues në këtë mbretëri të vdekur. Dhe as që e përfytyron dot se si mund të ishte një shoqëri që e përjetonte leximin jo si hobi por si nevojë. Njeriu i trembet tmerrsisht metabolizmit dhe ikën me tmerr prej leximit. Mendja njerëzore ka shumë punë për të bërë dhe zgjerohen hekurrahësit e saj, për të zvogëluar të tjerat. Ngarkesat janë bërë shumë të papërbalueshme. Libri si shprehje që nga ai kueinform për të mbërritur te libri i sotëm përmes Gutenbergut, duket se kaloi në periferi të njerëzimit për tu bërë problem i ekzistencës së tij si zjarri apo uji. Libri më tepër u bë çështje e ca kokëkrisurve që përpiqrn të ushqejnë me besim njeriun. Të joshur prej këtij zbulimi njerëzit menduan se kishin zbuluar vet ilaçin e fatkeqësisë së tyre. Por indiferentët si përherë kanë zenë pozicionet e para 5 mijë vjetëve. Tani ka shumë biblioteka të institucionizuara, por të ngurtësuara brenda një orari që nuk e lejon leximin të përhapet dhe në vend të saj bien

mortajat e shpërndahen gjithandej viruse të rrezikshëm. Lexuesi i dikurshëm. Ndoshta kjo do të ishte një temë e preferuar duke bashkëjetuar me një të keqe që na është qepur mbrapa. Si metaforë libri tani shfletohet nga era për të mos u infektar prej dëshmime rrëqethëse të kujtesës. Vetëm një grusht trimash po i ruajnë pozicionet e saj me stoiçizëm. I ke dëgjuar ti vallë historitë e shumta që tregohen por që tremben të shkruhen? Po e hap këtë Bibël njeri për ta lexuar sipër kokës tënde. Ti që po e mbart tmerrin tënd me vete, çdo fjalë do që ta dëgjosh prej gojës së zotit dhe nuk guxon ta zbulosh atë vet, se i trembesh misterit që brenda një libri rri fshehur. Sepse ti i trembesh vdekjes. Libri është minë me sahat në mendjen tënde. Më mirë ti vazhdo të punosh tokën dh gëzoju bimës ku ka më shumë frymëzim dhe diçka eterike, që i ngjanë një leximi përmes të cilit njeriu i befasuar, është duke njohur veten.

3.3.12

EDHE NJË HERË PËR KADARENË

Këndimi i Kadaresë merrë hapësirat e perandorive të cilat i kthen nga pluhuri në madhështi për t'i përplasur sërish te fundi tragjik i tyre. Për të zbuluar prej këtyre rrënojave fatet e popujve të humbur por edhe të atyre që kanë mbirë prej farës së tyre. Një operacion sa i vështirë po aq dhe i dëshirueshëm, nëse do të kemi durimin e nevojshëm për të shqyrtuar dëshmitë-një rezultat i ri-pjellë e mendjes së shkrimtarit. Ndoshta asnjë shkrimtar tjetër si Kadareja nuk ka përdorur me kaq sukses këta lloj operacionesh. Një laborator jo aq i madh por i sofistikuar për të ndryrë tërë këto gërmadha brenda vetes. Ekzemplarët në shqyrtim rrëfejnë vet tragjeditë e tyre, për të sjellë të vërtetën më të mundshme dhe të besueshme, duke e zhveshur prej legjendës dhe mitit. Prej këtij laboratorit ka rrjedhur shumë ekstrat historik dhe letrar. Një e shkuar që bëhet e sotme përmes sinqeritetit të rrëfimit. Për t'i bashkuar këto fije të këputura duhet të përparosh shumë në të shkuarën e tyre, që ka vizionin e shkrimtarit për të ardhmen. Për të mos i ndierë veç e veç ato na jepen si një e tërë, të vetmet stacione ku mendja e njeriut është ndalur kaq gjatë për të shqyrtuar sjelljet dhe fatin që përherë shoqëron marrëzinë njerëzore me dëshirën për të pushtuar të ardhmen.

19.5.12

SHKRUAJ PËR TË MUNDUR HARRESËN

Shkruaj për të mundur harresën. Ndoshta shkrimi dhe prej kësaj nevoje ka lindur. Ai u shpik mijëra vjet më parë dhe i la varret të mbushen me të vdekur. Sipër tyre ngriti statuja dhe monumente. I tregoi njeriut adresën e së ardhmes. Vetëm përmes këtij ushtrimi njeriu zbuti veten, sa më thellë e njohu atë duke ndierë nevojën e kujtesës. Ai kuptoi se ishte perëndia e vetme mbi tokë dhe s’kish kush ta mbronte tjetër prej një asgjësimi total. Atë që e kanë thënë miliona e miliarda faqe të shkruara, është pothuaj e pamundur ta përshkruash pa i bërë më parë homazh shkrimit. Unë jam një i dënuar i galerës që e përfytyroj vdekjen time si një rilindje. Unë jetoj përtej harresës që e shkuli me buldozier këtë varr për shkak të mbipopullimit. Por edhe në natën e pafundme do të ndizet një dritë që na shfaq lakuriq të vërtetën: Ju jini vrasës të së shkuarës tuaj dhe ajo si dënim do të zgjohet për të treguar se kini ende një mundësi shpëtimi. Hapini dritaret ndaj erës se po vijnë zërat e largët që po u sjellin dashuritë e humbura dhe faljen e mëkateve dhe, mos bëni më ato gabime sepse gabimet e tjerë në radhë janë duke pritur. Duke i shkruar ne krijuam përvojën dhe vetëm prej saj shkrimi u bë qytetar i botës.

8.11.18

RRUZUJ DRITE

Letërsia nuk i ka zgjidhur problemet e njeriut por ajo thjesht e ka ndihmuar të shoh sa e thellë është errësira nën të dhe sa dritë po sjellë me vete çdo lloj perspektive. Ja, kemi vendosur një çast të thërrasim Shekspirin për këshilltar dhe dhe t'i betohemi se do të zbatojmë vetëm këshillat e tij. Një çast do të jemi lodhur për shkak të rrethanave që e ndërlikojnë jetën e çdo njeriu papritur dhe Shekspiri befas del nga skena, pa mundur dot të na verë në gjumë me ninullat e tragjedive të tij. Pra qënka e pamundur ta përdorësh letërsinë si një lloj aparati për të shëruar ndërgjegjet e plagosura. E megjithatë letërsia si filozofia pa u shndërruar në propagandë ka rolin e saj në vendosjen dhe ruajtjen e ekuilibrave shoqërorë, sepse përmes tyre përcillet vet thelbi i njeriut. Por le të marrim një çast në shqyrtim shumicën që nuk ka pasur kurrë kontakt me librin. A mund të jenë ata të përjashtuar prej ndikimit të saj? Besoj se edhe ata e kanë marrë këtë mësim përmes komunikimit publik. Ata kryesisht pëlqejnë filmat, humorin, historitë, përrallat. Pra bëhen konsumatorë të nënprodukteve të letërsisë, pa e kuptuar se shija që po u formohet ka për bazë thjesht traditën e ligjëritimit. Ajo gjuhë të cilën e ka përpunuar dhe ruajtur vetëm fjala e shkruar. Pra ata në të vërtet janë mëkatarë njëlloj si lexuesit e rregullt, ndonëse një libër në duart e tyre mund të përfytyrohet si një zjarr, të cilin ata nuk dinë si ta shuajnë. Ndërkohë që duhet

thënë se kur numri i librave rritet, bibliotekat varfërohen, siç ndodh zakonisht me kërkesën dhe ofertën. Letërsia mbeti kështu çështje e një elite të shoqërisë, por ajo nuk ka fuqi për të depërtuar më thellë duke u përhapur nëpër dyqane e rrugë, me britma shitësish e reklama. Opinioni është i verbër. Ai që nuk sheh ka humbur dhe aparatin e dëgjimit. Libri fle gjumë me bibliotekaret e lodhura nga papunësia. Ne e paguajmë edhe këtë taksë të vogël për librin, thjesht për të shpëtuar prej diçkaje të bezdisshme. Sa shumë ditur i e përvoja vdesin nëpër faqe librash. Edhe sikur unë thjesht ta ve para si pasqyrë për të parë veten. Iku koha kur ‘cari’i vërtetë i Ruisë ishte Tolstoi. Bashkë me të dhe një mision i letërsisë kishte përfunduar.

2.

Një shkrimtar i mirë duhet t’i identifikojë qart synimet e veta. Ato duhet tu ngjajnë rruzujve që i japin dritë njëritjetrit, pikërisht prej atyre këndeve ku mungon drita, aty ku përherë ka qënë errësirë. Dhe kjo në të vërtetë do të kishte vlerën e njëzbulimi. Shkrimtari përgjatë gjithë jetës së tij krijuese përpiket të plotësojë veten , t’i bëjë më të përdorshme ato energji që u mungojnë të tjerëve , të fut në prizat e tyre atë energji që brenda tij ndoshta është duke fjetur. Një botë që vjen prej tij me përthyerje fjalësh. Për tu përmbushur detyra që kemi për eksplorimin e botës dhe ku ajo të ardhmen e saj na i ka fshehur. Sepse njeriu përherë do të gjendet para të papriturave, të cilat nuk vijnë kurrë bashkë me ilaçin e tyre shërues. Prej veprës së çdo shkrimtari vjen një marrëdhënie tjetër e panjohur, e cila na zbulon hallkë pas hallke kompleksitetin e rrethanave me të cilat na duhet të përballemi. Sepse farërat e bimëve nuk mbijnë në të njëjtën thellësi. Çdo bimë do shtrijë posht rrënjët gjersa

të gjejë vlagën me të cilën do të uishqehet. Letërsia tjetër do të jetë shtëpi e pabanueshme. Vetëm mure dhe çati por pa frymë njeriu brenda. Ja pse veprat e mira siç thamë u ngjajnë rruzujve që shkëmbejnë dritat me njëri-tjetrin. Drita që vjen prej thellësive më të errëta. Dritë që nuk na verbon për shkak të densitetit e reciprocitetit të valëve.

29.1.17

XHOJSI DHE SARAMANGO

Lisbona është një lloj Dublini i Xhojsit. Por Saramango nuk është Xhojsi dhe Lisbona gjithashtu, por vihen re ngajshmëritë që mund të përcjellin idenë e labirintit. Ngajshmëritë shpesh të krijojnë mundësi për tu orientuar në kohë e për të zbuluar vet frymën e saj. Duke qënë gjeografikisht larg ata janë shumë afër në kohë dhe rrezatojnë secila më vete për tu bërë vet frymë e kohës. Lisbona e Saramangos është po aq e errët sa Dublini i Xhojsit nën shi dhe mjegull, nën ankthin e asaj që pritet të ndodhë dhe që i ka vdekur që në embrion çdo lloj oprimizmi. Duhet ta kishim përsëritur mijëra herë këtë të vërtetë për të shpëtuar prej saj, gati si prej pranimit të një gënjeshtre. Lisbona është qendër e një ish perandorie detare, që tani është e tkurrur në kufi të vet për tu ushqyer me lavdinë e saj të dikurshme. Dublini është edhe më i errët, duke u mbarsur për të lindur gjeni të tjerë ku në të njëjtin djep të gjithë do të përkunden. Jo vetëm shkrimtarët por edhe joshkrimtarëve i nevojitet një vend i tillë, qoftë edhe i shpikur për të zbuluar veten në qendër të një Alefi tjetër, i cili sipas tërë gjasave mund të jetë i kudondodhur.

30.11.16

PARA PASQYRËS ITALO KALVINO

Si mund të ndjehesh para një pasqyre? Të ikësh/
Zhdukesh/ prej saj mos të çmendesh. T'i bësh një vizitë vetes te një mjek i njohur dhe të shporresh nga sytë këmbët. Pasqyra të tilla e tregojnë lakuriq të vërtetën. Kur s'ke më fuqi të përballësh me të, mbathja sa më parë ose në s'të ka mbetur gjë tjetër thyeje në mijëra copëza pasqyrën. Ka edhe një mijë mënyra të tjera për të shpëtuar prek këtij tmerri: të vdesësh pa e njohur veten/dmth të ikësh nga kjo botë pa kuptuar se po ikën për jetë prej saj/. Paqyra si përherë është aty duke citur vizitorët e saj. Nëse të guxon të rrih më gjatë përballë saj, ca gjurmë të tua në të mund të mbeten. Dhe nëse ke ndierë forcën tërheqëse të saj ti mund të bësh një kompromis me veten. Dua të them atë, që pasqyra përherë është një ftesë si ajo e pranverës që sapo ka ardhur dhe, ti hap kanatë më kanatë dritaret si para një zbulimi. Dhe nëse pasqyra të tregon krejt të vërtetën, ti mund ta vëzhgosh atë më së thelli, pa iu trembur thirrjeve në alarm se po të përpijnë flakët e një zjarri. Çfarë je duke parë te pasqyra, kthehet në një përplasje mes lumit dhe digës që kërkon atë për ta ndalur. Ka edhe më tepër arsye për të besuar te forca e papritur e këtij zbulimi. Aq sa mund të harrohesh për fare se ndodhesh para një pasqyre, me të cilën ke nisur një bashkëbisedim të gjatë si ai i mjekut me të sëmurin. Ti i ke thënë pasqyrës atë që nuk ia kishe treguar kurrë vetes.
20.12.16

LIBRI 'RROKJE NË KRYQ' I PIRRO LOLIT

Libri Rrokje në Kryq nuk është libri i Pirro Lolit por i njeriut. Nuk e vura midis fjalën 'vetëm', jo për ta përjashtuar atë krejt prej autorësisë, por me dridhmat pas leximit, gjuha nuk më dha mundësi tjetër për ta shprehur. Kritika jonë gati inekzistente nuk u konvolgua në të dhe për fat të keq optika e saj u gjend krejt e zbuluar para një libri tronditës. Për të ikur paksa nga libri le t'i afrojmë në pasqyrë njeriut vdekjen. Atëherë mund t'i përqasemi dramës sonë të ekzistencës- teoria e së cilës është më tepër karem për filozofinë e mundësive që ajo na jep për ta përballuar. Libri e bën këtë do të thoshja pak a shumë si Reportazh i shkruar me Litar në Grykë të Fuçikut. Por në një mënyrë tjetër përballë një armiku që zgjohet duke qënë i fshehur te vetja. Është një makth i pafund që përshkon qënien në zgrip. Është një botë e mbetur pa shpresë me një dhimbje që s'ka qiell ta përcjellë kumbimin e kabanës së saj. Sa herë e marë në dorë këtë libër i trembem atij si një bombe me plasje të vonuar. Fjala Vetëm, në mes që i mungon asaj shprehjes së fillimit, është vet donatori që do të ndezë më vonë tmerrin e nevojshëm për ta përshkuar si një sprovë krejt librin. Autori/kushdo qoftë ai/ nëse në të vërtetë nuk është Pirro Loli, është vet guximi njerëzor për ta çarë nga kreu në fund diametrin e plagës, duke mos e gjetur dot në mishin e saj plumbin vrasës. Është një letërsi që e mbartin ëndrrat. Është psikanaliza që nuk ia ze në

gojë realitetit atë marrëveshje të fillimit ku dëshmitari vdes para se të nënshkruaj tastamentin. Në libër i gjejmë të shpirtëzuara fjalët. Dhimbjet konvertohen në ëndrra. Bien shumë bubullima e shkrepin rrufe te një universi që ka humbur ekuilibrin. Nuk ka më paqe e cila është e minuar prej luftrash të nëndheshme. Libri e përcjellë këtë mesazh si shpresë përderisa autori arriti të nxjerrë prej një apokalipsi shpirtra si fjalë, që nuk janë shpesh në përdorim të gjuhës. Shpesh të duket se këto fjalë janë shkruar në grahmat e fundit të Frymës.

15.1.17

FALENI TË VDEKURIN TUAJ

Më kini parë si gjysh, si vëlla , si bashkëshort , më kini parë si prind por pa u parë dot në të tëra pamjet njëherësh. Kjo ka qënë vuajtja ime prej së cilës Kafka erdhi si tragjedi e moskuptimit. Amësia krijon fqinjësi të padurueshme që një individ nuk e përballon dot dhe shpërthen në revoltë duke asgjësuar tragjikisht veten. Kjo fqinjësi birësi amësi e çuditshme, një lloj robërie që e mat me të njëjtën masë dashurinë dhe urrjetjen, të sotmen dhe persepektivën. Unë u krijova prej kësaj familjeje si thelb i shoqërisë, ku vlera e secilit matet me kontribute të një aritmetike të zakonshme, që nuk e lejon tjetrin të shfaqet. Mali i një dhimbjeje të madhe- gjaksore dhe e përbindshme që do ta mbushin vetëm për një çast varrin tënd me lule.

4.4.17

NË LIDHJE ME RAMBINDRONANT TAGORËN

Nëse arrij ta kthjelloj kujtesën, do tu tregoja diçka të vërtetë dhe të pakontesteushme. Por kam ende shumë paqartësi për të mbërritur në kohë tek ajo që dikur kishte ndodhur. Sot fisi Blloshmi është shumë i lakuar në media dhe unë që kam fakte rreth tyre, dua me përunjësi mes pafajësisë e gabimit njerëzor, të sjell atë kohë që kishte një rrjedhë tjetër. Dhe shkak që u riaktivizua kujtesa ime si bateri e konsumuar ishte një libërth i vogël i Rambindronat Tagorës në bibliotekën time. Prej këtij detaji unë iki prej Librazhdit në Indi duke kryer një udhëtim imagjinar ndëroqeanik të kujtesës. Po kush është dhuruesi i këtij libri? Unë s'kujtoj dot tani asnjë emër përveçse jam i sigurt se ai ishte një prej Blloshmëve. Ky libër më është falur në një fshat të ngritur në një pllajë mali në anë të djathtë të rrugës automobilistike duke ardhur nga Tirana, ku ruhej e gjallë ende vepra e ca të lavdishmëve që prej këtu të panjohur kishin ikur. Te shtëpia e Blloshmajve në Bërzeshtë unë zbulova Tagorën , poetin e madh indian, fitues të çmimit Nobel kur në Tiranë atë ende nuk e kisha njohur. Me Tagorën në bibliotekën time pasoi një heshtje e gjatë 40-50-vjeçare, gjersa Blloshmët u bënë protagonistë, duke kërkuar emrin që të tjerët ua kishin vjedhur. Ja pse kujtesa ime tani i ngjanë një fushë beteje ku ajo mbledh të vranët e saj dhe korigjon historinë prej gabimeve në mënyrë si ajo është shkruar, Nyja lidhëse mes meje dhe atyre mbetet

përsëri Rambindronat Tagora- pinjoll i një fisnikërie të lashtë indiane, ndërsa kish zbritur në siujdhesën moderne të letërsisë bashkëkohore. O miku im i vjetër që po të bëj një lutje dhe do të pres shumë kohe deri pas vdekjes. Mos je ti vallë ai poeti i pushkatauar për shkak të poezisë bashkë me kushëririn tënd edhe ai poet? Ndoshta, por unë që s'nxitoj për të vërtetuar faktin e marrë me mend se ti je një prej atyre që iu mohua liria dhe u martirizua vetëm e vetëm, sepse aty midis maleve guxonte të shihte përtej aty ku shikimi ynë ende nuk kishte mbërritur. Sikur të jesh ti pikërisht ai martiri i Blloshmëve që u ekzekutua se zbuloi qënien e vet në barkun e një përbindshi, ky shkrim qoftë një homazh për miqësinë dhe fisnikërinë. Unë nuk mundem ta shpërblej dot ndryshe veç duke përmbshur këtë amanet të ndërgjegjes. Pyetja ime e di që do mbetet pa përgjigje. Letërsia dhe dija në atë kohë kishin heshtur dhe të verbuar nuk e panë kur po kalonte kjo re për të pastruar rrjedhën e lumit Shkumbin, dhe ne të dy të ndalemi një çast, pikërisht te ura si njerëz të një kohe tjetër. Por kjo kurrë s'ka për të ndodhur dhe ti e di se kjo vetëm për shkak të Heraklitit që pa lumin te ura dhe shpiku idenë e tij gjeniale të kohës. Me kujtesën time në këtë luftë të pashpresë që po mëton tani e vetme nëpër këtë oqean harrese, pa mundur dot të kërkojë ndihmë prej askujt, për të dalë në çfarëdolloj bregu që do të ishte e mundur. Duhet kujtesa e Prustit t'i zbulojë tërë ato imtësi aq të vogla. Dhe përballë kësaj pamundësie të tmerrshme njerinngrenëse, unë po i dorëzoj këto fjalë në një libër. Shprehje që do ta përsos më vonë vet koha, sepse në atë çfarë kisha shkruar në thelb është pafajësia – atribut, vetëm i së vërtetës.

6.3.17

PËR MOIKOM ZEÇON

-Post mortum -

Sa e sa herë kam përsiatur rreth emrit të tij ai përherë më mbetet në mendje i përveçëm. Një zodiak/ të cilin ai e pati shumë qejf/ gati i papërcaktuar. Një patriark dhe një plebe, një zë dhe një klithmë që befas shndërrohet në ulërimë. Shumësia e veprës së tij të cilën unë ende nuk e kam përmbledhur dot në një emërues të përbashkët. Kam lexuar shumë prej tij por më tepër ende nuk i kam lexuar dhe nuk besoj se ndonjëherë kam për t'i shfletuar të tëra. Le ta ndajmë atëherë këtë të tërë të tij në pjesë për ta zhvendosur atë nëpër çdo anë ku është duke e parë drita. Ky demiurg me një fuqi të papërfytyrueshme është bashkëkohësi ynë, njeriu që flijohet për gjithçka. në çdo tempull ku shkon për tu ribërë njeriu i ngarkuar me mëkatet e nevojshme, që kur e sheh veten në pasqyrën e ujit zhytet në të për tu dëlirësuar. Ai po le pas një shkrim gati të përbindshëm si për të sfiduar vet gjuhën, ngaqë ajo i duket e pazonja për tu vetshpikur. E për të shprehur gjithçka që nuk u krijua dot prej një plejade të tërë martirësh. Moikom Zeqo sidoqoftë është një dukuri shqiptare dhe po e zhbën këtë kufi duke folur në emër të diçkaje që ndoshta ende nuk është konfirmuar. Ai që rrëmben krejt dritën i trembur se mos ajo është duke verbuar të tjerët. Do ta quaja dhe kalorës, një lloj Don Kishoti që kërkon të ridimensionojë vet kohën. Një jetë vitale që i jep fuqitë e mbetura fundit për ta shtyrë atë gjer te përjetësia.

Kur them Don Kishot kam parasysh atë përpjekje pozitive që ndoshta nuk përkon aq shumë edhe me kohën, për të prishur rendin e gjërave, ose dhe për të ndryshuar atë masë matëse që është treguar e paaftë t'i gjykojë vlerat, të cilat i shqyejnë kornizat e klasifikimit. Dhe unë e lexoj ndërsa ai shkruan për tu lexuar ndryshe ndryshe, shkruan dhe shkruan si të jetë përherë me shpresën se nata është duke e sjellur me vete dritën. Nuk kam gjetur dot tjetër shembull në kulturën shqiptare ku përmes transfuzionit të thellë të zbulohet vet mungesa e vet lëndës. Pa mundur dot të përmbledh gjithçka vet Moikomi bën lexime të tjerë dhe si një përbindësh është duke nxjerrë edhe një kthetër tjetër. Ka ende për tu sjellë në dritë prej kësaj lënde gjer atje ku përjetësia na ve një kufi të presim kohën për të vdekur.

2.3.17 – 15.6.2020

DYSHIMI QË PAS ËSHTË DUKE NA NDJEKUR

Si mund ta shpërblejmë ndryshe mendjen veç duke shkruar ose gdhendur atë që ajo me bujari na ka ofruar. Për t'i hapur udhën një thirrjeje tjetër që vjen prej një largësie edhe më të largët. Ajo që na ka çuar në një nga situatat më absurde gjer në asgjësimin e qënies sonë prej shkaqesh që ndoshta do të mbeten përherë të panjohura. Ajo që duke na braktisur në një prej ëndrrave të saj më të rënda na le pas dyshimin. Pse kaq përdhunshëm kish ndërhyrë në jetën tonë dhe nëse na kish lënë një takim për një herë tjetër. Nëse një ëndërr e përkthejmë thjesht si një dhimbje ajo është duke na sjellur lajme jo të mira. Ndërsa prej rrugëdaljes së vetme ajo duke ikur e la dritën fikur. Në një cak para gjumit je duke hyrë në një tunel dhe tërë përgjegjësinë për të dalë prej andej e ka vetëm mendja. Bëhemi krejt të pakohë dhe humbasim kontrollin e hapësirës. Lëvizim në terr edhe kur na verbon drita. Në zgjim jemi të rrahur por me kusht që asnjë pikë gjaku të mos duket asgjekundi. Dhe dua ta jap këtë lajm të gjithëve sidomos atyre që flejnë buzë njëvarri mbushur me të vrarët e tyre.

26.12.15

NUK NDODHEM NË VENDIN E ILUZIONEVE

Nëse nuk do të kisha zbuluar përherë diçka të re do të kisha humbur edhe motivin për të shkruar. Po si mund të ndodh kjo kur tërë pritjet tona na lanë prapë aty ku ishim? Drita që mungoi atëherë erdhi më vonë për të zbuluar shkakun e errësirës. Dhe vet kjo plakje e trupit tani po kthjellon mendjen time për të parë në një dritë të re vet të shkuarën. Sikur po ndodh tani ajo që dikur ka ndodhur dhe ne nuk arritëm dot atë ta përjetonim. Duke iu ngjitur shkallë-shkallë kujtesa na dorëzon një hapësirë tjetër që më parë ishte fshehur nën mjegull. Dhe si ndodhi vallë, nëpër çfarë shkrepje vetëtimash u përflak kjo dritë e dikurshme? Përherë na ishte dashur një farë kohe për tu rivendosur te ky realitet si sfidë ndaj kësaj përditshmërie. Ajo që pata zbuluar bëri një zhvendosje të realitetit duke i venë në ballë një dritë tjetër. Nuk jam bërë më i lumtur por nuk ndodhesha më as në vendin e iluzioneve. Thjesht duke parë trupin tim të plakur zbuloja rrënjë sëmundjesh të vjetra ,frytet e të cilave tai ni ishin bërë edhe më të hidhura. Vet çasti i zbulimit është i papërshkrueshëm, sepse duke më falur zbulesën ai menjëherë zhduket. Për më tepër besoj se nuk ka shumë rëndësi çfarë zbulimi. Dhe prej kësaj unë u ndërmenda se pafundësia si koncept më parë buron prej brendësive tona.

23.5.18

REMBIJA VDIQ, REMBOJA RRON

Vetëm tani u shkrua sepse mund të shkruhej vetëm ajo që u shkrua. Më vonë do të ishte e pamundur. Vur re në të praninë e kohës, orën që tringëlloi dy pa çerek dhe ky udhëtim i shkurtër në autobuzin urban i ulur në një prej ndenjësve ku një mori njerëzish rrinë në këmbë. Në mendje e shkruara një ditë ikën pa lënë gjurmë. Ose edhe ajo që nuk u shkrua daton njëlloj të sotmen. Mendimi diku është ndalur në pritje. Ndoshta pritësit s'kanë mbërritur ende si në një stacion të madh treni ku dhe zhgënjimet janë më të dukshme. Do vijnë trena të tjerë këta të dëshpëruar për t'i mbartur. Erdhën vetëm ata që mundën. Prej sa e sa gjërave jemi të përcaktuar por zoti thotë se ti përherë ke mbërritur në kohën e duhur. Po njeriu që stimulon ambicjet e tij a nuk është i përcaktuar për të vdekur më herët? Atë orë të ditës dhe prej ç'ndodhi me Rembonë këtë gjeni që lindi i rritur e vdiq fëmijë? E tërë kjo mund të ketë qënë njëherësh një mrekulli dhe një fatalitet. Rembija vdiq, Remboja rron. Të thuhej dje kjo që e pamundur ashtu siç nuk mund të thuhet as nesër. Por ç'kishte ndodhur në të vërtetë sot ku hapësira dhe koha ishin takuar nën një shenjë të veçantë të drtiës dhe errësirës? Zbatuesi nuk e kishte parë fare urdhëruesin përndryshe edhe ata do ta kishin përjashtuar njëri-tjetrin. Ku ndodhesha vallë në atë orë të ditës dhe prej ç'shtyse pa marrë kurrëfarë vendimi, më kishin dhënë arbitrarisht urdhër për tu bërë orë e një kohe, kohën vet për ta shënuar?

28.1.10

SI PËRHERË NË HORIZONT DRITAT U SHUAN

Ngjarjet e mëdha i imponohen historisë por më pak letërsisë. Nën hirin e gërmadhave që lanë pas pasi, kishin shkatërruar më parë miliona identitete dhe po aq ëndrra. Qelbi i mbledhur në paqe shpërtheu këta tumorë të zinj. Por a mundet dot vallë pas gjithë kësaj të ketë më paqe edhe pasi ajo të ketë varrosur tërë martirët e saj? Ky shpërthim urrejtjesh nuk na ka ndihmuar aspak se varret përherë i kemi lënë hapur për të vdekur të tjerë. Unë i përkas brezit që sa herë u nisa isha kthyer pa mbërritur dot te lufta. Inspektova fushën e saj të ngarkuar me topa e mitralozë por i lashë të vajisur dhe transhetë të hapura si kanale ujitëse. Ngjarjet e mëdha i zvogëlojnë së tepërmi përmasat e përditshmërive tona duke na bërë të parëndësishëm. Nëpër këto pika referuese ne kërkojmë ende identitetet tona të humbura. Kur gjaku u derdhë si lumë ne nxituam të merrnim prej tij një pikë gjak. Aty ku lavdia u ngjit në majë ne arritëm të këputnim prej saj një gjethe dafine. Pikë e nga një pikë ky gjak është mbledhur në shekuj. Ne e ndiejmë peshën e tyre e cila kurrë nuk zvogëlohet. A s'është dhe tani Roma po aq e rëndë si më parë? Duket sikur mbi kujtimin e saj s'kanë kaluar tërë ato kryqëzata dhe grumbullimi i principatave e ndryshoi përfundimisht hartën e botës. Roma ndriçon historinë aq sa dhe e turpëron atë. Por legjionet e romakëve u bënë më vonë falanga të Hitlerit. Historia ka venë mend ndërsa

thirrja për urtësi nuk i ka zbutur ende gjakrat e Romës. Njeriu zvogëlohet përherë në këtë betejë me historinë nën ca kolona madhështore të lavdive të dikurshme, që do na verbojnë deri sa tu shuhen dhe mirazhet e fundit. Ngjarjet e mëdha thirren si prova në agim të epokave të mëdha. Ku bëhet një seleksionim i mentaliteteve të vjetër dhe hidhen në luftë armët e reja më të sofistikuara. Bota këtej e tutje do vazhdojë po njëlloj të qeveriset prej më të fortëve. Por përfundimet si përherë do të jetë një shans tjetër i humbur për paqen që prej horizontit të saj është zhdukur. Ato ishin energji të jashtëzakonshme që u harxhuan dhe si përherë në horizont dritat u shuan. Të vrarët janë aq të shumtë sa të gjithë në një varr të përbashkët i futi historia. Një Te Deum madhështor u këndua dhe ne s'do dimë më kurrë ku e si stërgjyshërit tanë neve si pasardhës na kishin projektuar nëpër ëndrrat e tyre. Ngjarjet e mëdha i mendoj si shembje dhe ngritje mbi eshtrat e të mundurve. Do të kemi përherë një riformatim të ri të botës, vizioni i së cilës nuk është veçse ai horizont i përgjakur. Ngjarjet e mëdha bëhen kështu shenja ku ngaherë për njeriun mbetet kjo farë që e bënë njeriun të përjetshëm. Horizontet e botës u nxinë para se Roma të rrëzohej. Ata që tani e quajnë veten bij të Romës së Lashtë janë shpërndarë si zogjtë e korbit nëpër botën latine. Romakë të vjetër nuk ka më, vetëm kur në konferenca ndërkombëtare i bashkon gjuha latine. Popujt u shkrinë si kripa në ujë por Çezari do të na shfaqet përherë si mirazh në kërkim të perandorisë së botës.

25.11.10

PAK PAS HESHTJES...

Nëpër faqet bosh ajo që s' u shkrua është heshtja, që na sugjeron një mënyrë tjetër të lexuari. Heshtja e nëndhshme e cila përherë e ka kapur në befasi njeriun. Jo vet veprimi por mungesa e tij është ajo që na lutet për tu treguar të vëmendshëm. Heshtja nëse është përbërje kimike do të jetë vet laboratorit ku ajo përgatitet. Ajo e përmban por nuk e artikulon ende gjëmën. Atje jemi të gjithë të mbyllur. Heshtjet që u mposhtën prej veprimit nesër do t'ua shohim tymin përsipër. Në heshtjen e saj çdo kryevepër është shkruar. Ndoshta aty kemi për t'ia gjetur ndonjëherë rrënjët. Ç' nuk kemi thënë e ka mbushur vetëdijen tonë me shenja të pafundme, zbulime ku gjenden të përpunuara tërë përpjekjet tona. Por sipari ende nuk është ngritur. Askush s' është duke trokitur në kafkën tonë për të nxjerrë prej andej këlyshët e plakur. Heshtja në udhë që unë e zbërthej në fjalë, përmes këtij ritmi që përcjellë hapat e mi këtë mbrëmje. Papritur u ndieva kohë e pafundme brenda vetes. Pak pas heshtjes ku unë nis të flas nuk është grisur akoma kjo heshtje, por një thirrje e traditës që brenda meje ka pranuar të vdes. Tërmeti ka qënë përherë aty – heshtje mashtruese e pakohë nën këmbët tona dhe pothuaj tepër larg çdo lloj përfytyrimi. Por heshtja udhëton njësoj me ne me rrotëzat e patinave nën këmbët tona. Mos vallë ajo e përcakton dhe vet drejtimin për ku ne jemi duke ecur? Le ta quajmë mister por ajo një ditë do na tregojë fytyrën e saj të tmerrshme. Heshtja

ka peshën e ajrit ndërsa ne nuk e kemi zbuluar ende. Siç e përfytyrojmë përherë misterin. Edhe nëse e ndiejmë se posht nesh po bëhen gati të shfryjnë gazra të nëndheshëm ,vetëm kur të shpërthejnë mund të njohim natyrën e tyre. As unë nuk e di më pas çdo të shkruaj, sepse nuk mundem të zbuloj ç'energji më ka mbetur gjer te fuqitë e mia të fundit. Ato u bënë dhe ora e rënies së kësaj kambane që unë me kohë ia kisha përgatitur festën.

30.11.10

NË BRAZDË

T ë zbërthesh një kuptim të gjerë në sa më pak fjalë- një shteg të vetëm që e hapin duke e shkelur mijëra këmbë. Në këtë ag mëngjesor ku drita nuk e tregon dot qart atë që është duke ndodhur, teksa po ravijëzohet një mister që duket se rri fshehur te qëllimi. Kjo ndodh pas shumë hamendjeve e dyshimeve, lakadredhave e përsiatjeve të shumta që po bëjnë harakiri. Më në fund në terrin e natës drita mëngjesore u zgjua. Këmbë pas këmbë, dyshim pas dyshimi, fara e besimit po hidhet. Do të jetë kjo një nga rrugët tona të ardhme. Do dëshmojnë për të ata që e shkruan duke ecur, por edhe të tjerë të cilët do matin largësinë prej së ardhmes nga kjo e shkuar. Ndërsa udhëtarët e këtij mëngjesi përfytyrojnë diçka tjetër. Që nga ky çast ata bëhen bashkëkohës- një barrë tepër e rëndë kjo po të matësh rëndesën mbi tokë të peshës së çdo gjurme. Një e çarë emadhe që po hap një rrugë duke mëtuar për pushtimin e së ardhmes. Kjo rrugë mund të zgjas edhe pesë shekuj të tjerë derisa udha Egnatia të jetë hapur me gjithë trashenë e vet të gjurmëve. Por ata nuk e shohin më dot rrugën që përvijuan për shkak të misionit të tyre. Ata vetëm ecin si në poemat e San Xhon Persit. Drejt një qytetërimi të ri- punë torturuese milingonash pa numër që po u çojnë ushqim te streha e Zotit të vobektëve. Ata që më vonë do t'i japin emrin një epoke të tërë historike, do sakrifikohen pa fjalë për të çuar ekzistencën në një vendbanim të ri e të

panjohur. Ata që kanë qënë ëndrra e dikujt tjetër po nxitojnë atë për ta pushtuar. Heronj të rinj ndërsa historinë njerëzore mbi supet e tyre janë duke e ngritur. Kur tu shteren idetë pothuajse qëllimin e kanë mbërritur dhe zoti i tyre tani e tutje do të jetë dikush tjetër. Ata që si pishtarë në flakë u dogjën përgjatë rrugës mbërritën duke çuar aty hirin e tyre.

4.1.10

FJALË TË MARA PENG PREJ GJUHËS

Prej këtyre që këtu po fliten s'më intereson asgjë. Dhe vendos të ikij prej këndejmi duke mos i lënë askujt adresën time. Tani që jam një i ikur ata janë të lirë të tjerrin jetën time duke i shtuar faktet por i ftoj të shihen në këtë pasqyrë që unë u lash duke ikur. Edhe unë vetë gëzoj një liri të pacënueshme sepse shigjetat bien por nuk e shpojnë dot këmishën time prej plumbi. Ata flasin për gjithfarë temash dhe u kthehen sërish atyre prej frikës se mos gjuha një çast do t'i ketë braktisur. Do të doja të dëgjoja në një shirit gjithçka njerëzimi ka folur që kur e konvertoi ulërimën e vet në gjuhë. Asnjë fjalë asnjëherë nuk është shqiptuar njëlloj në kufi të një fjale tjetër. Një mozaik i papërfytyrueshëm. Dëshira për të folur nuk është thjesht çështje e ushtrimit të gjuhës. Thashë e themnaja e botës është mjegull- avull fryme, ekzistencë. Ata po flasin ende. Dhe nuk dihet kur do tu sosen fjalët nëse pusi si gjuhë ende nuk është shterur. Unë tani jam çliruar prej varësisë nga burimi. Bëhem pak mistik të zbuloj atë që s'e shoh e nuk e dëgjoj. Jam i rrethuar por jo i pushtuar. Mund ta përfytyroj atë që po ndodh pa e përdorur fare si mjet gjuhën. Unë jam krejt pa gjuhë dmth në mbrojtje të saj sepse unë nuk jam më përdorues. Më përfytyrohet gjuha si rrjetë merimange ku bien në të së pari shkatërruesit e saj. A mundesh dot ta përfytyrosh këtë botë pa viktimat që kjo luftë la pas? Ata që po flasin së shpejti një e nga në do të vdesin me dëshirën

e panginjur për të marrë peng së paku një prej fjalëve të gjuhës. Do të vdesin të lumtur- them – sepse kryen një detyrë të shenjtë dhe shpëtuan gjuhën nga vdekja. Martirë të saj një ditë të gjithë do të jemi. Gjuha na ka bluar duke na konsumuar si frymë, gjuha i vetmi shpëtim për tu artikuluar në botën e një anonimati të pafund. Por martirët vet gjuha një çast do t'i bëj të pavdekshëm edhe pse në pemën e gjuhës ata do kacaviren për t'i rrëmbyer përherë asaj frutat e pjekur. Atyre që nuk u dhimbsej gjuha ia vrisnin fjalët e saj duke mos i shërbyer asnjëherë te rrënjët.

26.3.10

PAS NJË SHEKULLI TË LODHUR

Në poezinë e Apolinerit ka shumë hapësirë për t'i dhënë mundësi lexuesit të afrohet ose i mëdyshur të qëndrojë larg aq sa është e nevojshme koha dhe hapësira për mbërritjen e një mesazhi. Duke qënë një pikë rëndese në poezinë botërore ajo më tepër përfytyrohet si një urë që lidh të shkuarën me të ardhmen. Ndryshe ndodh me poezinë tjetër kur ajo embyll lexuesin në burgun e saj. Poezia e Apolinerit u hap duke përdorur ende konstruktet e vjetër para se të gjithë ato ta rrëzonin urën. Buronte më tepër dritë prej kësaj poezie aq sa të lejon të shohësh më mirë edhe dobësitë që ajo reflekton duke qënë në stadin e një eksperimenti. Drita që depërton midis vargjeve e nxjerrë krejt në dukje brendësinë e poezisë duke thyer njëkohësisht barrierat e ritmit dhe rimës. Është kohë ndryshimesh të mëdha. Shekulli XIX u lodh prej arsyes së tepërt që po përpiquej të çlirohej prej saj sepse vet koha kish nisur të ecte me një marsh tjetër. Sundimtarët e vjetër duhet të dorëzonin diçka prej pushtetit të tyre. Lajmi ishte i mirë por duhej verifikuar akoma gjer tek avanguarda surrealiste që u kthye në kohë të eksperimentit të gjallë dhe jo më prej kavjeve të ngordhura. Por në një traditë vlerat duhet të bashkëngjiten njëra- tjetrës pa shkaktuar trauma të pariparueshme. Poezia u bë vet fryma në agimin e një kohe të re. Me Apolinerin nisi rebelimi që la gjurmë të thella në një udhë që duhej përshkuar dhe jo kapërcyer. E ardhmja e një të shkuare të

afërt do t'i ngrinte pikëpyetje të mëdha vet asaj strukture që ishte duke u rrënuar. Bota duhej rindërtuar ndryshe, poria behën njëra pas tjetrës dy luftra shfarosëse me vet artin dhe poezinë që kish pranuar erën e re të ndryshimit. Duhej të frynte një flad i ri që poezia të zbulonte atë cipë me të cilën ishte fshehur e keqja. Përvojat do të ishin të tmerrshme por edhe të pashmangshme. Poezia i dha valsit vjenez ritmin e shpejtë të ikjes prej katastrofave që po vinin.

14.11.19

ËNGJËLLI MBROJTËS

Për të nderuar të zotin e saj të madh vepra e tij tani ka heshtur. Përpjejke rë reja do vijojnë me kohën. Pengesa e saj e vetme duket se ishte vetëm krijuesi i saj i gjallë. Pemët e një pylli të pafund që në nderim të Tij i përkuli era. Është nata e fundit siç do të gdhihet nesër dita e parë pas ikjes. Ajri dridhet ende prej përfytyrimeve. Ajo që këtej e tutje do të jetë e pavarur pa zërin e zotit të saj mbrojtës. Ajo që si re e bardhë do të fluturojë mbi varrin e këtij zoti për t'i shprehur ngushëllimet për gabimet dhe për ato çka ai maksimalisht nuk mundi t'i arrinte. Gjithë mëkatet ke për t'i shlyer ti e harruar nën pluhurin e bibliotekave që zotit të saj ia kanë zënë për jetë frymën. Ti që po jeton ditët e mbrame të tua do ta kesh kujtesën plot plagë prej harrimit. Ti gjë pa zemër që zemrën prej gjoksit tënd e kanë shkukur. Ëngjëlli yt mbrojtës kapërceu ylberin në të gjallë të tij dhe një zot e di sa shishe me shampanjë për shëndetin/jetëshkurtësinë/ tënd ka rrëkëlyer.

29.10.19

VALË QË I JAPIN HIJESHI LUMIT

Vogëlsirat ne i përshkojmë por pa i vendosur kurrë në qendër as edhe kur ato janë farë dhe prej tyre pritet të lindet diçka e rëndësishme. Ato që zbukurojnë shprehitë tona më së shpeshti harrohen duke mos i vënë asnjëherë theksin mbi to dhe shprehja dobësohet përgjatë artikulimit. Ato janë kaq të vogla, gati të padukshme qoftë edhe si nyjet prej ku nis vargu i gjatë i një shprehjeje. Por nëse ato i shkëputim për një çast prej shprehjes asaj ka për t'i ndryshuar krejt rrjedha. Përsose elokuencën si të tillë që secila pjesë të ruaj ndriçimin e tërë pjesëve. Për fat të mirë çdo njeri me mend e di se ato nuk mund të anashkalohen. Ato valë të buta që i japin tërë atë hijeshi lumit. Një kroçiere mendjemadhe lundron përmes tyre dhe shkuma e bardhë e ujërave ka aromën e një të qeshure. Ato drithërima që vijnë prej një plage të madhe. Sa shumë iu kam gjuajtur në pritje të më shfaqeshit për të zbuluar në to kuptimin e vërtetë të asaj që kisha dashur të shprehja. Nxitimi me të cilin shkelim me këmbë gjurmën e një tjetri pa ndierë më parë dhimbje. Vetëm përmes tyre e kam thurur atë mozaik aq të bukur. Prej fillit në gjëlpërë që atë është duke endur. Ju kini qënë shkak i vërtetë që më keni shtyrë të gërmoj harresën. Ju martire të një ideje sipërore edhe pse përmes jush është duke e thurur, flamurin tuaj tjetërkush e ngre lart. Unë u zbulova rastësisht kur mu gjakosën duart me gjakun tuaj. Tani që iu jam përkushtuar ju më shfaqeni kudo duke

më ngritur kurthe të vegjël. Prej thërmiash përbëhemi. Te vrapit ynë ka një hap ku rrëzohet krejt trupi. A s'është tani kryefjalë ajo që u bë vet perspektiva. Edhe pse asaj një hap i vogël i kish thyer njerën prej këmbëve.

5.10.19

PREJ GUTENBERGUT

Me Gutenbergun librat nisën të stoliseshin anash me lule. Në shenjë respekti për dijen që po i jepej njeriut, një prej dhuratave më të çmuara e progresit teknologjik të shek. XVI. Lule të varura, rrethim në të katër anët e çdo faqeje libri, aq sa të bëhej se duke e lexuar ndodheshe në një kopsht ku kundërmonin lulet e të tëra stinëve. Dhe ato shkronjëza të bukura për të mos u turpëruar prej asaj që ishte shprehur. Kishte mbërritur epoka e librit nëpër shtypshkronja përmes zhurmës së makinerive. Lulet anash sikur i ruanin fjalës drejtpeshimin. E re, e bukur dhe e fisme fjala ishte duke fituar një staut tjetër. Pergameni i lashtë dhe kubikët me shkronja kueinforme tani e tutje do t'i përkisnin historisë. Udha e librit do na kujtonte vet Blejkun e madh që përgatiste me duart e veta 17 kopjet e librit të tij në një prej dhomave të shtëpisë, duke i rrahut fletët prej bakri të librit për të ndierë më thellë dhembjen që ato përcillnin nga brenda. Çdo kopje poetit i shpërfaqej si një libër më vete. Edhe kujtimi i këtij akti është aty. Po çfarë është libri, ky gjësend kaq i brishtë që u bë zëdhënës i jetës mbi tokë, ky sizmograf kaq i ndjeshëm pa leximin e të cilit ne kurrë s'do kishim ndierë se brenda nesh lëviz një amplitudë shumë e përthyshme ndjenjash. Libri nuk është kasaforta ku e shkuara jonë është mbyllur tek faqja e fundit e tij, por për më tepër një hapje e fletës së parë prej një dore tjetër që mbërriti gjer këtu prej përvojës së një tjetri. Libri

i lidhi pazgjidhmërisht epokat duke na treguar të vërtetën. Kur ishim të ligj na e pohoi këtë përmes lotëve që të tillë s' duhet të kishim qënë. Por ai tha vetëm të vërtetën dhe duke e shfletuar ne bëjmë pakt me përvojën së cilës i detyrohemi për ta shkruar në një libër tjetër. Sepse përvoja është një vallzim i përleshëm i këmbëve dhe mendjes sonë. Libri që prej pergamenit po na shoqëron gjer në kohët moderne, duke sulmuar prej teknologjisë po fjalën nuk mundet dot ta nxjerrë dot prej lojës. Libri i parë i Gutenbergut dhe shenjë se teknologjia duke e bërë objekt librit i kish hapur një perspektivë tjetër.

17.6.19

ÇËSHITJE STILI

Sa herë përpiqesh t'i ikësh stilit tënd e gjenë veten të Spenguar nëpër shumë të papritura. Ato të shfaqen pakuptuar dhe fjalët kthehen për të zënë vendin prej ku ti i pate zhvendosur. Është vetë përvoja që nuk hapet aq lehtë për të mirëpritur eksperimentin. Ke për të dështuar dhjetëra herë edhe pse ke vendosur për tu hakmarrë ndaj vet gjuhës. Të shtrosh një udhë duhet më parë të kalosh nëpër një shteg të shkelur prej miliona këmbëve. Stili u krijua për të përkufizuar te rrjedha e saj shprehjen gjersa të përcaktohesh prej tij dhe bëhet pothuaj e pamundur për të dalë prej këtij udhëkalimi të detyrueshëm. Ai bëhet kështu shpëtimi dhe njëherësh dënimi i saj. Ti e ke zbuluar gjuhën atje ku ajo u fshihet të tjerëve. Shtëpia tashmë është bërë e jotja dhe çelësin e saj për ta hapur e ke vetëm ti dhe askush tjetër. Stili nuk na lejon më të dalim prej tij dhe gjuha përmes tij ka fituar një përmasë tjetër. Stili bëhet kështu edhe i paimitueshëm sepse ti ke ndërtuar një marrëdhënie tjetër shpirtërore me gjuhën dhe këtë kod nuk mund ta zotërojë dot askush tjetër. Përndryshe gjuha do ishte shndërruar në një llafazane të ligë që vetëm me pak fjalë të saj përgojohet një botë e tërë. Për ta thjeshtësuar disi këtë gjë kaq të komplikuar siç është stili mu duk se gjeta një lidhje me antropologjinë që studion harmoninë e çdo gjendjeje tonën. Sepse stili përngjit fjalët te shprehja si dhe çonë ujin te rrënja e çdo fjale që është duke u përvëlur prej etjes. Gjymtyrët në sinkron me

lëvizjen dhe fjalët në marrëdhënie me njëra- tjetrën që na japin një pamje tjetër të gjuhës. Stili në thelb jam unë që e kam pushtuar gjuhën edhe pse herë pas here ajo përpiqet të zhvendoset më tej për të gjetur mesin e saj të artë që përgjithësisht është i pamundur. Një prirje që përshkon tej përtej gjuhën për të zbuluar kuptimet e reja të fjalëve në një proces që është fuke mbarsur vetë gjuhën. Jam i mëdyshur nëse duhet ta sjellë apo jo shembuj se si u krijua stili, ku çdo krijim përherë vulën e tij është duke e mbartur. Le t'i lemë shembujt se në rastin më të mirë përmes çdo stili do të na flasë vet fjala si ndiehet ajo duke u shndërruar në vet rrjedhën e lumit.

19.6.19

I PËRVEÇËM DIKU NË NJË KËND TË HORIZONTIT

Ishim natyra të ngazëllyera para krijimit dhe na lumturon ajo që është vetëm e jona. Ndoshta shumë shkrimtarë janë ndierë keq kur i klasifikon brenda një metode ose shkolle të caktuar, gardh që s'mund të kapërcehet prej asnjërit. Prejardhja është dhunim i origjinalitetit ose klithma e një pamundësie për të dalë prej këtij burgu të stilizuar fjalësh. Ja pse natyra e krijimit është eksperiment edhe kur ai përfundon i dështuar. Metoda si bashkësi zërash synon të përfaqësoj epokën por kjo nuk le shenjë nëse nuk arrin t'i kapërcej ato. Zëri yt del përherë si njësi prej pjesëtimit të një shume të caktuar dhe kjo varësi mund të zbehë edhe rezultatin që jemi duke pritur. Çdo zë na vjen si kryengritje ndaj së tërës e cila bëhet vazhdim i pandërprerë i një leximi të vetëm. Dhe metoda ngadhënjën si e tillë e vetme për shkak të prirjes përfruese të secilit për tu mbrojtur prej harresës. Problemi është që metodat thithin talente të fuqishëm për t'i bërë nder një epoke. Ata që nuk nënshkruajnë kontratën me të mbeten shkrimtarë që flasin vetëm me zërin e tyre. Kafka për shembull nuk iu bashkua asnjë metode sepse ai vet u bë shpikës. Ai u vetpërkashtua prej çdo metode letrare që njëlloj si dhe Kavafi mbetën të paklasifikueshëm. Ata ngritën një perandori letrare të vetën. Oden poeti i madh anglo- amerikan do të thoshte për Kavafin: Ai është i vetëm duke qëndruar me nder në një kënd të horizontit. Nëse rrymat letrare u tretën në një

bashkësi për ata mjafton edhe një monument i vetëm. Në kohën e Homerit ne nuk njohim ndonjë metodë edhe pse mund të themi se qytetërimi i tij ishte i varfër. Por ne nuk e dimë saktësisht se çfarë dhe kush ai ishte për të dhënë dhe një gjykim përfundimtar për vet Homerin. Homeri mbeti si yllësi që i tregoi udhën një njerëzimi të para tre mijë e ca vjetësh. Metodat lindën shumë më vonë por edhe Sokrati më parë ato i pati refuzuar duke praktikuar shkollën e tij private, prej ku asnjëherëpërmes autoritetit nuk predikoi krijimin e një bindjeje të vetme, për t' i lënë nxënësive tij të lirë të ndiqnin fatin e jetës së tyre. Asnjë metodë s'ka qënë kurrë mëkat por thjesht një mënyrë kufizimi ku dhe mendje të ndritura luftuan heroikisht për ta tejkaluar njëritjetrin, pa e kuptuar as vet se këtej e tutje do të ishin një nga përfaqësuesit dhe jo e tërë metoda.

9.7.19

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Leximi si hyrje në letërsi.....	3
Mëngjesi i së dielës.....	5
Përballë Borgesit.....	6
Poezia si mision i papërfunduar.....	8
Atje ku shuajnë etjen drerët dhe sorkadhet.....	9
Udhëtim me Holubin.....	12
Shenjtëria e një çasti.....	14
Prej nga vijnë, për ku shkojmë.....	15
Një libër si peshë në dorën tënde.....	17
Rrjedha është vet kënga e ujit.....	19
Librin e shfleton era.....	20
Robëri e nevojshme.....	21
Rreth Lasgushit dhe traditës.....	22
Më shumë i pushtuar se pushtues.....	26
Kushti i një poezie.....	27
Dështimi si mësim i hidhur.....	29
Shkrimtari.....	31
Bashkëbisedim në heshtje.....	33
Për allen Ginsbergun dhe nënën e tij.....	34
Ingeborg Bachman.....	36
Kuptimi emocional.....	38
Në botën fantaziste të letërsisë.....	40
Koha reale e kdaresë të " darka e gabuar".....	41
Burimi ku pi ujë etja.....	46
Lirshmëri pa pengesa e ligjëritimit.....	47
Eliot e Transtromer.....	49
Bibla kish nisur të shkruhej.....	51
Çast.....	53
Blasfemi.....	54
Kavafi.....	55

Një jetë që është duke ardhur	56
Letërsia si busull në dorë të njeriut.....	59
Jeta një përrallë.....	61
Çështje vetjake.....	62
Mafhuz i mallkuar.....	63
Trembe me lule e zana.....	65
Libëri që vazhdimisht do të shkruhet	67
Talenti i kushtëzuar.....	68
Prej dhe nga.....	69
Ëndrra.....	71
Oskar Uajld.....	73
Sjellja dhe prurja.....	75
Qytetare e botës.....	77
Pushteti i poezisë mbi kohën.....	78
Libër që kurrë s'do të mbyllet.....	80
Mos ia përbaltë nderin udhës.....	81
Prej çastit në agoni që është duke ardhur.....	83
Borgesi si gjurmëlënës.....	85
Një vdekje e panevojshme.....	87
Nëpër kthina ku misteri rri fshehur.....	89
Lufta dhe paqja.....	90
Për betim muçon.....	91
Heminguej.....	93
Shtrati european i poezisë shqipe.....	95
Rreth një skicë- ideje.....	96
Drejt një shtegu të ri.....	98
Sadik Bejko.....	100
Në studion e shkrimtarit.....	102
Lirika e mbrëmjes.....	104
Pranoje si dhuratë këtë libër.....	106
Edhe një herë për kadarenë.....	108
Shkruaj për të mundur harresën.....	109

Rruzuj drite	110
Xhojsi dhe Saramango.....	113
Para pasqyrës italo kalvino.....	114
Libri ‘rrokje në kryq’ i pirro lolit.....	115
Faleni të vdekurin tuaj.....	117
Në lidhje me Rambindronant Tagorën.....	118
Për Moikom Zeqon.....	120
Dyshimi që pas është duke na ndjekur.....	122
Nuk ndodhem në vendin e iluzioneve.....	123
Remboja vdiq, Remboja rron.....	124
Si përherë në horizont dritat u shuan.....	125
Pak pas heshtjes.....	127
Në brazdë.....	129
Fjalë të mara peng prej gjuhës	131
Pas një shekulli të lodhur.....	133
Ëngjëlli mbrojtës.....	135
Valë që i japin hijeshi lumit.....	136
Prej Gutenbergut.....	138
Çështje stili.....	140
I përveçëm diku në një kënd të horizontit.....	142

